



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 37 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 25.1 të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës,

THËRRAS

Mbledhjen e XXXVII-të (tridhjeteshtatë - mandati VII)-e rregullt, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **29 mars 2024, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në Komunën e Podujevës**, në orën **10:00**, me këtë;

REND TË DITËS

1. **Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 28.12.2023; 30.01.2024 dhe 17.02.2024**
2. **Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00594-0, ZK Turuçicë**
2.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim
3. **Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00596-0, ZK Turuçicë**
3.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim
4. **Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00597-0, ZK Turuçicë**
4.1. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim
5. **Nisma për bashkëpunim ndër-komunal mes Komunës së Podujevës me Komunave:**
Komuna e Vushtrrisë; Komuna e Prishtinës; Komuna e Mitrovicës së Jugut dhe Komuna e Obiliqit
5.1. Propozim vendimi për miratimin e kërkesës – nismës për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal
5.2. Propozim vendim për autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për themelimin e bashkëpunimit ndër - komunal
6. **Raporti Vjetor Financiar i Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023**
7. **Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri – Projekti “Furnizim me mjete pune për ngritjen dhe zhvillimin e bizneseve”**
8. **Të Ndryshme**

Nr.Prot.01-060/03-0019058/24
Podujevë, datë; 20 mars 2024



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e XXXIII-të (tridhjetetre)-e rregullt, mandati VII-të, e mbajtur më 28 dhjetor 2023.

Mbledhja filloi në orën 10:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

(Nga LDK Valon Demolli; Demokrat Hodolli; Arnisa Sylejmani; Edona Shabani; Adnan Zymeri; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Fahri Hasani; kurse munguan; Arjeta Abazi dhe Tringa Sfishta.

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; ; kurse mungoi Lirika Maliqi.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu; Endritë Murati.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi me arsyetim shëndetësor me shkrim dërguar Kryesuesit të Kuvendit.

Gjithashtu të pranishëm mbledhje ishin, z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Xhevdie Beqiri-Drejtoria e Administratës DA; Avni Fetahu-Drejtoria e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Pajtim Balaj-Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSH; Alban Zeka-Drejtoria e Inspeksionit DI; Lirie Hoti-Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të KFOR, përfaqësues të mediave lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë në këtë mbledhje, në vazhdim theksoi, kuorum kemi dhe mund të fillojmë me punime, për momentin prezent janë 27 anëtar/e të Kuvendit, kurse mungojnë 8 (lexon emrat që mungojnë për momentin).

Materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë të gjithë me kohë, po ashtu edhe konstatimet nga mbledhja e KPF-së ku janë rekomanduar edhe dy pika të rendit të ditës të cilat kërkohet që të futen për shqyrtim në këtë mbledhje të Kuvendit e që edhe për këto pika materiali ju është dërguar, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës.

z.Naim Çunaku, theksoi, me qëllim të korrektësisë sepse tani ë janë bërë dy vite dhe duhet t'i ngjajmë asaj siç thuhet me Rregullore, pra Komiteti për Politikë dhe Financa i sugjeron Kuvendit shtimin e dy pikave, jo të thuhet që KPF ka vendos për dy pika sepse po dalim keq, aq më shumë kur tani janë bërë dy vite të këtij Kuvendi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse atëherë e hedh në votim rendin e propozuar të ditës së bashku me dy pikat shtesë të sugjeruara nga KPF.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 27 vota Për, nga anëtarët që ishin prezent në sallë, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar, përfshirë edhe 2 pikat shtesë të rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 27 dhjetor 2023.

Rendi i miratuar i ditës:

1-Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 27 shtator 2023; 31 tetor 2023; 23 nëntor 2023; 08 dhjetor 2023.

2-Propozim vendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2024

3-Propozim vendimi për lejimin e mjeteve financiare (ndihmë në emër të kompensimit për fermerët e Komunës së Podujevës për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore të ndodhura gjatë vitit 2022)

4-Raportim i Kryetarit të Komunës lidhur me realizimin e projekteve për vitin 2023

5-Propozim vendimi për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm

6-Drafti i Planit Operativ Emergjent Lokal – (Raporti nga konsultimi publik)

7-Marrëveshja Kornizë e Bashkëpunimit Ndërkomunal Shumë-Funksional

(e lidhur mes 6 Komunave si në vijim: Kryeqyteti Prishtina; Komuna e Podujevës; Komuna e Lipjanit; Komuna e Fushë Kosovës; Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Obiliqit)

8-Rishqyrtimi i Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës për periudhën 2023 - 2027 (përkatësisht përfshirja e Ligjit nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-060 për Mbeturina, në dokumentin e Planit Lokal për mbeturina të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2025)

9-Të Ndryshme

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës të mbajtura më: 27 shtator 2023; 31 tetor 2023; 23 nëntor 2023; 08 dhjetor 2023.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pra siç keni vërejtur kemi katër procesverbale, do të thotë kemi qenë paksa mbrapa me procesverbale për shkak të disa mbledhjeve të shpeshta që janë mbajtur dhe që kanë qenë të gjata, kështu që administrata paksa ka vonuar me përgatitjen e tyre, por që tani i kemi të gjitha dhe po e përmbyllim këtë vit me procesverbale.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo i hedh në votim në pako katër procesverbalet sipas kësaj pike të rendit të ditës dhe materialit përkatës të dërguar.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 28 vota Për, nga anëtarët që ishin prezent miratohen pa vërejtje apo plotësim ndryshime procesverbalet nga kjo pike e rendit të ditës dhe atë sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

2. Propozim vendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2024

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, para vetës kemi propozim vendimin për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2024.

Ne si Drejtori kemi bërë përgatitjen e materialit për Listën e veçantë në të cilën janë të përfshira të gjitha të dhënat kadastrale të pronave siç janë numrat e parcelave, sipërfaqet dhe zonat kadastrale, arsyetimin e interesit publik dhe zhvillimin ekonomik, datat e publikimit, periudhën e kohore të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme si dhe destinimin e pronave sipas Hartës Zonale.

Gjithashtu ne si Drejtori kemi marrë edhe konfirmimin prej përfaqësuesit të Komunës për konteste juridike, për pronat e përfshira në këtë listë të veçantë ngase me Rregulloren përkatëse për dhënien e pronave në shfrytëzim, nuk lejohet të jepen në shfrytëzim pronat që janë në konteste gjyqësore, andaj kërkoj nga ana juaj si Kuvend që ta përkrahni këtë pikë të rendit të ditës.

z.Valon Demolli, theksoi, që prej fillimit të këtij mandati kemi kërkuar publikimin e listës së pronave komunale dhe ju si Ekzekutiv dy-tri herë keni premtuar se do ta publikoni atë, andaj e nderuar Drejtoresh e DPKGJ a po na premtoni edhe njëherë tani që ajo listë do të publikohet në ueb-faqen e Komunës në mënyrë që të dihet cilat janë ato prona, ku gjenden, kush i shfrytëzon dhe a paguajnë taksa apo jo për shfrytëzim.

z.Haki Rudari, theksoi, më lejoni që në emër të Grupit të LVV-së të paraqes qëndrimin tonë lidhur me listën e veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2024, ne si Grup konsiderojmë se mëto dhënie në shfrytëzim të këtyre pronave apo këto parcela me mijëra e mijëra m² e që saktësisht tani nuk e di, janë në interes të qytetarëve për arsye se përmes tyre bëhet shfrytëzimi për qëllim të rritjes së vendeve të reja të punës por në të njëjtën kohë është edhe interes i përgjithshëm publik me dhënien e këtyre pronave për qytetarët.

Vazhdimisht e kam cekë qoftë si opozitë qoftë tani si pozitë që këto prona duhet të karakterizohen dhe duhet të bazohen në bazë të Ligjit nr.04/L-144 lidhur me parimet që duhet t'i kemi për këto prona, pra kemi disa parime që janë në Ligj të cilat dua t'i lexoj dhe që duhet t'i kemi për bazë vazhdimisht, parimi i ligjshmërisë, i efikasitetit, i transparencës, i interesit publik, ruajtja e pronës, ruajtja e mjedisit, e që të gjitha këto konsideroj se e bënë që pastaj këto prona kur jepen në shfrytëzim të jenë të barabartë personat që konkurrojnë dhe në të njëjtën kohë është edhe në interes të qytetarëve.

z.Bashkim Sylja, theksoi, ne Grupi i PDK-së e përkrahim propozim vendimin për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim në vitin 2024.

z.Naim Çunaku, theksoi, nga ato që i potencoj parafolësi zotëri Rudari, edhe unë dëshiroj të potencoj diçka lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Sa është e rëndësishme ruajtja e pasurisë së Komunës e përcaktoj Ligji për vetëqeverisje lokale. Pronat komunale të mos mbeten asete të “fjetura” por të hyjnë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe në funksion të të gjithë atyre operatorëve ekonomik që kanë interes t'i marrin në shfrytëzim, dhe nga ata që i marrin në shfrytëzim në një formë i ruhet vlera e pronës komunale, pastaj krijohen mundësi ekonomike më të mira për mirëqenie dhe zhvillim ekonomik si dhe e treta si komponent rriten të hyrat vetanake për Komunën.

Nga ajo që u fol edhe nga shefi i Grupit të LDK-ës zotëri Demolli, nuk ishte akcenti që të mos përkrahët por ishte akcenti diku tjetër që është shumë legjitime dhen shumë e drejtë, madje jo

vetëm tani dhe jo vetëm qe dy vite apo pesë vite por është fakt se pronat komunale kanë ekzistuar qysh nga evidentimi i tyre si prona komunale, prandaj ajo që u kërkua nga z.Valon Demolli do të ishte mirë sepse edhe Ligji e kërkon një gjë të tillë që çdo aset komunal dhe çdo pronë komunale të jetë e regjistruar, dhe ato prona që sot në një formë janë të “fjetura” apo që ato që nuk dihen se në çfarë forme janë duke u menaxhuar të vëhen në faqen zyrtare të Komunës në mënyrë që ta ketë të drejtën çdo qytetarë i Komunës së Podujevës të shpreh interes për ta marrë në shfrytëzim.

Prandaj nga kjo del që edhe ne Grupi i LDK-ës e mbështesim dhënien e pronave në shfrytëzim, e dim qëllimin e mirë të dhënies së pronave në shfrytëzim, mirëpo vërejtja ishte që të pasurohet ajo listë e pronave me të gjitha pronat që mund t’i merr qytetari në shfrytëzim.

z.Arjant Topanica, theksoi, po ndërlihem shkurtë meqë jemi tek dhënia në shfrytëzim e pronës publike, dua të di si qëndron puna, a është dhënë në shfrytëzim, apo përse a shfrytëzohet një pjesë e parkingut në qendër të qytetit dhe këtë e them duke marrë për bazë shqetësimin e disa banorëve për pjesën prapa Bankës BKT konkretisht pjesa që shfrytëzohet për kafiteri. Pra ka shqetësime nga banorët që është zënë ajo pjesë kurse ne nuk e dim dhe nuk e kemi votuar këtu për ta dhënë atë pjesë të parkingut në shfrytëzim asnjë operatori ekonomik, por ajo pjesë shfrytëzohet dhe është bllokuar tërësisht pjesa e anës së djathtë pas rampës që është në vend dhe shfrytëzohet nga një biznes privat që të gjithë e dim se kujt i përket, prandaj do të doja ta di ku qëndron problemi këtu dhe si qëndron puna dhe a është duke u shkel ligji në këtë drejtim.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, sa i përket listës së përgjithshme të pronave komunale, për fat të mirë tani e kemi zgjedhë shefin e pronës e që ka qenë mungesë qe një kohë të gjatë kjo pozitë, dhe tani ekskluzivisht i’a ja kam dhënë detyrë që të merret me këtë çështje dhe besoj dhe shpresoj se shumë shpejt do të publikohet.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, Kryetari i Komunës kur e tha që të qëndrohet deri në fund të mbledhjes për të marrë përgjigjen, unë besoj se deri atëherë gjysma që jemi këtu ikin nga salla, por meqë nuk po përgjigjet askush kolegut parafolës, po i përgjigjem unë. Ai person është një militantë i LVV-së, ja kanë lëshuar aty parkingun dhe e ka zgjeruar dhe rrethuar me pisha dhe nuk shkon Inspeksioni që ta ngucë apo që t’ia heq ato, pra kjo është përgjigja.

z.Bahri Selimi, theksoi, për peronin në fjalë që u cek, ai e shfrytëzon një pjesë të hapësirës publike ku i cili ka publikuar për pëlqim sikurse që kanë aplikuar shumica e atyre që i shfrytëzojnë hapësirat publike, është i pajisur me pëlqim dhe i paguan taksat komunale që i takojnë për shfrytëzim në bazë të Ligjit përkatës për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar drejtor i DSHPMSH, në krejt qytetin e Podujevës më së shumti në atë kafiteri kam ndejt. Mund të them se ajo është një hapësirë 15-16 m² ashtu siç ka qenë. Njëherë e ka uzurpuar me dritare duke e rrethuar një pjesë, pastaj edhe rreth 1 ari vend duke vendos lule dhe pjesë të betonit, andaj nëse ka të drejtë ai person që aq shumë ta uzurpoj komplet parkingun e banesave atëherë jemi në rregull.

z.Bahri Selimi, theksoi, është shumë e vërtetë që e shfrytëzon edhe hapësirën e brendshme dhe hapësirën e jashtme, prandaj ka kërkesë edhe për hapësirën e brendshme edhe për atë jashtme, tarifat ndryshojnë dhe hapësira e brendshme ka tjetër tarifë kurse hapësira e brendshme ka tarifë tjetër, mirëpo ai person i përgjigjet të dy tarifave dhe ka paguar dy tarifat.

Lidhur me këtë, nuk është mirë të fokusoheni vetëm tek një biznes, madje mos dalim andej prapa fare por vetëm e shikojmë Sheshin se si është gjendja, mirëpo gjithsecili prej tyre ka aplikuar dhe tani paguan tatim, përkundër që më parë e kanë shfrytëzuar vend e pa vend dhe ashtu qysh kan dashtë vetë, tani secili është në listë dhe është i pajisur me pëlqim dhe paguajnë tatimin Komunës duke i rritur edhe të hyrat vetanake ashtu siç e ceku z.Naim Çunaku pak më parë për këto pronat që jepen në shfrytëzim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim vendim sipas kësaj pike të rendit të ditës dhe materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 29 vota Për, nga anëtarët që ishin prezent miratohet Propozim vendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2024, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje

3. Propozim vendimi për lejimin e mjeteve financiare

(ndihmë në emër të kompensimit për fermerët e Komunës së Podujevës për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore të ndodhura gjatë vitit 2022)

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa jam në dijeni kjo listë është për disa fermer të cilët kanë aplikuar në Ministrinë përkatëse për kompensim të dëmeve të shkaktuara por që janë refuzuar dhe tani Komuna e ka përgatitur këtë listë dhe është paraqitur para Kuvendit për kompensim. Urdhëroni ndokush nga Ekzekutivi të paraqet fjalën hyrëse, pastaj vazhdojmë me diskutimet e anëtarëve të Kuvendit.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, po e marrë përsipër dhe po bëjë përpjekje që ta elaboroj paksa këtë pikë të rendit të ditës edhe pse nuk është në domenin tim drejtpërsëdrejti por meqë drejtoresha e DBPZHR është emëruar më vonë kurse problemi që është shkaktuar është i mëhershëm nuk desha që ta ngarkoj me këtë çështje atë. Ajo që dua të them është një çështje e cila në një formë na ka shkaktuar edhe neve shqetësime.

Në vitin 2022 jeni në dijeni se janë shkaktuar disa dëme në bujqësi nga fatkeqësitë natyrore, normale që Komuna e ka të formuar një Komision i cili bënë vlerësimin e këtyre dëmeve dhe jeni në dijeni se pas çdo dëmi të shkaktuar në Komunën e Podujevës fermerët e kanë të drejtën të paraqesin kërkesë për vlerësimin e atyre dëmeve dhe në vazhden e kësaj konform rregullativave ligjore fermerët kanë paraqitur kërkesa të tilla e që sigurisht se Komisioni ka dal në terren dhe ka kryer punën e vet dhe këtë keni mund ta vëreni në dokumentacionet përkatëse që ju janë dërguar për këtë pikë të rendit të ditës.

Se a është kryer mirë apo jo puna nga komisioni në fjalë, unë edhe sot e asaj dite i kam dilemat e mia, pastaj se a ka pasur lëshime nga ana e fermerëve në kërkesat e tyre sërish i kam dilemat e mia, dhe duke pas parasysh gjitha këto probleme që kanë ndodh në proces dhe shpeshherë duke u hedh faji herë tek Komisioni i Komunës herë tek fermerët kinse i kan kaluar paksa rregullat rreth mundësisë së kompensimit të dëmeve, është ardh një situatë ku kemi pas një varg këmbimesh dhe shkëmbimeve të informacioneve mes Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural MBPZHR, dhe Komunës së Podujevës përkatësisht Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve.

Po ta shikojmë përbërjen e Komisionit mund të themi se ka qenë bukur profesional sepse ka mbuluar gjitha fushat, mirëpo siç e ceka unë sot e asaj dite kam dilemat e mia, madje ka pas raste kur kam menduar që ai Komision ndoshta e ka merituar që të dërgohet komplet në komision disiplinor sepse si pasoj edhe e mos punës së mirëfilltë ndoshta të atij komisioni, por edhe ndoshta për jo seriozitetin e treguar disa prej këtyre fermerëve që janë në listë sepse sipas asaj që më është thënë nga komisioni në fjalë, gjatë punës së tyre ka pasë fermerë 3 vëllezër të cilët kanë bërë kërkesë me të njëjtën pronë, me të njëjtat foto, dhe kur gjitha këto kanë dal në diskrepancë tek MBPZHR e që kjo Ministri normale pastaj i ka kthyer prapa rreth 97 fermer nëse nuk gabo, që

kanë qenë në atë listë. Pastaj pas një vargu të negociatave dhe shkëmbimit të kërkesave dhe dokumentacioneve mes Komunës dhe Ministrisë ne kemi arritur që atë numër ta zvogëlojmë dhe në fund Ministria, përkatësisht nga komisioni përkatës i MBPZHR që është i formuar për kompensimin e dëmeve na është thënë se nëse ju si Komunë e merrni përsipër një pjesë të përgjegjësisë për t'i kompensuar një pjesë të atyre fermerëve, ata si Ministri do t'i marrin një pjesë të fermerëve tjerë për të cilët ata vet e kanë arsyetuar se është gjithçka në rregull për t'i kompensuar.

Pra prej dy punëve të këqija që ishim, të refuzohet komplet ajo listë prej rreth 97 fermerëve, unë në një formë jam pajtuar që Ministria ta kryej pjesën më të madhe të kompensimeve të atyre fermerëve, ndërsa për pjesën tjetër të fermerëve po ulemi dhe po e analizojmë bashkërisht edhe njëherë me Komisionin komunal se çka mund të bëjmë, komision i cili t'ju them të drejtën është ulur me dhjetëra herë duke analizuar dhe shoshitur në forma të ndryshme dhe krejt në fund kanë ardhur me një rekomandim tek unë ku sipas këtij rekomandimi për këta 36 fermer është propozuar të kompensohen me 40% të vlerës së dëmit që është bërë gjatë asaj periudhe kohore, dhe tani sa mund të jetë reale gjithë kjo, është përgjegjësi drejtpërsëdrejti e komisionit komunal sepse ne nuk kemi mënyrë tjetër se si mund të besojmë apo jo në këtë fakt.

Duke pas parasysh faktin që unë nuk jam i interesuar që të mos e dëmtoj asnjërin prej këtyre fermerëve, kemi vendosë ta sjellim në këtë seancë të Kuvendit. Dëmet janë të vitit 2022 e që normale se Komunës po i kushton me kosto financiare, por për këtë numër që ka mbete MBPZHR nuk ka dashur në asnjë formë ta diskutoj dhe të merret edhe njëherë me këtë çështje.

Prandaj ne e kemi paraqitë si kërkesë që ky Kuvend ta miratoj këtë listë, nëse miratohet pastaj normale që ne jemi të obliguar t'i kompensojmë këto dëme në shumë prej 40% të dëmit të vlerësuar e që ndoshta kjo shumë nuk është optimalja e kompensimit por mundësitë financiare që fillimisht ka qenë në vlerë mbi 90,000.00€, kemi rënë në këtë shumë prej 27,768.11€ që është propozuar nga Komisioni Komunal.

Unë do t'ju ftoj ta përkrahni këtë sepse fundja këto mjete buxhetore shkojnë tek ata fermerë tanë, nuk janë të komunave tjera por janë të Komunës së Podujevës. Dëme ka pasë, tani edhe disa prej fermerëve kanë dashtë të bëjnë devijime paksa për qëllime të ndryshme, pastaj a ka pas lëshime gjatë vlerësimit nga Komisioni komunal edhe në këtë nuk dëshiroj të shfaqë atë sepse ende mendoj se mund të ketë pas lëshime të tilla, prandaj kemi ardhë në këtë situatë ku jemi dhe nëse ju si Kuvend e vlerësoni që është mirë t'iu ndihmohet këtyre personave mund të vazhdojmë tutje, nëse e vlerësoni që nuk është në rregull mund ta kthejmë prapa dhe nuk paraqet kurrfarë telashe.

Përgjegjësia bie edhe mbi fermerët edhe mbi komisionin komunal. Fermerët nuk i fajësoj edhe shumë por fajin kryesor e lë tek Komisioni komunal sepse është dashtë të jetë më rigoroz kur ka bërë mbledhjen e të dhënave në terren, të dhëna të cilat pas një kohe ndryshojnë dhe nuk mund askush të del të bëjë foto as të ndërlihdë foto me dëmin e shkaktuar ngase gjendja ndryshon.

Edhe njëherë ju ftoj që ta miratoni këtë propozim, sigurisht pas një debati që do të zhvillohet ngase shoh interesim për këtë e që unë do të bëjë përpjekje t'ju jap sqarime për aq sa kam njohuri rreth këtij procesi. T'ju them të drejtën unë i kam takuar 3-4 herë këta fermerë të cilët në disa raste kanë ditë të jenë edhe goxha të vrazhdë dhe të frustruar. E di që nuk jam unë ai i cili mund dhe dua t'jua cenoj të drejtën e tyre nëse veç janë dëmtuar, por nuk jam as ai i cili sakt kam mund ta precizoj se vërtetë kanë ndodh dëmet në atë moment apo jo, kështu që ka qenë përgjegjësi e Komisionit, por edhe përgjegjësi e fermerëve që të jenë korrekt në raport me Komisionin komunal për vlerësimin e dëmeve që ka qenë në atë kohë.

Si do çoftë situata ka ardh këtu ku ka ardh, unë mendoj se këto mjete buxhetore ashtu kështu shkojnë tek fermerët sepse ne vazhdimisht jemi duke i subvencionuar fermerët dhe bujqit tanë, e

që në rast se miratohet ky propozim do të na zvogëlohet një pjesë e buxhetit për subvencione në bujqësi për vitin 2024, mirëpo sërish e njëjta do të shkoj tek fermerët tanë në një formë por me një mënyrë tjetër.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, meqë Kryetari i Komunës e përmendi Komisionin komunal dhe e kritikoj bukur shumë, propozimi im qysh tani është që ta formojmë një komision në këtu në Kuvend, i cili të ketë qasje në dokumentacione, në foto dhe në të gjitha çështjet tjera që kanë bërë dhe çka nuk kanë bërë komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve.

Çështja tjetër është se këto dëme kanë ndodh më 29 prill 2022 dhe kushdo që e mban në mend dhe çdo kush që ruan video incizime e dinë që në atë ditë ka rënë breshër dhe atë më së shumta në rrethinën e Lluzhanit dhe Lupçit ku edhe dëmet kanë qenë më të mëdha.

Po ashtu Kryetari e tha që në listë nuk ka persona të Komunave tjera, mirëpo listën e keni të gjithë dhe mund ta shihni shembull se në numrin rendor 15 figuron Dinamit Gubetini - Milloshevë, molla dhe dardha e që për mua edhe emri është i dyshimtë por edhe nga fshati Milloshevë, pastaj kemi personin përfitues sipas kësaj liste që figuron në numrin 21 Nehat Gashi - Majac ku thuhet kultura “abaz” vetëm nëse është ndonjë lëndë narkotike sepse kulturë “abaz” nuk kam dëgjuar asnjëherë, mandej në numrin 17 të listës nuk po di a t’ia përmend emrin apo jo, por për kulturën thuhet dardha dhe kushdo që e din ku e ka parcelën ai person atje nuk ka rënë breshër dhe që ato dardha qe 2 vite i ka mbjellë e që produkti i tyre mund të jetë shumë i vogël, por jo 1000 kg dardha.

Prandaj propozimi im është që të formohet një komision prej përbërjes së Kuvendit ku kemi edhe profesionistë të fushës siç është një prej nesh z.Burim Hasani që mund të jetë kryetar i komisionit i cili mund të ketë qasje pastaj në dokumentacionin e fermerëve dhe të komisionit komunal.

Unë nuk mendoj se duhet dënohen të gjithë fermerët këtu sepse ne nuk po jemi në dijeni se a janë ndërruar fotografitë nga komisioni komunal apo nga fermerët, sepse prej këtyre ka shumë fermerë që janë dëmtuar.

Mendoj se këtu ka shumë parregullsi, nëse më 29 prill 2022 ka rënë breshëri kurse këtu është shkruar se është dëmtuar pasuli dhe misëri, unë jam në dijeni se pasuli dhe misëri mbjellët nga 20 prilli deri më 01 maj, qysh është dëmtuar misri atyre pa u mbirë fare. Pastaj në këtë listë janë përfshirë paralel gruri dhe misëri e që do të duhej të ishte vetëm njëra sepse dyat nuk shkojnë në muajin prill, mund të jenë në muajin qershor ndoshta por jo në muajin prill. Përmenden edhe fidanët e lakrave e që unë nuk e di në Komunën e Podujevës kush është ai që mbjellë në muajin prill fidanë të lakrave, sikurse që ka edhe kongullesha madje me 1 hektar në muajin prill, e di që ka pasë disa parcela të mbjella me kungullesha por jo në muajin prill.

Pra këtu në këtë çështje ka shumë parregullsi mirëpo më së keqi e pësojnë fermerët që janë të vërtetë dhe që merren me atë punë, prandaj propozoj edhe kolegëve nga radhët e Kuvendit që të formohet një komision, meqë ne si Kuvend po i ndajmë mjetet financiare përse të mos shikojmë se a ka apo jo shkelje në këtë çështje, mirëpo si do që të jetë pozita ka numra / vota më shumë.

Ne Grupi i LDK-së nuk jemi kundër mirëpo pa e pastruar këtë listë nuk mendoj se është mirë të votohet kjo listë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, unë plotësisht pajtohem me asamblistin parafolës z.Ekrem Rrahmani. T’ju them të drejtën nuk është se nuk i kam dilemat e mia edhe unë, madje preferoj që fare nuk kemi nevojë të diskutojmë më shumë rreth kësaj çështje por vetëm mund t’i jepni emrat e anëtarëve nga Grupet a subjekteve politike që përfaqësohen në këtë Kuvend dhe e formojmë një komision prej 5 anëtarëve të cilët pastaj ti qasen dokumentacionit komplet.

Edhe ashtu ne këto mjete nuk mund t’jua transferojmë këtyre fermerëve edhe për një kohë sepse kjo bartje do të bëhet në vitin e ardhshëm buxhetor, prandaj ai komision mund të punon për 1 ose 2 muaj apo aq sa ka nevojë dhe të verifikojnë çdo çështje dhe të dalin me gjendjen reale sepse edhe

unë jam shumë i interesuar që ta nxjerrë gjendjen reale. Asnjë interes prej kësaj pune nuk e kam, përkundrazi jemi duke u dëmtuar me buxhet për një punë që nga dikush është bërë një gabim në proces, por edhe nëse ai komision ka bërë gabim në proces, prap nuk është faji im sepse janë persona profesionistë që i kemi zgjedhë këtu brenda Komunës dhe nuk janë asnjëri prej tyre të rinj që do të mund të thonin nuk e kuptojnë këtë problematikë.

Dilema ka, edhe unë i kam ato dilema, për fshatrat që përmenden siç ishte fshati Milloshevë, këtë nuk do të thoja të paraqitet si problem sepse me gjasë sigurisht ai person banon në Milloshevë por tokën e ka këtu në territorin e Komunës së Podujevës sepse bëhet fjalë për tokën që është në territorin e Komunës tonë pavarësisht që individi në fjalë mund të jetë i atij fshati.

Kështu që lirshëm mund të propozoni nga një anëtar/e për këtë komision, besoj që ka profesionist të fushës nga radhët e Kuvendit siç është asambleisti i përmendur më parë (z.Burim Hasani), madje kryesimin e komisionit dhe rolin kryesor është mirë ta ketë opozita gjë që nuk paraqet kurrfarë problemi ashtu sikurse nuk ka kurrfarë problemi që ta vlerësojnë gjithë procesin dhe ta nxjerrin realen nga ky proces sepse unë jam shumë i interesuar ta nxjerrë realen në mënyrë që pastaj ata që meritojnë të marrin edhe mjetet financiare në emër të kompensimit kurse për ata që nuk e meritojnë fundja nuk kemi obligime ndaj tyre.

Kryesuesi i Kuvendit, pas parafolësve mendoj se nuk mbetet vend më për debat rreth kësaj pike sepse ishin shumë të qartë dhe pati dy propozime konkrete, të qarta dhe shumë të sinqerta, mirëpo meqë po kërkohet fjala sërish, urdhëroni.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, i nderuar Kryesues nuk e di përse po heziton të na japësh fjalën kur jemi në dijeni se është e drejtë e jona si anëtar të Kuvendit. Unë kam një paqartësi dhe për këtë parashtroj pyetje, në listën përkatëse tek dy persona kam parë se çmimi i qepës është i ndryshëm, prandaj pyes a bëhet fjalë për qepë të llojeve të ndryshme apo si është punë në këtë çështje, pra personat e renditur në nr.8 dhe 10 në listë varion çmimi ku tek njëri është 41 cent kurse tek tjetri është 65 cent ndërsa për këta dy persona është e shënuar qepë, andaj pyes a është fjala për qepë të varieteteve të ndryshme apo si qëndron kjo.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, për shkak të procedurave dhe me kërkesën edhe të Zyrës ligjore, për këtë pikë të rendit të ditës po vendosim që të shtyhet për një prej mbledhjeve të radhës që të trajtohet, ndërsa në pikën Të Ndryshme mund të formohet komisioni i cekur, kjo për shkak të procedurave ligjore sepse në këtë pikë të rendit të ditës sipas zyrtarit ligjor nuk e di a kemi të drejtë të formojmë drejtpërsëdrejti komision kur pika në fjalë ka tjetër natyrë, mirëpo për të qenë në rregull, për këtë pikë të rendit të ditës po vendosim ta shtyjmë për një prej mbledhjeve të radhës dhe me rekomandim që në pikën Të Ndryshme të formohet komisioni për trajtimin edhe njëherë të dokumentacioneve të fermerëve në fjalë. Ky ishte rekomandim i Zyrës ligjore.

z.Burim Hasani, theksoi, sa i përket punës së Komisionit komunal për vlerësimin dëmeve, vet fakti tregon se nuk mund ta lëm komisionin edhe aq fajtor sepse vet fakti tregon se kur bëhet fjalë për vendbanimet tingëllon pjesa e territorit përgjatë Lumit Llap e që shumica e territorit ka të bëjë sa i përket pjesë së Lumit Llap i cili prek pjesët e fshatrave siç janë, shembull Lupç i Poshtëm, Lluga, Halabak, Lupç i Poshtëm, Majac i Poshtëm, Batllavë, do të thotë kjo është një vijë e cila preket pavarësisht sipërfaqeve vërshuese sepse sa do që të vogla të jenë vërshimet këto sipërfaqe preken, prandaj e them se vet fakti i këtyre vendbanimeve të jep një sugjerim se ka pas vërshime dhe si pasoj ka pasë edhe dëme në atë pjesë.

Sa i përket Komisionit komunal i cili ka bërë vlerësimet në kultura, pati edhe dyshime, shembull, edhe pse dëmet kanë ndodh gjatë muajin prill 2022, ne kemi kultura të ndryshme edhe pse ato nuk përputhen në stinën dhe periudhën mujore përkatëse të vitit 2022 këtu kemi disa dallime siç është ai për fidanët e lakrave edhe pse në këtë periudhë kohore shumica e fermerëve fidanët e lakrave i

mbjellin brenda në sera dhe atë në qese të plastikës për t'i krijuar si fidane e pastaj për t'i bartur në natyrë për t'i mbjellë, do të thotë kjo korrespondon me periudhën përkatëse kohore ngase i kanë pasë të mbjella brenda dhe ju janë mbushë serat me ujë.

Sa i përket pjesës së grurit, ne e kuptojmë se gruri është i mbjellë qysh në vjeshtën e vitit 2021 por që periudha e dëmit ka ndodh në vitin 2022 edhe pse në muajin prill të vitit 2022 gruri veç ka qenë i mbjellur dhe normale që në shumicën e rasteve ku ka vërshime dhe që uji qëndron mbi bazën tokësore kuptohet se mund të sjellë dëmtime tek të mbjellat.

Kështu që unë nuk e fajësoj shumë komisionin komunal edhe pse kërkesat e vlerësimeve janë paksa të mëdha nga ana e fermerëve, kurse komisioni e ka bërë atë vlerësim prej 40% nuk konsideroj se ka pas shkelje pse ky vlerësim është në këtë përqindje nga ana e Komunës për t'u bërë ajo pagesë, andaj nuk besoj se ka diçka që mund të shkoj diçka më shumë tek fermerët edhe pse në shumicën e rasteve fermerët kanë një kërkesë paksa më të madhe se sa që është dëmtuar por me rëndësi është që vlera prej 40% që është vlerësuar prandaj nuk e shohë të dëmshme këtë për fermerët andaj sipas mendimit tim ky proces është mirë të kryhej qysh sot menjëherë ngase krejt këta fermerë dhe kjo vijë e fermerëve janë të prekur nga dëmet. Nuk do të thoja që kjo çështje lihet anash, madje si çështje ka mund të kryhet qysh më parë në muajt shtator - tetor 2023 kur kanë qenë të mbjellat sepse është një pjesë e pagesave të cilat do t'ju hynin shumë në punë bujqve.

Kështu që unë mendoj se nuk ka nevojë të bëhet shtyrje e këtij procesi nëse veç shumica jemi në dakord mund të vazhdojmë tutje dhe mjetet financiare t'iu dalin sa më shpejt fermerëve, edhe pse të gjithë këta janë fermerë të regjistruar, edhe pse komisioni komunal e ka bërë punën e tyre, janë fotot, janë sipërfaqet e tokës së punueshme si dhe vet fakti tregon se vija e këtyre fermerëve të cilët preken janë vija të cilët rrethohen përreth Lumit Llap (Lluzhani, Lluga, Lupçi etj.) këto janë vetëm pjesa të ujërave që lidhen me Lumin Llap.

z.Ardi Hasani, theksoi, lidhur me propozimin e kolegut parafolës z.Ekrem Rrahmani dhe të Kryetarit të Komunës, unë doja të jepja një propozim për formimin e komisionit dhe për procedurat tutja, mirëpo tani meqë kolegu parafolës z.Burim Hasani e japi një propozim tjetër mbetet që të diskutohet, përndryshe unë mund të jap rekomandimin tani se për çka doja.

z.Artrit Mulliqi, theksoi, unë personalisht e përkrah propozimin e kolegut z.Ekrem Rrahmani, dhe këtë për arsye se gjatë shikimit të kësaj liste por edhe listave të mëparshme kam hasë se zakonisht në këto lista po sjellën të njëjtit emra. Pra çdo herë ku ka vërshime, në listë kemi të njëjtit emra, kur ka breshër të njëjtit emra dhe kur ka dëme tjera (brymë) të njëjtit emra, do të thotë këtu diçka është dyshimtë, madje unë dyshoj se disa janë duke mbjellë më shumë për të përfitur nga subvencionet se sa që janë duke marrë nga kulturat e tyre të mbjella, kështu që e përkrah plotësisht idenë e kolegut z.Ekrem Rrahmani.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar kolegu z.Burim Hasani këto dëme ceket se më shumë janë nga breshëri se sa nga vërshimet, por edhe nëse ka nga vërshimet unë më parë e ceka edhe numrin e renditur të fermerit dhe tani sërish shtroj pyetje nëse ndonjëherë ka pas vërshime në atë vend, shembull kemi numrin 17 në listë ku thuhet dardha, andaj çfarë i bënë dardhës atje në kodër vërshimi nëse veç ec uji, prandaj mendoj se këtu ka keqpërdorime.

Po ashtu ndoshta harrova paraprakisht ta cekë edhe një propozim tjetër, fjala është për vitin 2020 ka qenë një kod buxhetor për kompensimin e këtyre dëmeve nga fatkeqësitë natyrore siç janë breshëri, erërat, vërshimet etj, dhe e di që shuma ka qenë rreth 80,000.00€, pyetja është përse tani është heq ai kod sepse po të ishte tani ndoshta edhe Ekzekutivit të Komunës do t'ia lehtësonte punën nëse do të ishte kod i veçantë për këto çështje, nuk do të sillej fare tek ne këtu për të na ngushtuar në një formë dhe të votojmë persona të ndryshëm e që në atë listë mendoj se ka edhe

metrapaz, prandaj nëse do të ishte kodi buxhetor përkatës nuk do të sillej fare tek ne si Kuvendi që tani të diskutojmë për emra dhe çështje të ngjashme, por do të kryhej nga Ekzekutivi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, unë nuk mendoj se është mirë të zgjatet kjo çështje më shumë me debate në Kuvend për arsye se pati dy propozime shumë konkrete që ishin nga kolegu z.Ekrem Rrahmani dhe nga Kryetari i Komunës i cili e përkrahu atë, kështu që unë do të veprojë në këtë mënyrë dhe nuk do të kishim më dilema sepse komisioni në fjalë do të hiqte dilemat.

Pra propozimi ishte që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje të radhës tani dhe me rekomandim që në pikën Të Ndryshme ta formojmë një komision nga Kuvendi, komision i cili do të merret me këtë çështje dhe në një prej mbledhjeve të radhës të diskutojmë sërish për të njëjtën temë ne, andaj kjo më duket paksa shumë po e zgjasim.

z.Naim Çunaku, theksoi, vërtetë jemi në një situatë pa dashur të gjemë fajtorin, por është një situatë mjaftë e koklavitur e krijuar dhe vërtetë nuk e di si mund të bëjmë një zgjidhje në harmoni me aktet normative në fuqi. Në rend të parë i nisëm se nga cili kod buxhetor të merren këto mjete financiare e që sa kuptova nga fjala e Kryetarit të komunës këto mjete do të merren nga kategoria e subvencioneve të bujqësisë të planifikuara për vitin e ardhshëm që do të thotë se në këtë pikë jemi të sqaruar, mirëpo një diçka që nuk e di se si mund ta sqarojmë është se këtu në këtë propozim vendim Komisioni komunal është thirrë në nenin 24 të rregullores për kushtet dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, dhe tani nëse i referohemi këtij neni i cili e parasheh subvencionimin gjegjësisht zhdëmtimin, nen të cilin po e lexoj tani, subvencionimi në fushën e bujqësisë pylltarisë dhe zhvillimit rural mund të bëhet përmes procedurave të parapara të prokurimit publik, përkrahjes financiare, ndihmës në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, përmes pagesave direkte të pas investimeve të bëra nga fermerët dhe konsultimit nga ana e komisionit komunal konform kritereve të përcaktuara në ftesën publike, pra këtu është poenta, thuhet, konform kritereve të përcaktuara në ftesën publike si dhe formave të tjera të parapara me rregullativë ligjore, subvencionimi bëhet përmes Marrëveshjes në mes Komunës, mund të bëhet edhe me donator të ndryshëm ashtu siç kemi pasë raste.

Çka po dëshiroj të them është se për këtë çështje ne kemi diskutuar edhe në mbledhjen e KPF-ës me drejtorin z.Bahri Selimi që ne tani më kemi marrë një dëm gjeneral që ka ndodh në vitin 2022, dhe si dëm gjeneral nuk mund të jetë ngase duhet të specifikohet. Ne vazhdimisht këtu po përmendim dëme në kultura bujqësore (perim kulturë, drithëra etë tjera) mirëpo dëme ka pasë edhe tek ata që kanë shpezëtari e që jam në dijeni saktësisht që ka pasë kërkesa në Komunë edhe për shpezëtari sepse qentë endacak i kanë dëmtuar peronave me 100 e 200 pula, andaj nëse hyjmë në këtë konsideroj se është bukur e gjerë dhe nuk e di sa mund t'ia dalim.

Gjithherë do t'i përgjigjem me po që të ndihmohet bujku dhe fermeri i vërtetë të cilët vërtetë e ka ekonomi dhe jeton në bazë të saj, këtu nuk kam asnjë dilemë se duhet të përkrahet.

Sa i përket asaj se si mund t'jua ngushtojmë rrugën atyre që në emër të atyre të singertëve po keqpërdorin, është një situatë jo e lehtë. Komisioni ad-hoc që u përmend që të themelohet, ne në fakt e kemi një rekomandim të komisionit komunal i cili fare nuk i jap llogari Kuvendit por është komision i cili llogari i jep Kryetarit të Komunës z.Shpejtëm Bulliqi, mirëpo me Kuvend ai komision nuk ka asgjë, kurse ne krejt përmes Kuvendit mund ta atakojmë atë komision, prandaj tani kur edhe Kuvendi kërkon të formoj Komision, në një formë konsideroj se po bëjmë një situatë bukur mix-se. Jam për që të paguhen dëmet fermerëve, por nuk e di sa do të mund t'ia dalim, prandaj edhe njëherë po e përsërisë se jam për ndihmë të çdo fermeri dhe çdo bujku të vërtetë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, i nderuar z.Naim Çunaku, ju të paktën e dini se kjo çështje ka mund të kryhet edhe në mënyrë direkte pa ardhur fare këtu në Kuvend, mirëpo arsyeja përse është sjellë këtu tani më besoj se jeni duke e kuptuar, unë po dëshiroj ta kem edhe bekimin / aprovimin e këtij Kuvendi për këtë proces, e them këtë sepse kompensimin e dëmeve e ka marrë Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural apo Qeveria si nivel qendrorë, kurse unë në këtë proces jam duke dhënë mjete financiare të Komunës, prandaj po dua ta kem edhe aprovimin nga ana juaj si Kuvend, përndryshe unë mund t'i ndaj edhe pa vendim të Kuvendit por e përsërisë se po dëshiroj që ky proces të shkoj edhe përmes juve si Kuvend.

Nëse komisioni i cekur formohet sot nga radhët e Kuvendit, mua do të më lehtësoj shumë punën sepse edhe mua mi heq dilemat që kam, pa dashtë ta dëmtoj askënd sepse nuk jam i interesuar ta dëmtoj asnjërin prej atyre fermerëve mirëpo t'ju them të drejtën nuk jam i interesuar t'ia jap as edhe një cent asnjërit që nuk është meritë për tu kompensuar, jo që frikohem se këto mjete nuk shkojnë në vend të mirë sepse tek fermerët shkojnë, por jo në formë të manipulimeve.

Prandaj në anën tjetër formimi i komisionit në fjalë nga radhët e këtij Kuvendi mua do të më lehtësoj punën që ndoshta të merrem pastaj me të tjerët, nëse vërtetë gjenden lëshime të bëra nga Komisioni komunal që ka qenë, nuk e di a janë bërë apo jo lëshime, mirëpo nëse ky Komision i Kuvendit do ta kryej punën me kompetencë do të jetë një supervaizer / mbikëqyrës që do ta shoh punën e komisionit që ka qenë se çfarë ka bërë. Pra nëse ky komision konstaton se janë bërë lëshime nga komisioni i mëparshëm mua më hap rrugë që pastaj të merrem me komisionin e ngritur nga unë, kështu që ju lus të mos humbni kohë më shumë rreth kësaj çështje por formojeni këtë komision duke e shikuar procedurën ligjore se a po e formoni në pikën Të Ndryshme apo cila është rruga ligjore në mënyrë që mos të ketë shkelje, dhe që do të më ndihmoni shumë e që me kureshtje të madhe pres rezultatet se çfarë do të më ofroj ky komision që do të formohet.

z.Haki Rudari, theksoi, natyrisht se i dëgjova me vëmendje kolegët por në të njëjtën kohë edhe Kryetarin e Komunës, mirëpo dua t'i them parafolësit koleg asambleist se komisioni komunal jep vetëm rekomandime, do të thotë komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera vetëm ka rekomanduar Kuvendit të Komunës, në këtë rast neve, vendimet i marrim ne si anëtar të Kuvendit.

Te Rregullorja për ndarjen e subvencioneve, tek neni 7, e tha edhe më parë Kryetari i Komunës, thuhet, anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve mbajnë përgjegjësi për zbatimin e drejtë të kushteve, do të thotë ata mbajnë përgjegjësi për zbatimin e drejtë apo jo të drejtë të kushteve. Mandej tek neni 11 i po të njëjtës Rregullore, nën 3, ndër të tjerash mund të bëhet rishqyrtimi dhe rivlerësimi ose thuhet mund të anulohet tërësisht ky proces e që realisht tani pothuajse jemi në këtë pikë, dhe pas kësaj të formohet një komision prej përfaqësuesve të subjekteve politike (jemi 4 subjekte politike tani prezent por është edhe përfaqësuesi i subjektit OBKD i cili mungon) si dhe një përfaqësues tjetër qoftë ekspert, nga Shoqëria Civile, qoftë përfaqësues nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe zhvillimit Rural, nuk do të ishte problem kjo, dhe pastaj ai komision i analizon dokumentet, nëse është nevoja të dal në terren edhe atë mund ta bënë e që sigurisht se në seancën e ardhshme do të vijmë më të përgatitur rreth kësaj pike.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ne tani po e dim që më e mira do të ishte që këto dëme t'i kompensoj Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe mos ata kemi ne fare këtë telashe. Për këtë është formuar komisioni i cekur dhe është sjellë në Kuvend, por tani ne duhet të dalim nga kjo situatë, ose ta votojmë këtë listë sipas propozim vendimit kështu siç është ose ta shtyjmë për një mbledhje të radhës me rekomandim që ta formojmë një komision prej Kuvendit i cili në mbledhjen e radhës të na raportoj neve për gjendjen në fjalë, atëherë besoj se do të jemi më

të qartë rreth gabimeve të mundshme sa i përket marrjes së vendimit nga ana jonë ngase neve na takon kjo përgjegjësi meqë veç është sjell në Kuvend si pikë.

Kështu ishin dy propozime, ai i asamblistit z.Ekrem Rrahmani dhe ai i Kryetarit të Komunës e që unë personalisht do t'i përkrahë.

Për momentin në sallë janë 30 anëtar/e të Kuvendit, andaj e hedh në votim që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një prej mbledhjeve të radhës me rekomandim që të ngritet një komision ad-hoc prej Kuvendit, për vlerësimin e dokumentacioneve.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 28 vota Për, nga anëtarët që ishin prezent, përkatësisht pas diskutimeve dhe propozimeve, (bazuar në nenin 12 shkronja d) dhe 17 shkronja c) të Ligjit për vetëqeverisje lokale 03/L-040, nenin 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 19 paragrafi 1.19 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, në formë të përfundimit / konkluzionit, mbështeti propozimin që:

I. Propozim vendimi në fjalë shtyhet për shqyrtim në një prej mbledhjeve të radhës të Kuvendit të Komunës.

II. Të formohet një Komision ad-hoc për shikimin, analizimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të dëmtuarve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të ndodhura gjatë vitit 2022 sipas rekomandimit nr.prot.02-016/01-0086038/23 datë 06.12.2023 dhe Listës përkatëse të Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

III. Në pikën e rendit të ditës Të Ndryshme, nga subjektet politike të propozohen emrat e anëtarëve për ngritjen e komisionit në fjalë i cili do t'i qaset shikimit, analizimit dhe vlerësimit të dokumentacioneve të fermerëve dhe të tjerëve të dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të ndodhura gjatë vitit 2022 që nuk janë kompensuar nga ana e nivelit qendrorë por që janë kthyer në Komunë për vendosje dhe kompensim, si dhe i njëjti për punën e bërë të përgatitë raport në formë të shkruar me rekomandime konkrete për hapat dhe veprimet e mëtutjeshëm që duhet të ndërmerret Kuvendi i Komunës lidhur me ndarjen e mjeteve financiare për kompensimin e dëmeve për të dëmtuarit sipas Listës përkatësisht rekomandimit të datës 06.12.2023.

4. Raportim i Kryetarit të Komunës lidhur me realizimin e projekteve për vitin 2023

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, duke e paraqitur raportimin lidhur me realizimin e projekteve për vitin 2023, theksoi, para disa ditëve kam realizuar takim dhe debat publik me qytetar në të cilin t'ju them të drejtën nuk kam qenë shumë i kënaqur me pjesëmarrjen, por sido qoftë e kam pas për obligim t'i realizoj detyrat që dalin konform rregullativave ligjore.

Edhe përkundër faktit që ne kemi pas mundësin të raportojmë deri në fund të muajit mars kur është afati i fundit i raportimit, meqë kjo seancë është e fundit për këtë vit unë e kam parë të rrugës që të jap disa informata lidhur me punët e kryera gjatë vitit 2023, edhe për faktin që jemi në përmbyllje të këtyre punëve sepse po punohet ende në terren falë kushteve të mira klimatike.

Po e filloj me Drejtorinë e Administratës, gjatë vitit 2023 janë lëshuar gjithsej 92328 dokumente të ndryshme për qytetarët, është punuar në ambientin e jashtëm të Komunës së Podujevës dhe jemi në fazën përmbyllëse të këtij projekti, janë avancuar disa shërbime përmes E-Kioskeve përkatësisht është futur në sistem edhe materiali për tatimin në pronë, konkretisht certifikata e tatimit në pronë.

Kemi filluar me procesin e zgjedhjes së këshillave lokale të fshatrave, proces ky për të cilin të gjithë jeni në dijeni se nuk ka shkuar ashtu siç kemi planifikuar por po shpresojmë që viti i ri do të na hapë mundësi që të vazhdojmë aty ku kemi mbet, pra ka pas disa tentime për t'i formuar disa këshilla dhe njëkohësisht ka pas disa dështime për arsye prej më të ndryshmeve dhe nuk kanë shkuar ashtu siç kemi planifikuar, por sido qoftë shpresojmë se viti 2024 do të na hapë rrugë në këtë proces dhe të ecim përpara.

Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, është planifikuar dhe aprovuar buxheti për vitin 2024 si buxhet më i lartë ndonjëherë e që kjo është normale sepse gjithmonë ai buxhet që vie është më i larti, pra fjala për buxhetin e vitit 2024 prej 31,043,019.00€, afërsisht rreth 4 milion euro më i lartë se buxheti i vitit 2023. Pastaj të hyrat vetanake të Komunës së Podujevës të realizuara në vitin 2023 janë afërsisht 2,200,000.00€ e që është një shembull i mirë i rritjes së të hyrave vetanake, pra kemi inkasim afërsisht 400,000.00€ më tepër se që kanë qenë të planifikuara dhe besoj se këto mjete do të jenë ndihmesë për ne në vitin 2024 për realizimin e disa projekteve. Vlen të ceket se këtu në Kuvendin e Komunës në një prej seancave të kaluara është marrë vendim për faljen e shumës prej 100€ të tatimit në pronë për qytetarët tanë. Mandej gjatë vitit 2023 janë regjistruar 1500 objekte në sistemin e tatimit në pronë e që do të ketë efekt pozitiv në rritjen e të hyrave vetanake.

Drejtoria e Arsimit, janë kryer një varg i punëve dhe detyrave gjatë këtij viti kalendarik siç është furnizimi me kabinete muzikore projekt ky në vlerë prej 8,730.00€, furnizimi me rekuizita sportive në vlerë mbi 15,000.00€, pastaj në bashkëpunim me Organizatën IOM janë furnizuar me kabinete të shkencave ekzakte dhe kabinete muzikore shkollat në fshatrat Sfeçël dhe Orllan, mandej është bërë furnizim me inventar për shkolla në vlerë mbi 140,000.00€, furnizim me kabinete të gjeografisë, historisë, matematikës në vlerë 48,681.00€. Tashmë jeni në dijeni që ky vit na ka mundësuar hapjen e dy çerdheve të reja publike dhe tani Komuna jonë ka katër çerdhe publike, pra bëhet fjalë për çerdhet e reja në fshatrat Lluzhan dhe Sfeçël lokalitete në të cilat më parë nuk ka pas çerdhe, dhe po ashtu ky vit ka qenë vit që kemi filluar edhe ndërtimin e dy çerdheve të reja në qytetin e Podujevës dhe në fshatin Batllavë.

Është bërë instalimi i kamerave për sigurinë e fëmijëve në nëntë objekte shkollore, janë furnizuar me inventar çerdhet në shumë 54,000.00€, është bërë inaugurimi i Qendrës së parë të karrierës në Podujevë, po ashtu për nevoja të arsimit profesional të shollës "Fan S. Noli" kemi përfutur pajisje për zdrukthëtarin në bashkëpunim me qytetin Kestel në Bursa të Turqisë. Pastaj janë ndarë 265 bursa për studentë dhe atë në vlerë totale rreth 100,000.00€, është bërë inaugurimi i masës së efijencës në bashkëfinancim mes Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Botërore në vlerë prej

730,00.00€, pra bëhet fjalë për SHFMU “Shaban Shala” ku ende janë duke vazhduar punimet në këtë objekt shkollor, është punuar në dhjetëra shkolla tjera për renovimin e tyre. Gjatë këtij viti kanë vazhduar punimet në tri objekte shkollore, dhe atë në fshatin Dumosh ku punimet janë duke vazhduar me intensitet si dhe objekti i shkollës në fshatin Obrancë i cili tani thuajse është i gatshëm për zhvillimin e procesit mësimor por janë edhe disa intervenime në ambientin e jashtëm e që shpresoj se me fillimin e gjysmë vjetorit të dytë nxënësit do e fillojnë mësimin në objektin e ri, si dhe kemi objektin e shkollës së fshatit Llugë ku punimet janë duke vazhduar me një ritëm jo aq të mirë e them kështu, projekt ky i cili është i financuar nga Ministria e Arsimit, kurse dy projektet e lartcekura janë të financuar nga Komuna e Podujevës. Është realizuar po ashtu një projekt në bashkëfinancim mes Komunë së Podujevës dhe Caritasit Zvicëran në Gjumnazin “Aleksandër Xhuvani” dhe në Shkollën e Mesme Profesionale “Fan S. Noli”, si dhe kemi furnizimin me inventar për 5 klasa përgatitore në 5 shkolla të ndryshme në bashkëpunim me Caritasin Zvicëran.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare-QKMF gjatë këtij viti janë ofruar mbi 214000 shërbime të ndryshme për qytetarët, Qendrat tjera të mjekësisë familjare në terren kanë ofruar rreth 49000 shërbime të ndryshme për qytetarët, nga shërbimi mobil shëndetësor janë ofruar rreth 8000 shërbime shëndetësore për pacientët në shtëpitë e tyre. Urgjenca e qytetit po vazhdon të ndërtohet e cila është bashkëfinancim mes Organizatës Chatar Charity dhe Komunës së Podujevës, pra presim dhe besojmë se kjo pranverë do ta gjej të gatshëm atë objekt dhe ta bartim urgjencën e qytetit në këtë objekt. Janë rinovuar disa objekte shëndetësore duke e përmirësuar infrastrukturën e përgjithshme të tyre, QMF-të janë furnizuar me pajisje të reja mjekësore, QKMF është furnizuar me 4 autoambulanca të reja.

Pastaj ka përfunduar projekti i ndërtimit të njëzetedy shtëpive nga Fondacioni “Shqiptarët për Shqiptarët” dhe tashmë familjet i kemi të vendosura në atë lagje. Janë subvencionuar në vlerë rreth 200,000.00€ personat me gjendje të rëndë shëndetësore dhe sociale. Po ashtu është nënshkruar Marrëveshja me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” për fillimin e ndërtimit të Qendrës rezidenciale për persona të moshuar, e cila ka një vlerë prej 2,500,000.00€ prej tyre me shumë 500,000.00€ financon komuna kurse pjesën tjetër e financon Shoqata “Jetimat e Ballkanit” projekt për të cilin shpresoj se gur themelin do ta vëm në përvjetorin e rënies së Heroit të Kosovës Zahir Pajaziti më datë 31 janar të këtij viti, andaj nga ky moment jeni të ftuar në atë aktivitet.

Gjithashtu në bashkëpunim me Organizatën e Chatar Charity janë hapur 100 puse për familjet me gjendje jo të mirë sociale.

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, kjo Drejtori ka pas një numër të madh të kërkesave sa i përket informatave për Planin urbanistik prej tyre kanë qenë njëzetenyjë kërkesa, pastaj për kushte ndërtimore kanë qenë gjashtëdhjeteshtatë kërkesa, për leje ndërtimore kanë qenë dyzetedy kërkesa, për pëlqime n’parim tetëdhjetekatër kërkesa, mandej për listën e legalizimeve kemi shtatëmbëdhjetë kërkesa, kurse për listën e pritjes kanë qenë nëntë kërkesa, njoftim për plotësim dokumentacioni katër kërkesa, në listën e refuzimeve kemi dymbëdhjetë.

Sa i përket projekteve të realizuara dua t’i përmend vetëm projektet në mënyrë që të mos ju marrë kohë shumë ngase janë të paraqitura këtu në mënyrë të detajuara, prandaj lista e kontratave për asfaltimin e rrugëve duket kështu, asfaltimi i rrugëve në fshatrat Batllavë, Gërdoc, Kaçybeg mbi 1.5 km është përfunduar, pastaj asfaltimi i rrugëve në fshatin Dumnicë rreth 1 km ka përfunduar, asfaltimi i rrugëve në fshatrat Sylevicë, dhe Tërnavicë mbi 1.8 km po ashtu e përfunduar, asfaltimi i rrugëve në fshatin Bellopojë projekt dy vjeçar mbi 2.7 km të përfunduara, asfaltimi i rrugëve në fshatrat Godishnjak, Lluzhan, Shakovicë rreth 1.5 km e përfunduar, asfaltimi i rrugëve në fshatrat Tërnavë dhe Halabak mbi 1.2 km e përfunduar, asfaltimi i rrugëve në fshatrat

Gllamnik dhe Sibofc mbi 1.5 km e përfunduar, asfaltimi i rrugëve Lladofc dhe Shajkofc mbi 1.1 km e përfunduar, asfaltimi i rrugëve në Orllan me rrethinë mbi 2.8 km e përfunduar, asfaltimi i rrugëve në qytet i ndarë në 3 lote mbi 2.3 km e përfunduar, asfaltimi i rrugëve në fshatrat Letanc, Peran, Llapashticë mbi 2.5 km e përfunduar.

Pastaj po i rumbullakojmë shifrat e gjatësive të asfaltimit të rrugëve, asfaltimi i rrugëve në fshatrat Lupç, Majac projekt dy vjeçar mbi 2.1 km të përfunduara, asfaltimi i disa rrugëve në fshatrat Pakashticë, Zakut, Kërpimeh, Metehi mbi 1.8 km të përfunduara, zgjerimi dhe ndërtimi i Rr.“Xhemajl Mustafa” 2.73 km të përfunduara, pra gjithsej 26886 km rrugë të përfunduara. Kemi edhe projektet dy vjeçare që janë të vitit 2022-2023, Rr.“Skënderbeu” e përfunduar tash më, asfaltimi i rrugëve në fshatin Gllamnik ka përfunduar, po ashtu janë përfunduar rrugët në fshatin Llapashticë dhe në qytet, asfaltimi i rrugëve lidhëse në mes fshatrave Llaushë, Dobërdol, Buricë, Konushefc, Dumosh dhe Sfeçël kanë përfunduar, po ashtu kanë përfunduar punimet në rrugët e fshatrave Revuç, Bajçinë, Lluga, Konushefc, Bradash dhe Dobratin, si dhe ka përfunduar asfaltimi i rrugëve në fshatin Letanc.

Gjatë këtij viti kemi pas disa Memorandume Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vitin 2022-2023 që ka qenë për asfaltimin e rrugës së fshatit Turuçicë e që këtë vit mbyllet kontrata, si dhe asfaltimi i rrugës lidhëse të fshatrave Kalaticë dhe Brainë e cila është në proces të ekzekutimit dhe nuk ka mundësi të kryhet këtë vit por që presim që në vitin e ardhshëm të përmbyllet si projekt. Pastaj kemi Memorandumet tjera me këtë Ministri që janë për vitet 2023-2024 dhe janë për sanimin dhe rehabilitimin e rrugëve të dëmtuara në fshatin Pakashticë në vlerë 154,000.00€ dhe mjetet janë shpenzuar në këtë vit, kemi zgjerimin, sanimin dhe asfaltimin e rrugës kryesore në Shamalluk në vlerë 186,500.00€ e që mjetet për këtë vit janë shpenzuar dhe pritet që shtesa e fundit e asfaltit të bëhet në vitin e ardhshëm apo mund të ndodh nëse e lejojnë kushtet atmosferike ka gjasa që mund të kryhet edhe gjatë këtij viti komplet faza e punimeve e pastaj shpenzimin e mjeteve e bëjmë në vitin e ardhshëm.

Ndërtimi i rrugës së fshatrave Herticë-Turuçicë në vlerë 350,000.00€ është në proces të lidhjes së kontratës. Po ashtu në këtë Drejtori ka edhe projekte tjera që janë kryer gjatë kësaj periudhe kohore siç është shpronësimi i rrugës lidhëse me magjistralen Podujevë-Prishtinë dhe Rr.”Vëllezërit Frashëri”, pastaj kemi hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm të Zonës Industriale, mandej kemi krijimin e Sistemit digjital të regjistrimit të ekonomive familjare në kuadër të menaxhimit të mbeturinave dhe mirëmbajtja e sistemit të ujitjes në sheshin e qytetit, pastaj shtimi i hapësirave gjelbëruese, hartimi i Planit komunal të veprimit për energji dhe klimë 2023-2030, meremetimi i objekteve banesore në qytet, ekzaminimi i materialeve ndërtimore, mirëmbajtja e fontanave, rregullimi i lodrave në park, sistemi i regjistrimit të adresave e kështu me radhë, pra kemi edhe një varg projektesh të hartuara, rreth trembëdhjetë projekte për të cilat nuk dëshiroj t’ju marr kohë më shumë.

Drejtorja për Pronë Kadastër dhe Gjeodezi, gjatë vitit 2023 janë pranuar 11290 kërkesa, prej tyre 96.6% janë trajtuar dhe aprovuar e që lë të kuptohet se është bërë një punë e madhe në këtë Drejtori edhe përkundër volumit të madh të kërkesave. Në sektorin e pronës për periudhën janar-dhjetor 2023 janë shqyrtuar 399 kërkesa të cilat kanë marrë përgjigjet meritore, pastaj kanë përfunduar procedurat e bartjes së pronave në zonat kadastrale në fshatrat Obrancë, Surkish dhe Livadicë të cilat janë kthyer në pronësi të Komunës, fjala është për shpronësimet që i kemi bërë.

Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit, në këtë drejtori po i përmend vetëm disa projekte më të rëndësishme, pra është investuar në funksionalizimin e objektit në fshatin Sfeçël dhe tanimë funksionon çerdhja në këtë fshat, kanë filluar punimet për ndërtimin e Qendrës multifunktionale dhe besoj se ky projekt do të përfundoj në vitin 2024, mandej është vendosur shtatorja e Adem

Demaçit, është nënshkruar një kontratë në vlerë prej 425,000.00€ për ndërtimin e fushave të reja sportive dhe zgjerimin e këtyre kapaciteteve, biblioteka prej hapësirës së vjetër ka kaluar në hapësirën e re, është rehabilituar. Janë financuar klube të ndryshme dhe projekte individuale në vlerë 150,000.00€, mandej në galerinë e arteve kanë qenë dymbëdhjetë ekspozita, janë mbajtur pesëmbëdhjetë manifestime, tri premiera për skenën e mbrëmjes, dy për fëmijë, tridhjetë repriza, pastaj kemi subvencione për botime librash, kemi furnizuar bibliotekat me libra të reja dhe janë realizuar një varg aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive gjatë tërë vitit.

Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim, nga kjo Drejtori është bërë mirëmbajtja dhe pastrimi i lumenjve si ai i Lumit Kaçandoll, përroska e fshatit Bradash, kemi dy kontrata deri më tani sipas të cilave janë ndërruar 3230 trupa ndriçues, është bërë mirëmbajtja dhe furnizimi me kamera, furnizimi me drunj dekorativ, dekorimi i qytetit, trajtimi i qeneve endacak, ndërtimi i Stacionit të Autobusëve ku janë realizuar thuajse 50% të punimeve dhe besoj se me fillimin e vitit të ri do të përmbyllet si projekt, pastaj është bërë mirëmbajtja e infrastrukturës publike, kanalizimi fekal dhe atmosferik, intervenimi në qindra raste të deblokimeve të ndryshme, largimi i 62 deponive ilegale, ndërtimi i trotuareve në qytet në gjatësi prej 4882 m, zgjerimi dhe rregullimi i shtretërve të lumenjve Lumi Llap në gjatësi 650 m në pjesën veriore dhe pjesën jugore do të thotë është zgjeruar rregullimi i shtratit të Lumit Llap këtë vit, mandej shenjzim horizontal dhe vertikal në qytet gjë që veç i kemi parë, kemi ndriçimin publik të qytetit 28 km gjatësi me 552 trupa ndriçues, ndërtimi i rrjetit të kanalizimit fekal dhe atmosferik në gjatësi 515 m në fshatin Letanc, 1155 m gjatësi në fshatin Bradash, 2214 m gjatësi në fshatrat Shajkofc dhe Batllavë.

Kemi investime edhe në rregullimin e rrugëve me zhavorr në 63 rrugë në gjatësi 24 km që janë trajtuar, ndërtimi i urave dhe kalesave ku janë ndërtuar 7 ura në fshatrat Pollatë, Dvorishtë, Majac, Bajçinë, mandej kemi ndërtimin e rrugëve me elemete betoni në qytet dhe fshatra në gjatësi 2645m, mure mbrojtëse në fshatrat Pakashticë, Majac, Llapashticë, dhe në Rr. “Hakif Zejnullahu”. Mund të them se riparimi i rrugëve nuk është që ka shkuar mirë, këtë vit janë kryer 8615 m², pastaj është bërë shqyrtimi i kërkesave për hapësira publike 50 lëndë të ndryshme, si dhe intervenime të zjarrfikësve në 695 raste që kemi pasë gjatë këtij viti.

Drejtoria e Inspeksionit, kjo Drejtori ka realizuar vizita të rregullta inspektuese ku inspektorati i tregut ka shqiptuar 11 gjoba mandatore, 14 fletëparaqitje kanë shkuar në Gjykatë për mos respektim të orarit të punës, vendime për asgjësim të mallrave të prishura në 20 raste, pastaj inspektorati i shpërbemeve komunale këtë vit kanë shqiptuar 18 gjoba e që mendoj se ky numër këtyre gjobave është pak, inspektorati i komunikacionit ka shqiptuar 38 gjoba, inspektorati i mjedisit gjithashtu ka shqiptuar numër të paktë të gjobave dhe këtë e them sepse në këtë fushë gjendja është jo e mirë, mandej kemi inspektoratin e ndërtimit që ka trajtuar 52 objekte me leje kurse kanë shqyrtuar dhe trajtuar 43 objekte pa leje nga të cilat këtë vit janë rrënuar 15 objekte të ndryshme pa leje.

Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nga kjo Drejtori është bërë subvencionimi me fidanë të mjedrës në formë të pagesave direkte nga 1000€ për 37 fermer, subvencionimi me fidanë të feferonëve po ashtu në formë të pagesës direkte nga 500€ për 13 biznese, mandej furnizim dhe montim i serave 300 m² për 45 përfitues të projektit, pastaj përkrahje e 75 fermerëve përfitues të projektit me kultivator, përkrahje e 130 blegtorëve me nga një mëshqerrë mbarse.

Po ashtu janë realizuar një varg projektesh në bashkëpunim me donator të ndryshëm, si; furnizim me mekanizëm bujqësor 53 përfitues, 14 motokultivator me frezë dhe rimorkio dhe 39 motokultivator me kosë dhe rimorkio projekte këto në bashkëfinancim me Organizatën nga Katari. Përzgjedhja dhe montimi i serave 176 m² për 10 fermerë përfitues, shpërndarja e 4 pajisjeve laktofriz për fermer në bashkëfinancim me Organizatën IADK, 70 drunj dekorativ në bashkëpunim

me FINCA, pastaj përkrahje e 50 fermerëve përfitues me freza dheu, projekt ky në bashkëfinancim me TIKA turke.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, kjo Drejtori ka bërë subvencionimin e kapaciteteve prodhuese për 16 biznese të cilat janë mbështet në vlerë 62,000.00€, ndërtimin e shtigjeve të ecjes në fshatrat Shakovicë, Bellopojë, Pakashticë e Poshtme, Zakutë projekt në vlerë 240,000.00€, pastaj mbështetje me bimë mjaltëdhënëse për 5 përfitues, mandej kemi projektin e parkingut nëntokësor i cili është proceduar dhe është në shpallje publike, platforma elektronike ku tani kemi harta digjitale, mandej kemi projektin e furnizimit me 100 mjete/pajisje pune për bizneset start-up, rrobaqepës, automekanik, hekëri e kështu me radhë, si dhe kemi projektin e Zonës Industriale për të cilin tashmë janë mbajtur disa dëgjime publike dhe për këtë kemi një proces i cili ka ec dhe tani jemi duke pritur pëlqimin nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës si dhe licencimin që duhet ta bëjë Ministria Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për çka shpresojmë ndoshta në fillim të vitit të ardhshëm do ta marrim licencën për tu hapë mundësitë për veprim në terren.

Është themeluar Ndërmarrja Publike Lokale “Eko-Llapi” dhe tani më e kemi vendimin për themelimin e kësaj Ndërmarrje të re publike,

Kemi trajtimin e 823 lëndëve të regjistrimi i bizneseve. Mandej kemi bërë mbështetjen me serra 100 m², kultivator me frezë dhe kultivator me kosë, projekt ky që është bashkëfinancuar nga Organizata Islamic Relief Kosova ku janë mbështetur 50 fermer.

Pra këto që i potencova në pika të shkurtra janë ato punë të cilat i kemi kryer gjatë këtij viti, mirëpo a ka pasur probleme dhe sfida ju them se unë dëshiroj të jem shumë transparent para juve dhe t’i keni si informacione sepse me siguri edhe ju intereson një gjë e tillë. Problemi kyç që po më pengon është çështja e parkingut nëntokësor për të cilin ne në fakt kemi bërë shpalljen publike, kemi kaluar procesin në Këshillin Ndërmarrësor përkatës dhe kemi marrë pëlqimin, pra kemi bërë shpalljen publike dhe në raundin e parë janë paraqitur 2 kompani, njëra është eliminuar sepse nuk ka qenë serioze kurse ka mbet kompania tjetër në proces, por jeni në dijeni besoj që ne kemi pas një projekt të hartuar që lartësia maksimale që mund të ngritën punimet mbi sipërfaqe të tokës / platos ka qenë diku rreth 1.2 metra ose 1.3 metra, mirëpo pas përfundimit të gjitha procedurave, kur është ka ardh me projekt final, lartësia ka qenë mbi 3 metra për ato objektet afariste që janë të planifikuara në një hapësirë prej rreth 900 m² e që është 10% e gjithë sipërfaqes, dhe pastaj duke marrë parasysh se ky projekt del jashtë rregullave që është aprovuar edhe nga Këshilli Ndërmarrësor, kemi ardhë në një situatë ku çështja ka mbet pezull dhe sipas gjitha gjasave na duhet ta refuzojmë komplet si projekt dhe të kthehemi mbrapa të fillojmë me projektin nga fillimi, apo kemi mundësinë tjetër që të bëhet një kërkesë në Këshillin Ndërmarrësor për rritjen e mundësisë së lartësisë së ndërtimit ngase arsyeshmëria e investitorëve është që pa hapësirën e cekur afariste është jashtëzakonisht vështirë për periudhën kohore të planifikuar 35 vjeçare të mund të bëhet kompensimi i investimeve në parkingun nëntokësor.

Mua më brengos fakti edhe për arsye se kjo hapësirë ka mbet shumë keq sepse tani ne jemi në një situatë ku nuk mund të bëjmë investime për rregullimin e sheshit por nuk kemi as kapacitet ta zë që shumë prej 3,000,000.00€ të bëjmë investime që do të duhej t’i ndajmë nga 1,500,000.00€ për dy vite radhazi për ta ndërtuar parkingun nëntokësor me mjete vetanake, ose në të kundërtën duhet bërë kërkesë në Këshillin Ndërmarrësor për rritjen e lartësisë së ndërtimit në mënyrë që ta bëjmë më atraktiv parkingun nëntokësor.

Sinqerisht ju them se unë i kam dilemat e mia, ndoshta pak a shumë duhet marrë pëlqimin edhe të këtij Kuvendi duke mos përjashtuar dhe pëlqimin e ekspertëve tjerë të fushës sepse për të vepruar kokë në vete nuk e kam atë mundësi që të mare atë përgjegjësi, në anën tjetër edhe nëse ngrit

lartësia e ndërtimit të objekteve afariste ashtu siç është sjellë oferta, atëherë humb pamja e platos e që ne dëshirojmë ta ruajmë si plato para këtyre dy objekteve, do të thotë kemi dilema të cilat janë shkaktuar për shkak se nuk konsiderohet shumë atraktive për investitorët në periudhën përkatëse kohore sa i përket kompensimit në këtë hapësirë.

Gjithashtu mendoj se sa i përket Zonës apo Parkut Industrial, punët paksa janë ngadalësuar, kam shpresuar se këtë vit do të fillojmë por janë procedura që duhet kaluar nëpër Ministri të ndryshme e që bëhet fjalë për 5-6 Ministri nëpër cilat është dashur të kaloj materiali së bashku me kërkesa përkatëse e që njëra prej problemeve kyçe ka qenë Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e cila ka marrë bukur shumë kohë për faktin që ajo pjesë ka qenë kryesisht hapësirë bujqësore dhe nuk ka qenë lehtë të kaloj ky proces mirëpo falë mirëkuptimit që kemi gjet e kemi përfunduar këtë proces dhe tani shpresoj se do kaloj ky projekt.

Po ashtu kemi pas një varg ngecjeshe dhe vonesash edhe në realizim të projekteve dhe atë jo për fajin tonë mirëpo kompanitë i kemi janë këto që janë, mbikëqyrjen e kem këtë që të gjithë e dimë sepse nuk është as e sotit e as e djehit por është bukur gjatë, njerëzit dhe kapacitetet humane i kemi këto që i kemi dhe besoni që goxha sfiduese është, si do që të jetë unë po ju informoj nga informatat që i kam, investimet kapitale falë një angazhimi të të gjithë Ekzekutivit do shkojnë diku rreth 92%, gjë për të cilën unë jam frikësuar se nuk do ta mund ta kalojmë 80% të tyre, mirëpo dashti Zoti që edhe koha javëve të fundit ishte e mirë dhe arritëm një pjesë të projekteve t'i përmbyllim e që ishte shumë rrezik që këto projekte të mos përmbylleshin. Besoj se e keni parë që dje është kryer segmenti i Rr.“Xhemajl Mustafa” sipër në hyrje të rrugës së fshati Dumnicë që ishte në gjendje jo të mirë dhe tani është bërë shumë mirë që u mënjanuan ato probleme dhe të paktën deri në pranverë e kemi qarkullimin e mirë në atë pjesë të qytetit, sot po ashtu ka qenë e planifikuar të vazhdoj pjesa e dytë e asfaltimit të rrugës në Shamalluk por tani për tani nuk kam informacion a kanë vazhduar punimet apo jo.

Ndërtimi i Stacionit të Autobusëve ka avancuar bukur mirë me punime, mirëpo kemi ngecë me projektin për riparimin e rrugëve dhe atë pa fajin tonë por për fajin e papërgjegjshmërisë së kompanive të cilat po kërkojnë shumë, apetitet i kanë shumë të mëdha, kapacitetet nuk po mund t'i rrisin për të pasë mundësi me arrit. Pastaj procedurat e prokurimit ne nuk mund t'i orientojmë dhe kompanitë po hyjnë në procedura me çmime sipas të cilave po i marrin tenderët dhe pastaj po stërngarkohen me punë dhe nuk po kanë kapacitete të mjaftueshme për të krijuar mundësi për t'i kryer punët siç duhet. Nganjëherë ndodh të bëhen edhe lëshime, vlen të ceket se në këtë projektin në ambientin e jashtëm të Komunës i është dhënë kompanisë afat jashtëzakonshëm dhe hapësirë 18 muaj nëse nuk gabohe (sikur të jetë shesh) e që nuk ka pas nevojë të jetë aq i gjatë, por normale që pastaj me lëshime të tilla nganjëherë kompanitë dinë edhe t'i shfrytëzojnë ato vakume dhe gjejnë punë tjera që mandej ka neglizhencë, dhe tani a jemi të kënaqur plotësisht me kualitetin e punës, t'ju them të drejtën jo dhe këtë e bazoj edhe në faktin që ne kemi kontraktuar një kompani për t'i bërë disa shpime dhe disa matje për vlerësimin e kualitetit të punës mirëpo nuk jemi shumë të kënaqur, por si do që të jetë ne duhet t'i shtyjmë si projekte përpara me këto mundësi dhe kapacitete çfarë i kemi, dhe me këto kompani që i kemi.

Si total besoj se janë realizuar punë të mira në vitin 2023, mbetet të përmbyllen disa projekte të mëdha në vitin 2024 dhe gjithashtu të fillohen disa projekte të mëdha. Në veçanti është shumë e rëndësishme të ec përpara projekti i magjistrales Prishtinë - Podujeve i cili nuk është projekt i yni por po duket se ky projekt po zhvillohet me intensitet të kënaqshëm deri tani dhe gjitha informacionet që i kemi planifikohet që në vitin 2024 të mbyllet ky projekt, andaj dashtë Zoti që të ndodh ajo punë. Projekti tjetër bukur kapital dhe sfidues do të jetë rruga që lidhë Rr.“Vëllezërit Frashëri” me magjistralen Podujevë - Prishtinë, sepse është trase e rrugës që bëhet dhe më e

rëndësishmja është se ne e kemi paguar shumën e shpronësimit në vlerë rreth 1,000,000.00€, për ato prona të cilat kanë kaluar në procese dhe jemi në rregull, dje është hapur tenderi dhe sa kam informata janë 4 operatorë që kanë ofertuar dhe shpresojmë të jenë të suksesshëm dhe ndonjëri prej tyre ta merr këtë projekt dhe të kemi mjetet e zotuar që mund të fillojmë menjëherë me procesin në momentin që krijohen kushtet për trasim.

Problemi tjetër që është sfidues dhe që duhet të jeni në dijeni edhe ju si Kuvend në mënyrë që pastaj të mos lodheni me postime sepse po ju tregoj unë tani, është mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve, fatkeqësisht Komuna jonë nuk ka kontratë të nënshkruar ende, kështu që i them anëtarit të Kuvendit z.Valon Demolli të mos ketë merak sepse nuk kemi kontratë kështu që mos u mundoni me pyetje publike sepse unë po ju tregoj tani që nuk kemi kontratë të nënshkruar ende.

Nuk është faji ynë për këtë sepse në muajin maj e kemi shpallë tenderin, prej muajit maj janë duke u shtyrë mes veti kompanitë përkatëse, njëherë me pyetje e kundër pyetje e ku ta di unë se si shkojnë ato procedura nga jashtë ende pa e lëshuar si tender, tani së fundmi kanë filluar me ankesa, fatmirësisht i kemi dy kompani tona që janë nga Komuna e Podujevës por që nuk kanë arrit të gjejnë mirëkuptim mes vete të mos na bllokojnë. Unë nuk e di se si do të zhvillohet procesi, dashtë Zoti nuk bie borë, edhe disa ditë kemi kohë, procesi është në fazën e ankesave dhe në fazën procedurale. Kam shkuar dhe jam interesuar për përshpejtimin e procesit, natyrisht jo të interferoj sepse e drejtë e imja të interferoj, por nëse e shohë që ky proces po zvarritet do të jem i detyruar të dal krejt jashtë kësaj dhe të zhvilloj procedurë të negociuar e që sigurisht se si kontratë pastaj nuk është e mirë dhe nuk më konvenon as mua si Kryetar i Komunës, mirëpo mos keni merak sepse rrugët nuk do t'i lë pa pastruar dhe qytetarët nuk do i lëm keq, nëse nevojitet negociimi i kontratës duhet ta bëjmë edhe përkundër asaj që nuk dua ta bëjë negociim të kontratës, pra nuk është qëllimi im kjo por nuk mund të bllokohej ne për hir të askujt, mirëpo duhet të gjejnë rrugëzgjidhje për ta shtyrë procesin përpara.

Pra këto janë disa prej sfidave që unë i përmenda, ndoshta edhe mund të kem harruar ndonjë, por e rëndësishme është që nuk po fshehim asgjë dhe për të gjitha pyetjet e juaja unë do të përgjigjem pa telashe sepse e kam obligim, prandaj ju falënderoj për vëmendje, ndoshta paska e isha i gjatë në këtë shpalosje të raportit por edhe projekte ka pas pak më shumë.

z.Valon Demolli, theksoi, sot Kryetari i Komunës paraqet raportin njëvjeçar të punës e që normalisht duhet të raportoj të paktën dy herë në vit apo sa herë që kërkon Kuvendi, mirëpo Kryetari paska vendosur sikur babadimri të shpërndaj dhurata njëherë në vit dhe duke na e uruar vitin e ri me këtë raport të punës njëvjeçare. Kryetarin e Komunës mund ta arsyetojmë për këtë raport të punës një vjeçare sepse nuk do të kishte çfarë të prezantonte tjetër nëse do të raportonte dy herë gjatë vitit, dhe kjo u pa edhe para dy dite në debatin me qytetar, u pa sa e beson dhe vlerëson qytetari këtë qeverisje ku pjesëmarrja ishte shumë të vogël.

Me këtë raport të punës ju krenoheni me projektet e realizuar nga dikush tjetër, a mund të na sqaroni neve dhe qytetarët Llapjan, cilin projekt e keni realizuar ju si Ekzekutiv pa përkrahjen e Organizatave të ndryshme humanitare si Chatar Charity, Shoqata “Jetimat e Ballkanit”, Shoqata “Shqiptarët për Shqiptarët” etj.

Në emër të qytetarëve Llapjan e falënderojmë Organizatën Chatar Charity për ndërtimin e emergjencës së qytetit dhe QMF-në në fshatin Gllamnik, gjithashtu e falënderojmë edhe humanistin z.Halil Kastrati nga Shoqata “Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin e Qendrës Rezidenciale për të moshuarit, si dhe një falënderim i veçantë është edhe për familjen Stublla e cila dhuroi parcelën për Organizatën “Shqiptarët për Shqiptarët” e udhëhequr nga z.Elvis Naci, për ndërtimin e 22 shtëpive të reja për familjet në nevojë në Komunën e Podujevës, pa dashur t'i përmend edhe shumë organizata dhe donatorë tjerë.

Ku janë projektet për investime dhe shtim të kapaciteteve shëndetësore në Komunën e Podujevës, konkretisht pse nuk u funksionalizua Spitali i qytetit, fatkeqësisht i vetmi projekt i kësaj qeverisje pa dyshim është projekti madhor ndërtimi i Rr “Skënderbeu” me skandalet e tij përveç vonesës mbi 1 vjeçare, keqpërdorimit me 1,500,000.00€ të taksapaguesve Llapjan, çfarë do të na thoni ju dhe drejtori i juaj për abuzimet në këtë projekt me drunjtë dekorativ në këtë rrugë, madje çfarë ju thoni qytetarëve për kubëzat e kësaj rruge, ku kanë mbet ato, ndoshta ju dhe drejtori i juaj përgjegjës e dini këtë, ndoshta pa pikë turpi përgjigja e juaj do të jetë sikur ajo ndaj qytetarit në takim publik, “ne nuk hajm asfalt”, po e ngushtoni nga 5m në 2.95m dhe tani krenoheni me punimet shkel e shko dhe nënshkrimin kontratë mbi kontratë, mirëpo asfaltimi i rrugëve 3m deri në 300m nëpër prona private edhe pse rrugë të shkurtra po ju del mjaftueshëm për me “hangër centimetra”, si duket kjo qeverisje punon për interesat e kompanive të asfaltit e jo të qytetarit.

Shkolla ekonomike që aq shumë u fol si projekt madhor për vitin 2023 si duket pushtetit i dështoi për shkak se nuk u arrit marrëveshja e përqindjes, si mund të thuhet ndryshe kur tentohet t’i jepet tenderi operatorit 1,000,000.00€ më shtrenjtë.

Sa i përket Drejtorisë së Administratës, e vetmja e arritur e kësaj Drejtorie është shndërrimi i oborrit të Komunës nga parkingu i veturave për diasporë, rregullimi për herë të dytë gjatë dy viteve dhe keqpërdorimi e hajnia e 150,000.00€. Pastaj sa i përket Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, për këtë më së shumti na tregon Raporti i auditorit i cili për herë të parë në Komunën tonë është një raport i kualifikuar, pse ka ndodh kjo sepse nuk e njohin as abc-në e buxhetit dhe financave publike, harxhim i parasë publike pa asnjë kriter, keq menaxhim i parasë publike, pagesa e faturave në kode jo adekuate, pagesa të punëve që realisht as nuk kanë filluar punimet.

Sa i përket Drejtorisë së Arsimit, këtu është një temë në vete, kjo Drejtori vetëm arsim, edukim dhe kushte më të mira për nxënës dhe personel mësimor nuk ofroi, në vend të kësaj e vazhdoi avazin e vjetër edhe këtë vit, punësime partiake, punësime familjare, punësime të dirigjuara, punësime pa kriter dhe nga e famshmjat listë e pritjes. Rreth punësimeve dhe lënia pa pagesë e një numri të personelit arsimor, pagesa për një derë siç e dimë 830€ për ato dyert e famshme, thirrja e famshme e Policisë në Podujevë për shkak se gazetarët po kërkojnë informacion, mashtrimi për shujta ditore për nxënës, bartja e nxënësve pa lidhur kontratë me taxi-bus, pajisja me ditarë në shkolla me vonesë një muaj, e për storjen e sigurimit të librave s’kemi çfarë flasim sepse është skandal kombëtar. Pastaj mungesa e vazhdueshme e materialit higjienik, punësimi i 3-4 personave për një normë prej 20 orëve, një shkollë me dy drejtor kjo ndodh vetëm në këtë qeverisje, largimi i punëtorit teknik veç pse denoncoi abuzimin me mungesën e materialit higjienik, dhe skandali i kësaj Drejtorie është vënia e gur themelit të çerdhes në fshatin Batllavë e që gjatë vizitës që kam bërë aty nuk kishte as gur themel, nuk e di si ka arrit operatori ta largoj materialin ndërtimor dhe armaturën sepse kjo ka qenë një krenari në facebook, me një pamje të jashtëzakonshme buzëqeshja e fëmijëve aty, kurse tani as gur themel nuk kish aty.

Sa i përket Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, 450,000.00€ për fushat sportive të cilat kurrë nuk u kryen, ndërsa paratë u avulluan, pastaj kemi ndarjen e subvencioneve në baza partiake të militantëve partiak pa kriter, do të thotë pa plotësuar asnjë kriter dy kontrata të njëjta për të njëjtin terren sportiv, kontrata e parë në vlerë 72,000.00€ kurse kontrata e dytë 425,000.00€, gjithashtu për ndërtimin e infrastrukturës sportive prej tyre 100,000.00€ të ndara për barin sintetik në kontratën e dytë.

Sa i përket Drejtorisë së Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndarje e mekanizmit bujqësor tek familjarët dhe të afërmit e pushtetit dhe tani më e kanë zbuluar një metodë të re që kryesisht po i publikojnë emrat e grave apo pjesëtareve tjerë të gjinisë femërore në familje, pastaj mos pagesa e dëmeve në bujqësi, një mëshqerrë 3000€ etj.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kemi Qendra të Mjekësisë Familjare jo funksionale në fshatra, rëntgenin në dhomë të mjekut materniteti pa klimë, lifti nuk punon, presion psikik ndaj punëtorëve, zgjedhja e drejtorit të QKMF jashtëligjshëm si dhe Qendra për Punës Sociale pa drejtor 2 vite. Ndërsa sa i përket Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim, aty se besoj që kemi ndonjë sukses përpos mirëmbajtjes së oborrit te shtëpia e Kryetarit të Komunës, mirëpo janë edhe disa shkelje tjera e që sot nuk po i ceku.

z.Xhevdet Maloku, theksoi, duke mos dashur t'i përsërisë gjitha fjalët dhe projekt për projekt ku veç se i prezantoi Kryetari I Komunës para nesh, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e vlerësojmë si pozitive punën e Kryetarit dhe Ekzekutivit i cili ka sjellë punë të mëdha që kanë ndikuar në mirëqenien e qytetarëve duke filluar nga shëndetësia, arsimit, bujqësia e deri te përkrahja e bizneseve.

z.Bashkim Sylja, theksoi, po mundohem t'i anashkaloj disa përgjigje që i mora nga fjalimi i Kryetarit të Komunës, mirëpo konstatimet politike normalisht se do kemi edhe nëse qeverisja e LVV-së nuk e zbaton planin qeverisës të cilin e ka paraqitur përmes buxhetit të vitit 2023 dhe ku qeverisjes lokale i teprojmë më shumë se 1,000,000.00€, natyrisht se unë do e quaj një qeverisje të pa aftë jo profesionale, kështu e kam quajtur edhe qeverisjen e LDK-së, kështu do ta quaj edhe të LVV-së. Kryetari e tha se afërsisht afër 92% është realizuar buxheti në projektet e investimeve kapitale dhe nëse është realizuar aq, dorën në zemër e them se është mirë, nuk është keq.

Unë do flas edhe pse pavarësisht nuk i kemi informatat për secilën Drejtori se sa janë harxhuar, sa janë planifikuar në buxhet dhe sa janë harxhuar mjetet në investimet kapitale, kështu që do t'i cekë disa projekte pak më të mëdha dhe më të rëndësishme që janë. Rruga që lidhet nga magjistralja Prishtinë-Podujevë deri në Rr “Vëllezërit Frashëri”, si dhe rruga nga Rr.“Shaban Shala” deri te Rr. “28 Nëntori”, janë ndarë 1,250,000.00€, Kryetari e ceku se për rrugën që lidhet nga magjistralja Prishtinë-Podujevë, deri në Rr.“Vëllezërit Frashëri” janë kryer procedurat e shpronësimit, kurse për Rr.“Shaban Shala” deri te Rr.“28 Nëntori” nuk mora përgjigje andaj do të doja ta di deri ku kanë shkuar procedurat si dhe përse në vitin 2022 për rrugën që lidhet nga magjistralja Prishtinë-Podujevë deri në Rr.“Vëllezërit Frashëri” është ndarë një shumë e buxhetit 600,000.00€, për çka të gjithë e dimë se në fund vit i kemi bartë te projekti i Rr.“Skënderbeu” për arsye që të mos mbeten suficit ajo shumë mjeteve buxhetore. Rruga “Skënderbeu” është bërë një rrugë shumë e mirë deri të rrethi i Kërpimehut pasi ka përfunduar, të gjithë e dimë se kohëzgjatja e ndërtimit të kësaj rruge ka qenë shumë e gjatë dhe niveli i ndërtimit ka qenë shumë i ulët, këtë e potencoi edhe Kryetari i Komunës se kohëzgjatja e projekteve është shumë e gjatë, për një vit e gjysmë banorët e asaj zone kanë pas shumë vështirësi si dhe shumë biznese janë dëmtuar në atë pjesë.

Rrethi te vendi i quajtur “Qershiat e Llapashticës” është projekt i Ministrisë së Infrastrukturës por është projekt që direkt përcakton edhe qarkullimin e lirë të qytetarëve në Komunën e Podujevës, projekt ky i cili ka filluar para 6 muajve dhe nuk është duke u realizuar për këtë periudhë të gjatë kohore. U përmend edhe projekti më i rëndësishëm ai i magjistrals Prishtinë-Podujevë, nga ana e Komunës kisha kërkuar që nivelit qendror t'i bëhet presion pak më shumë sepse të gjithë ne e dimë që mos realizimi i rreth rrotullimit në fshatin Gllamnik po shkakton probleme, kemi pas raste me fatalitet për fat të keq te varrezat e Sekiraçësn ku kanë pësuar qytetarët tanë për shkak të neglizhencës së Ministrisë përkatëse për ta përfunduar këtë projekt.

Te asfaltimi i Rr.“Hakif Zejnullahu” ngushtimi i trasesë së rrugës për mua është bërë gabim, madje për mua edhe asfaltimi nuk është bërë në mënyrën më të mirë sepse qytetarët në atë pjesë kanë filluar të vendosin çimento gjatë rrugës. Pastaj në planifikimin e buxhetit prioritet i është dhënë edhe arsimit mirëpo rezultatet në cilësi kanë munguar. Gjithashtu edhe Auditori ka bërë vërejtje sa i përket disa projekteve të dy shkollave.

Pyetje tjetër kam edhe për çështjen e mësimdhënësve, pse një pjesë e tyre nuk janë në listë të pagave, do të doja ta di sa janë jashtë listës së pagave dhe pse. Gjatë vitit 2023 prioritet i është dhënë edhe Zonës Ekonomike, e përmendi edhe Kryetari, pra ka qenë prioritet i kësaj qeverisje edhe Zona Industriale dhe unë jam brengos goxha shumë për neglizhencën e këtij projekti e disa sqarime u dhanë mirëpo është shumë i rëndësishëm ky projekt për Komunën tonë por që mendoj se jemi vonuar sepse pas kësaj pike të rendit të ditës kemi pikën e radhës që është inicimi i procedurave për hartimin e Planit Rregullues për këtë Zonë.

Natyrisht unë nuk e mohoj sepse janë bërë edhe shumë punë të mira që janë përfunduar dhe në muajt në vazhdim sigurisht do të kemi informata nga raporti financiar i vitit 2023 dhe nga raporti i auditimit ku mund t'i analizojmë në hollësi gabimet dhe sukseset e kësaj qeverisje.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, lidhur me këtë temë po filloj prej procedurës së fundit që e përmendi Kryetari i Komunës që ishte mirëmbajtja dimërore dhe verore e rrugëve, unë mendoj se kjo procedurë ka filluar gabimisht që nga dita e parë sepse ka vendim të komisionit që ka shpallë fitues njëherë kompani 330,000.00€, pas ankesës është ndërruar komisioni dhe pastaj shpallet fitues kompania tjetër në tenderin 570,000.00€, këtu është një diferencë shumë e madhe, në dosje të tenderit shkruan për 280 ditë por ajo çka është edhe më e pështjelltë kjo punë, ne e dimë se këtu në Kuvend kemi votuar themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” dhe tani nëse kjo është dashur të realizohet për 280 ditë ajo kompani çfarë do të bën kur komplet është e njëjta punë që duhet të kryhet, pastaj tjetra kontratë është lidhur mes Komunës dhe KRM “Pastrimi”, edhe në atë kontratë janë të cekura këto pika, sipas asaj kontrate parashihet kositja e barit, larja e rrugëve, sheshit, unë po të kisha mundësi do e anuloja këtë procedurë sepse gjërat këtu janë pështjellë shumë, do të thotë komisionet që e kanë vlerësuar kompaninë fituese janë komisione të Komunës, tani sigurisht lënda është në OSHP dhe atje ka procedura prandaj deri në shqyrtimin e saj do të ketë vonesa, andaj për këtë dimër se besoj që ka ndonjë shpresë se do të përfundoj kjo punë.

Sa i përket ndërtimit të shkollës në fshatin Obrançë, unë më shumë i përcjell procedurat e prokurimit dhe më bëri përshtypje fakti jo vetëm se i janë kërkuar edhe 24,682.00€ dhe që kanë kaluar afatet e kontratës që ka qenë e planifikuar për 13 muaj që të përfundoj, por më bëjnë përshtypje specifikat për çka janë kërkuar mjetet financiare e që është për rrafshimin e vendit ku do të fillojnë punimet e shkollës e që dihet se punimet e shkollës tani janë në përfundim, ndërsa tani për punë shtesë për rrafshimin e vendit ku do të bëhet ndërtimi i shkollës mua më është dukur shumë interesant kjo.

Ndërtimi i SHMLE “Isa Boletini” e që këtë e ka postuar e dhe Kryetari i Komunës, kurse ndërtimi i saj nuk ka filluar ende, pse nuk kanë filluar punimet mendoj që komisioni ose zyra e prokurimit ka shumë faj sepse aty konkurrojnë 9 kompani dhe prej 9 kompanive tenderi i jepet kompanisë më të shtrenjtë. Kryetari e dinë se aty për atë shkollë janë dedikuar 2,000,000.00€, ka kompani që ka konkurruar me çmime 1,900,000.00€, 2,000,000.00€, 2,200,000.00€, që nuk i kanë tejkaluar shumat, kurse prej Komunës tenderi i është dhënë kompanisë në shumë 2,600,000.00€ dhe pastaj kur është bërë ankesë nga operatori me çmim më të lirë, oferta më e shtrenjtë është anuluar.

Sa i përket ndërtimit të parkingut nëntokësor, Kryetari i Komunës e dha përgjigjen kurse sa i përket pastrimit të objekteve komunale në vlerë prej 28,000.00€ është për çudi, sa di unë Komuna ka persona punëtor të punësuar për pastrim të objektit, andaj përse të jenë edhe këta punëtor edhe kompania, tani shtrohet pyetja se a e kryejnë punëtorët e Komunës këtë punë apo ata të kompanisë apo punëtorët e Komunës vetëm vijnë në punë e dikush prej tyre duhet ta kryej këtë punë.

Sa i përket mirëmbajtjes së fontanave të qytetit, të gjithë ne e dimë që janë dy fontana por tenderi është dhënë në shumë 8,160.00€, në atë fontanë ekzistojnë dy pompa në shumë prej 30€, dhe 3-4 drita me çmim 2€ ose 3€ dhe tani paramendojeni mirëmbajtja e fontanave në shumë 8,160.00€.

Sa i përket punimit dhe montimit të reklamave 3D me konstrukcion metalik në shumë 9,614.00€, edhe kjo kontratë për mendimin tim është shumë shtrenjtë, jo që është projekti i keq por është tepër shtrenjtë. Pika tjetër që është vënia në funksion dhe kontrollimi i sistemit të ujit, këtu bëhet fjalë për sistemin në shesh që janë të mbjellë drunjtë e sheshit, shuma 804 € nuk e di a e ka dikush ndokënd duke i kontrolluar ato sisteme të ujitjes sepse njëra anë është në funksion dhe drunjtë dekorativ ujitën kurse ana e sipërme është jashtë funksionit, këtu nuk e kam pa kurrë dikë duke punuar. Pastaj kemi pikën tjetër që është furnizimi me bimë dhe vazo të ndryshme për objektin e komunës në vlerë 7,000.00€, prej se vijë këtu si anëtar i Kuvendit sepse më parë nuk kam qenë dhe nuk është se kam ardh ndonjëherë në Komunë, të njëjtat lule i kam parë edhe sot edhe atëherë, andaj 7,000.00€ më duken shumë.

Te ndërtim i Rr.“Xhemajl Mustafa”, Kryetari nuk e di a gaboi kur e tha që kjo rrugë ka përfunduar, besoj se ka gabuar sepse projekti është në vlerë 351,904.00€, afati është 15 muaj, kontrata është nënshkruar më 21 korrik tani thuajse 6 muaj kanë shkuar, dashtë Zoti përfundon edhe kjo rrugë me kohë edhe pse për mendimin tim ajo kompani nuk është dashtë të shpërblehet me këtë tender sepse e kemi parë të gjithë në Rr.“Skënderbeu” për tri vite.

Sa i përket furnizimit me lëndë djegëse dru, edhe këtu ka pas kompani që ka ofruar ofertën prej 162,000.00€, kurse tenderin e ka fituar kompania tjetër në vlerë 260,000.00€, nuk e di përse në Podujevë nganjëherë kur ta shohësh faqen e prokurimit të jep mendimin se gjithmonë fiton ofertuesi më i shtrenjtë, e jo ai më i liri dhe për këtë çështje para rreth viti i kam thënë Kryetarit pastaj ka vazhduar ky avaz dhe është ndalur.

Furnizimi me perde 17.985.00€, më është bërë merak ta di se ku janë këto perde, pastaj furnizim me mjete pune edhe këtu për një vit rresht jeni duke u ndjekur me procedura ku komisioni i Komunës ia jep tenderin 171,050.00€ një operatori më të shtrenjtë, ankohet operatori që ka ofruar ofertën 140,000.00€ dhe krejt viti shkon dhe në fund OSHP vendos për ofertuesin më të lirë.

Po ashtu kemi disa pika interesante siç është ndërtimi i trotuareve në qytet dhe fshatra, një tender del ndërtimi i trotuareve në qytet dhe fshatra 188,681.00€, tenderi tjetër del ndërtimi i rrugëve me element betoni, edhe te këto trotuare pra janë munduar që veç emërtimet t'i ndryshojnë si me elemente betoni, kubëza, trotuare, në vlerë 458,371.00€, kurse pika tjetër del ndërtimi i trotuareve në qytet në shumë 349,896.00€, këtu 996,948.00€.

Kemi edhe çështjen e Këshillave lokale, nuk e di pse është ndërpre ky proces qe 6 muaj dhe ka ngecë si proces edhe pse ne si komision e kemi përfunduar një punë goxha të mirë, por që punën tonë nuk e vlerësoi askush. Për sjelljen e raportit financiar janar-shtator 2023 sigurisht Kryetari i Komunës është në dijeni që Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë e obligon. Çështje tjetër është edhe oborri i Komunës dhe këtu është një befasi 144,300.00€, neve atje na merr uji nga vërshimet, kurse këtu asfalt ka qenë, është ndërruar dhe po bëhet beton, njësoj.

Kryetari i përmendi disa rrugë siç ishin asfaltimi i rrugëve në fshatrat Buricë, Kunushëfc, Sibofc, Kaçybeg, njëherë në fillim mendova se goxha mirë janë asfaltuar këto rrugë, mirëpo me zbritjen e temperaturave rruga që vien për në fshatin Sibofc është në gjendje të mirë kurse pjesa tjetër e rrugës nga fshati Kaçybeg edhe Drejtori i DSHPMSh z.Bahri Selimi është dëmtuar, pra këtu e kemi pas një lidhje mes fshatrave përmes kësaj rruge por siç duket ajo ka filluar të dëmtohet.

Më bërë përshtypje pika që e ceku Kryetari për drunjtë dekorativ, por që ky tender ka dështuar, ka dalë 3 herë, kanë qenë të dedikuara 130,000.00€, dy herë e kam parë se në këtë tender nuk ka aplikuar askush, arsyen nuk e di por që kam edhe disa pika tjera të cilat nuk po i ceku.

Projektin më interesant më duhet ta theksoi para jush sepse Drejtori i DPUMM-së nuk është korret edhe në rastet kur kërkojmë dokumentacione shtesë në mënyrë zyrtare, ato nuk na i ofron, bëhet fjalë për Rr.“Skënderbeu” prej ditës kur është nënshkruar kontrata sot janë 566 ditë dhe nuk e dimë

zyrtarisht se a ka përfunduar ndërtimi i kësaj rruge, projekti ka qenë i paraparë të përfundoj për 210 ditë, çka ka ndodh në këtë projekt është shumë interesant kush e ka përcjellë, nuk e di qysh ka mundur drejtori i cekur ta ndërroj projektin komplet, shembull njëri prej dokumenteve është ky këtu (prezanton fizikisht) i cili tregon saktësisht çka do të bëhet, kah do të bëhet shtrimi i trotuarit, hapësira e gjelbëruar, sa do të jetë shtegu i biçikletave, këtu në projekt shkruan se në njërin anë duhet të jetë shtegu i biçikletave, duhet të jetë një metër hapësira e gjelbërimit dhe në anën tjetër një metër shiriti i gjelbëruar, kurse ky drejtori e ka heq gjelbërimin. Statuse në facebook poston nganjëherë që duhet të jetë hapësira e gjelbëruar, mirëpo ky i ka heq krejt dhe i ka bërë trotuare, pastaj mënyra qysh janë shkruar tenderët dhe pagesat se di a guxoi me i përmend edhe njëherë, unë e kam komplet kërkesën për pagesa por është interesant çfarë “supermeni” kish qenë ai që i ka kryer ato punë, që 565 ditë nuk ka mund me i krye punët e tij, shembull tenderi kur ka dalë ditën që e ka nënshkruar kontratën, atë ditë i ka marrë edhe paratë, por atë ditë i ka heq edhe 140 kamionë me dhe pastaj ka pas ta bëj shtrimin me zhavorr, andaj nëse ka ndonjë kompani në Kosovë që i heq për një ditë ata kamionë me dhe, e fiton tenderin e vrapon për një ditë në zyre dhe e bënë kërkesën e nënshkruan dhe shkon e i heq gjithë ata kamionë me dhe edhe kthehet e i merr paratë, goxha interesant është kjo. Unë e kam shikuar se aty shkruan sa është gjatësia kur dheu hiqet mirëpo ata dhe nuk ekziston askund sepse nuk e ka heq asnjë kamion, por për punën e Rr.“Skënderbeu” unë edhe publikisht e them, dokumentet i kam kompletuar dhe do i dërgoj në prokurori, pastaj do e shohim se ku do mbërrijmë.

z.Arjant Topanica, theksoi, këtu para nesh na u reklamua një raport i suksesshëm, ku asnjë projekt nuk ka filluar dhe përfunduar me forcat vetanake të Komunës pa marrë mbështetje nga donatorët apo fonde tjera të OJQ-ve e që gjithsesi ashtu siç e ceku edhe shefi i Grupit të LDK-së, gjithë ata donatorë ne i falënderojmë për donacionet që i kanë dhënë Komunës së Podujevës por këtu po paraqitet një raport se çfarë është bërë me buxhetin e Komunës e që në buxhetin e Komunës nuk gjejmë asnjë projekt kapital që ka filluar dhe përfunduar me përjashtim të Rr.“Skënderbeu” që tashmë është në përfundim pas më shumë se 3 fishin e kohës së paraparë për ndërtimin e kësaj rruge.

Vlen të theksohet se në bashkëfinancim me OJQ-të janë realizuar projektet në fjalë; siç ishte ndërtimi i ambulantes, emergjencës, qendrës rezidente për të moshuarit, Qendrës së Mjekësisë Familjare në fshatin Gllamnik dhe disa projekte tjera, në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje të ligjit për bashkëfinancim dhe është shumë e rëndësishme të thuhet se kur Komuna bashkëvepron dhe bashkë financon me ndonjë OJQ në çfarë do projekti nuk guxon në asnjë mënyrë që mjetet e Komunës të transferohen në llogari të donatorëve dhe ata ta realizojnë punën, por duhet të jetë e kundërta nëse ndonjë OJQ apo organizatë tjetër ofron donacione për Komunën atëherë ato mjete duhet të kalojnë në llogari të Komunës dhe pastaj Komuna t’i realizon këto punë, e jo të ndodh e kundërta sepse është shkelje e ligjit. Duke parë se shumica e punëve të proklamuar janë në bashkëfinancim ndoshta kishte qenë më mirë të sugjerohet Kryetari i Komunës që me marrë ndonjë menaxher prej këtyre Organizatave për t’i kryer punët e Drejtorive sepse siç po shihet nuk janë të zotët t’i realizojnë punët e tyre për të cilat janë të thirrur.

Në mungesë të projekteve kapitale proklamohen si suksese shërbimet që i kryejnë drejtoritë për çka edhe paguhen ato, pra nuk mund të jenë projekte shërbimet që bëjnë Drejtoritë përkatëse dhe këto nuk janë të arritura sepse janë shërbime të cilat kryhen dhe për atë paguhen ato.

Sa i përket DBPZHR-së, 90% e mjeteve janë të ndara nga Organizatat e jo nga Komuna, ku nuk ka projekte zhvillimore për bujqit Llapjan, nuk është ndarë asnjë cent i vetëm për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, nuk është mbajtur asnjë panair, nuk është bërë asnjë hap në shkëmbimet e përvojave me Komunitat tjera dhe me ekspert të fushave përkatëse për të sjellë praktika të mira për

bujqit tanë, po ashtu nuk ka lehtësim në procedurat për aplikim në subvencione që ka qenë kërkesë e kamotshme e bujqve.

Sa i përket Drejtorisë së Arsimit, jemi dëshmitarë dhe po shohim për ditë degradim të arsimit ku po bëhen dhe punësime duke mos përfill as më të voglin kriter duke rehatuar familjarë dhe të afërmit e pushtetit, vonesa në kompletim të stafit që rezultojnë në humbjen e qindra orëve të mësimi, mandej kthimi nga Ministria e Financave i 35 mësimdhënësve për mos pagesë për arsye se është tejkaluar norma e punëdhënësve, si dhe praktika të kundërligjshme ku largohen nga lista e pagave mësimdhënësit në emër të pushimit pa pagesë e që kjo praktikë nuk ka funksionuar.

Te investimet, do i përmendja investimet në fshatin Sfeçël në vitin 2023, nuk ka pas as ndriçim e as rregullim të trotuareve, edhe përkundër disa kërkesave që kam paraqitur për rregullimin e ndriçimit, pra të bëhet riparimi i sistemit të ndriçimit sepse ka prishje të vazhdueshme të rrjetit të ndriçimit, madje ka rreth 5 muaj që një dritë ndizet dhe fiket pa ndërprerë por nga ana e Drejtorisë përkatëse nuk ka as edhe një intervenim në këtë drejtim. Nga fshati Ballofc kemi kritika të shumta për arsye se nuk është bërë asnjë vizitë nga kjo qeverisje, nuk ka asnjë investim që vlen të përmendet qoftë në ndërtim të trotuareve, ndriçimit publik me përjashtim të pjesës së Kalas së Ballofcit që këtu po i thuhet si fshati Shamalluk e që sa e di unë në Zonën Kadastrale të Republikës së Kosovës brenda saj nuk ekziston një Zonë Kadastrale me emër Shamalluk, por është një fshat që gjendet në anën tjetër të shtetit të Serbisë, pra Zonë Kadastrale nuk kam hasur në një fshat që quhet Shamalluk kurse këtu po proklamohet se po bëhen investime në fshatin Shamalluk. Po bëhen disa investime për disa interesa në disa zona që janë të mbrojtura me ligj dhe nuk ka asnjë investim në pjesën tjetër të fshatit, për këtë arsye kam marrë edhe shumë shqetësime nga ky fshat.

Sa i përket Zonës Industriale, u cek se ka disa mangësi dhe ngecje në këtë drejtim mirëpo Kryetari e ceku se në fillim të vitit të ardhshëm pritet të bëhet implementimi i kësaj Zone, kurse për vitin 2024 janë ndarë vetëm 600,000.00€ për implementimin e këtij projekti e që mendoj se me 600,000.00€ në Zonën Industriale nuk mund të kryhet asnjë punë, madje as lëvrimi i asaj pjese nuk mund të bëhet me këto mjete, ndoshta as nuk mund të nevojiten për rregullimin e infrastrukturës së një pompe private të benzinës e lëre më për infrastrukturën e një Zone Industriale e që deri më tani e dimë se këto Zona Industriale nuk janë të suksesshme, pra kemi raste edhe nga komunat tjera që nuk janë shumë të suksesshme dhe nuk e dimë se kur do të përfundoj ky projekt.

Nuk do e zgjas më shumë debatin, mirëpo këto janë defektet, mangësitë dhe pa aftësitë e kësaj qeverisje që të realizoj projekte madhore, projekte kapitale me buxhetin tonë të taksapaguesve të Komunës së Podujevës.

z.Ragip Fetahu, theksoi, më lejoni që së pari ta sqarojmë një çështje në lidhje me donatorët, shpesh është përmend këtu që asnjë projekt i Komunës nuk është bërë pa përkrahje apo pa bashkëpunim me donator dhe bashkëpunim me partner etj. Fati është që është aftësi e secilit individ apo institucion që të krijoj raporte bashkëpunimi, bashkëfinancimi me individ, organizata, OJQ dhe institucione tjera, kjo tregon që është një aftësi e kooperimit e bashkëpunimit me organizata tjera. Për dallim nga qeverisjet e kaluara që kanë qenë në Komunën tonë, qeverisja aktuale bën projekte në vazhdimësi në interes të qytetarëve dhe komunitetit, pra projektet nuk bëhen vetëm në vitin e fundit zgjedhor apo në fushata zgjedhore, projektet bëhen në vazhdimësi dhe kontinuitet ku çdo vit ka projekte shumë të mira që prekin direkt jetën e qytetarëve dhe ka projekte të cilat e lehtësojnë jetën e tyre.

Ajo e cila sot po më befason është kjo modestia e drejtorëve të cilët nuk po e paraqesin punën që e kanë bërë sepse ka punë të shkëlqyeshme, nuk ka vetëm zi në Komunën e Podujevës me të vërtetë është duke u bërë një punë e mirë, janë duke u prekur zonat rurale dhe ato urbane me investime kapitale të cilat i kërkojnë qytetarët. Ndoshta një mangësi e Ekzekutivit ose e drejtorëve në këtë

proces është dhe ky “mish mash” që po bëhet këtu se gjoja nuk po bëhet asgjë, këtu ka të bëjë me informatat e dërguara në Kuvend nga Drejtoritë përkatëse, pra drejtorët e Drejtorive përkatëse nuk kanë sjellë informata në këtë Kuvend që të tregohet dhe të jepen qartësi për punën, angazhimin dhe projektet që po bëhen në nivel lokal. Ka investime shumë të mëdha, ka investime shumë të mira në të gjitha fazat në të gjitha vendet në gjithë territorin e Komunës tonë, mirëpo kjo punë nuk po paraqitet, nuk po proklamohet dhe nuk po i’u tregohet qytetarëve të zonave të caktuara që është duke u bërë punë. Problemi është te drejtorët të cilët nuk kanë paraqitur informatë vjetore për punën e tyre, për këtë arsye po i japim mundësi dhe hapësirë gjithë parafolësve që të përdoret kjo mangësi politikisht sepse me të vërtetë ka investime, ka projekte shumë të mëdha që duhet të bëhen në Komunën tonë, mirëpo mungesa e informatave nga drejtorët për këtë Kuvend po përdoret politikisht dhe me të vërtetë tani kjo duhet të tregohet nga gjithë drejtorët për punët që janë bërë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, kolegut z.Ragip Fetahu ndoshta i duket shumë, unë ndoshta nuk e përmenda por pozita është për të treguar cilat punë i ka kryer, mirëpo opozita është t’i tregojmë se cilat punë si i ka krye pozita dhe cilat punë janë kryer keq. Në prokurim ishin 82 projekte që kanë kaluar kurse unë i preka 20, nuk thash 80 dhe as nuk e thash se janë të gjitha zi apo të gjitha janë keq, ka punë që janë punuar, ka prej tyre që janë punuar keq, ka që kanë dështuar, ato çka i ka punuar mirë të tregon Kryetari. Ne opozita këtë punë e kemi.

Meqë e kam fjalën, kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit që nëse e shohim të arsyeshme shumica, të shkojmë në një pauzë sepse është koha e drekës.

z.Naim Çunaku, theksoi, po e shohë se një pjesë e madhe janë lodh dhe po sa e kanë kryer fjalimin e tyre kanë shkuar në drekë, mirëpo ne kërkuam para orës 12 të shkojmë në pauzë dhe tani nuk është e ndershme t’ia ngushtosh hapësirën tjerëve pse dikujt i është bërë boll. Po dua të jem sa më i shkurtër dhe s’dua të përmend asnjë nga ato që u përmenden në këtë foltore, por po mundohem edhe unë t’i paraqes vërejtjet dhe sugjerimet, pse jo edhe lëvdatat.

Raporti për gjendjen ekonomiko financiare dhe raporti i realizimit të projekteve dhe për dinamikën e realizimit të projekteve është një obligim ligjor, Kryetari i Komunës e paraqiti raportin para nesh, gjegjësisht gjendjen ekonomiko financiare, mirëpo t’i bashkëngjitem asaj se nuk është bërë asgjë nuk mundem, arsyeja pse s’mundem është sepse ky Kuvend e ka miratuar një projektbuxhet prej 27,000,000.00€ që është realizuar në këtë vit dhe 27,000,000.00€ është e pa mundur pa lënë gjurmë qoftë në vlerësim, qoftë në përmirësim të infrastrukturës por sigurisht se e ka përcjellë edhe një mori defektesh. Defekti kryesor për mendimin tim është problemi me kapacitetet humane, kapacitetet humane në Komunën e Podujevës t’i cilësosh se i kemi të mangët nuk e di a i bëjmë nder Komunës së Podujevës, e them këtë sepse si Komunë e Podujevës ku po kemi disa data të rëndësishme historike ne po dimë të tregojmë që kemi qenë bazë, celulë dhe shembull që na kanë ndjek edhe në nivel të Republikës së Kosovës, ndërsa a ka të përshtatshëm apo jo kjo është diçka tjetër. Vërtetë për mendimin tim nuk mundem mos me i pa defektet, por për ata që janë aty nuk i numërojnë defektet, ndoshta i numërojnë. Përparësia logjika e Ekzekutivit fshihet pas partisë politike dhe si e atakon punën e tij, kurse ai thotë po ma sulmoni partinë, andaj e them harrojeni këtë praktikë.

Ne këtu nuk jemi në garë politike, por në role të ndara Kuvend - Ekzekutiv, detyrë primare e Kuvendit është monitorimi i punës së Ekzekutivit dhe nëse ndonjë punë jo të mirë të Ekzekutivit arrijmë ne që me vërejtjet tona ta përmirësojmë, mendoj se është në dobi edhe të atij subjekti që ai e përfaqëson, nga cilido subjekt qoftë ai, sepse nuk jemi këtu veç si numër. Në këtë kontekst po e nisë me një shembull, një diçka që nuk do të doja ta bëjë temë por vërtetë që më shqetësoi fakti që sot në mëngjes kur unë e fus veturën brenda oborrit / parkingut të Komunës del dikush dhe debaton me mua (andëj këndeje) dhe harron që vendimet e Kuvendit e obligojnë atë, nuk mund të

më shitet mua ai person duke bërë cilësime se është me LVV-në apo me LDK-në, apo pse ky e pse ai, dhe të silltet në kundërshtim me vendimet e Kuvendit, harrojeni këtë praktikë. Përndryshe edhe ne mund të shprehim arrogancë dhe nuk e di pastaj se ku do dalim, nuk po përmendi asgjë tjetër.

I nderuar Kryetar, pa qare më duhet të përmend një diçka që ka ndodh për herë të parë në këtë dy vjeçar të qeverisjes së këtij Kuvendi të Komunës të cilit i është pamundësuar të ketë qasje në dinamikën e realizimit të projekteve dhe me gjendjen ekonomiko financiare në raportin 9 mujor, pra a jeni në dijeni Kryetar se Ekzekutivi juaj nuk ka paraqitur raportin 9 mujor financiar para Kuvendit të Komunës, dhe kjo është shkelje ligjore, diçka që nuk u përmend deri tani sot.

U përmend dhe më bëri përshtypje mos fillimi i realizimit të projektit të Parkingut nëntokësor në shesh dhe vërejtja se në atë projekte fillestare ka qenë një projekt për ta ruajtur emrin e sheshit, andaj në këtë çështje i nderuar Kryetar ju bëj apel që nuk guxojmë të lejohet ndërtimi i hapësirave biznesore në lartësi 3m, nuk është më shesh pastaj. Çështja është se ndërtimi i parkingut nëntokësor e humb funksionin dhe emrin e sheshit sepse aty pastaj krijohet një qendër tregtare.

Në qoftë se është nevoja të bëhet për 2 apo 3 vite me buxhet vetanak të Komunës sepse ai projekt kur realizohet nuk do të jetë vetëm për një gjeneratë dhe nuk bëhet nga kjo përbërje e këtij Kuvendi ose Ekzekutivi, por të lëmë shembull një projekt të tillë të realizuar, përndryshe nuk kisha dashtë të lëmë një projekt të realizuar keq sepse ndërtimi i lokaleve 3 m mbi sipërfaqe është ide shumë keq për mendimin mua.

Sa i përket riparimit të rrugëve, e paraqiti edhe Kryetari i Komunës si vërejtje e që vërtetë nuk e kemi gjendjen mirë, madje nëse mund t'i thërrasim memories kur kemi pasur raportin për projektbuxhetin e Komunës një prej kërkesave ka qenë që të ndahet më shumë buxhet në mirëmbajtjen dhe meremetimin gjegjësisht në realizimin e projekteve sidomos në infrastrukturën rrugore shkak i mos interesimit të operatorëve ekonomik.

Për fund kam edhe një apel ngase ne jemi në role të ndara këtu sepse demokracia kur është paraparë i ka nda këto role me qëllimin më të mirë që do t'i kontribuohet një zhvillimi, një qëndrimi, një mirëqenie, një shoqërie më të shëndosh dhe nuk guxojmë të kemi inate dhe teke personale për punë, mirëpo të gjithë që jemi zyrtarisht këtu thirrëmi në përfaqësim të qytetarëve.

Nuk dua të përsërisë diçka tjetër nga ato që u potencuan, mirëpo krejt shqetësuese ishte mos sjellja e raportit 9 mujor financiar, si dhe çështjet tjera që i ceka.

z.Haki Rudari, theksoi, natyrisht se e kuptoj opozitën sepse kemi qenë opozitë, por megjithatë këto që u potencuan nga ana e Kryetarit të Komunës, ju lutem thujeni diçka që është e pa saktë, diçka që nuk është bërë, shembull po filloj nga Drejtoria e Administratës ku janë avancuar shërbimet e sistemit digjital, pastaj në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave janë më shumë se 400,000.00€ të hyra vetanake më shumë në vitin 2023, tani më thuaj dikush se nuk janë bërë këto, janë gjëra të cilat unë i marr dhe i identifikoj. Mandej në Drejtorinë e Arsimit kemi furnizimin me inventar, kabinete, ndërtim të çerdheve, shkollave e të tjera, këto janë investime që janë bërë në shkolla. Mandej kemi Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale e cila ka ofruar 241743 shërbime për qytetar e që është jashtëzakonisht një numër i madh sikurse që Qendra për Punë Sociale ka ofruar 48613 shërbime, pastaj shërbimi mobil që është shumë i rëndësishëm numëron 7763 shërbime që ka ofruar. Vërtetë këto janë projekte për qytetarin, në gjithë sektorët, sigurisht tani edhe drejtorët e Drejtorive do ta marrin fjalën dhe të paraqesin investimet dhe projektet në interes të qytetarëve.

Unë e kuptoj opozitën, megjithatë diçka që është e vërtetë nuk mund t'i them që nuk është e vërtetë, prandaj në këtë kontekst desha të bëj këtë reagim në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së. Thuajeni këtu për diçka që nuk është realizuar unë do të pajtohem me ju, por do të thotë se ju asgjë nuk po mund të demantoni që nuk është bërë, përveç asaj që si opozitë ju kuptoj.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, pasi shefi i Grupit të LVV-së po kërkon të jemi sa më konkret, unë po e bëj një pyetje shumë konkrete, në institutin GAP që është një matës i performancës së komunave, prej 61 premtimeve janë realizuar vetëm 19, a do t'i mjaftoj këtij Ekzekutivi një vit e gjysmë për t'i përfunduar të gjitha projektet që i ka premtuar.

z.Naim Çunaku, theksoi, po i them dy fjali me qëllimin më të mirë, ne Grupi i LDK-së e mbështetim propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronave të Komunës, prandaj pyetja është sa prona i keni dhënë në shfrytëzim këtë vit. Vërtetë kemi defekte dhe të gjithë këtu deklaram se ato prona na krijojnë të hyra, mirëqenie dhe zhvillim ekonomik, andaj sa keni arrit t'i jepni në shfrytëzim ato prona nga ato që i kemi pas në vitin e kaluar, po ngeçim, nuk jemi në hap.

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i DPUMM, theksoi, çështja që u ngrit për Rr.“Skënderbeu” është e vërtetë që ka pas ndryshime të projektit që është punuar nga kompania, kështu që në fazën e parë para se të shpallet në prokurim ka pësuar ndryshime mirëpo këto ndryshime normalisht nuk kanë qenë thelbësore, kanë qenë ndryshime minimale si pasojë e kërkesës së bizneseve ku një pjesë e shiritit të gjelbërimit është zëvendësuar me pjesën e shtegut për ciklistë dhe normale edhe pjesa tjetër që ka mbet të mbjellën drunjtë çka nënkupton se pak a shumë jemi munduar që të ruajmë edhe pjesën e gjelbërimit por normalisht duke e funksionalizuar me pjesën tjetër të shtegut për ciklistë. Në realizimin e këtij projekti ka pasur edhe vonesa të cilat janë shkaktuar jo çdo herë me fajin tonë. Vonesa më e madhe që na ka shkaktuar në realizim të këtij projekti është KEDS që tani ka afërsisht një muaj që mezi e ka përfunduar këtë projekt. Kemi pas sa herë e sa herë kontakte edhe me pjesën e strukturës së KEDS ku veçse janë munduar ta përfundojmë këtë çështje.

Çdo qytetar që kërkon qasje në dokumente, ne veçse i ofrojmë dhe jemi të obliguar ligjërisht, mirëpo tani më duhet t'i përgjigjem gjithsesi njërit prej parafolësve, qasja është ofruar përmes USB-së me të gjithë dokumentacionin, unë veçse e ruaj edhe për një fazë tjetër që në rast se kërkohet të verifikohet apo si fakt i ofrimit të të dhënave përmes USB se çfarë ka ndodhur edhe me materialin tjetër të Rr.“Skënderbeu”, ne siç e dimë edhe Komuna ka mungesë të pronave dhe në fazën fillestare kemi dërguar në pjesën e poshtme që Komuna ka një pronë, tashmë jemi duke vazhduar në pjesën ku kompania “Pastrimi” e ka pjesën e lokacionit të administratës së tyre.

Një pyetje tjetër që u bë për rrugën tjetër lidhëse që është nga Rr.“Shaban Shala” deri te Rr.“28 Nëntori” ju informoj se në fazën e parë ne kemi paraparë për shkak edhe të kostos financiare të shpronësimit ta përfundojmë Rr.“Vëllezërit Frashëri” që lidhet me rrugën magjistrale kurse në fazën tjetër sigurisht se do të vazhdohet edhe Rr.“Shaban Shala” deri te Rr.“28 Nëntori”.

znj.Adelinë Stublla, drejtoresh e DSHMS, theksoi, ju falënderoj shumë që po merreni me çështjet e shëndetësisë, ju kuptoj se jeni opozitë, kam qenë edhe vetë opozitë por shumicën e rasteve nuk duhet parë vetëm zi por duhet parë edhe gjëra që janë bardh dhe që janë duke u kryer.

Nga asamblisti z.Valon Demolli u përmenden disa çështje që pata mundësi t'i evidentoj për shkak se isha në hapje të objektit të Kryqit të Kuq dhe nuk isha prezent këtu, por megjithatë disa nga to i kam shkruar. Ishte pyetja pse nuk është funksionalizuar Spitali, faktikisht jemi duke punuar në atë drejtim, është formuar grupi punues dhe jemi duke u marrë me këtë çështje për realizimin e Spitalit, faktikisht për shërbime ambulatorë që do të kryhen aty do të kemi diku rreth 5 specialist që do të punojnë me ditë të caktuara. Sa i përket drejtorit të QPS-së drejtoresha tani më është duke punuar në QPS edhe pse u cek periudha dy vjeçare por tani faktikisht është realizuar ajo çështje. Sa i përket punës së maternitetit që u tha se funksionon pa klimë, kjo nuk është e vërtetë sepse ka klimë, kurse rreth punës së liftave është në procedurë kështu që do të fillojmë me punën e zhvendosjes së tre liftave që janë faktikisht në defekt e të cilët i kemi gjet ashtu, ndërsa a i përket punës së presionit nga drejtori i QKMF që faktikisht u cek, unë i kam 20 vite përvojë punës dhe e

di se më parë ka qenë “sallamadi”, kështu që disave nuk po iu konvenon kjo çështje por megjithatë kur kesh të bësh me çështje të punës në shëndetësi duhet të ketë rend dhe rregull.

Sa i përket punës së rëntgenit në dhomë, këtë e kam cek dhe ju jam kundërvë për çështjen e opinionit publik si sqarim, kështu që nuk po e shohë të arsyeshme të jap përgjigje për shkak se kemi kufizim të kohës.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, dëshiroj të ndërlihem në disa çështje të cilat u ceken, u përmendën trotuaret që janë 3 kontrata të lidhura, nuk është e vërtetë që janë 3 kontrata por janë 2 kontrata, kontrata e parë e trotuareve është e lidhur në vitin 2022 dhe ka qenë dy vjeçare dhe ka përfunduar në këtë vit e që t’ju them të drejtën janë 10 km trotuare të ndërtuara me atë kontratë dy vjeçare që ka qenë. Kontrata tjetër është ndërtimi i trotuareve në qytet dhe sigurisht e keni parë që është bërë ky investim në Rr.“Hakif Zejnullahu”, pra të gjithë e keni parë çfarë punimesh janë bërë aty, është bërë trotuari i ri për herë të parë ndoshta edhe me korsi për persona me aftësi të kufizuara, është bërë shtegu i ri i biçikletave në atë rrugë dhe është bërë riasfaltimi apo shtresimi i rrugës në tërësi.

Te riparimi i rrugëve të asfaltuara e përmendi edhe Kryetari i Komunës i cili e potencoj shumë qartë se është një kontratë që ka ngecje paksa sepse nuk kemi mund t’i mbyllim gjitha gropat që janë të identifikuara, por ne si Drejtori dhe si Komunë e kemi bërë një punë të jashtëzakonshme në identifikimin e këtyre gropave e të cilat tani janë të digjitalizuara dhe i kemi që të gjitha të shenjzuara. Këtë vit nuk kemi pas mundësi t’i kryejmë punët për shkak të kushteve klimatike, mirëpo kjo kontratë vazhdon edhe vitin e ardhshëm deri në muajin gusht dhe ne me momentin e krijimit të kushteve atmosferike do të fillojmë me mbylljen e këtyre gropave që tani janë të identifikuara në mënyrë digjitale.

Te ndriçimi publik, sa i përket mirëmbajtjes edhe këtë e ceku Kryetari i Komunës sa trupa ndriçues janë ndërruar, është e vërtetë që ka probleme të shumta me ndriçimin publik, problemet vijnë për shkak të zgjerimit të madh të rrjetit ku janë mbi 150 km ndriçim publik në territorin e Komunës së Podujevës, 150 km janë shumë. Janë afër 10000 trupa ndriçues publik në territorin e Komunës së Podujevës dhe kur është një sasi kaq e madhe e trupave ndriçues sigurisht se ka edhe defekte të mëdha. Është dashur këtë vit t’i lidhim dy kontrata për mirëmbajtje të ndriçimit publik, kontrata që kemi pas të planifikuar nuk ka mjaftuar për t’i rregulluar të gjitha këto defekte që kanë ardh, dhe e kemi lidh kontratën e dytë dhe tani kur po flasim jemi në fazën e punimeve dhe është duke u kryer punë në rregullimin e ndriçimit publik.

Nuk po lëshohem në atë se sa është e suksesshme kjo Drejtori, u tha se nuk është bërë asgjë mirëpo me vet faktin që janë 23 kontrata të lidhura këtë vit dhe të gjitha të realizuara, nuk di çka me fol më shumë, projektet e mëdha si Drejtori i shihni vet çdo ditë duke u nisur prej Stacionit të Autobusëve, rregullimi i shtretërve të lumenjve ku është bërë një punë shumë e madhe si dhe projekte tjera që u ceken e që nuk dua t’i përsërisë.

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, dëshiroj të ndërlihem në çështjet e ngritura nga z.Valon Demolli dhe z.Arjant Topanica dhe atë për shkak të korrektesisë ndaj qytetarëve, më saktë ndaj fermerëve. Ndër disa çështje të ngritura nga ju, ishte edhe kompensimi i dëmeve, fillimisht sa për informacionin e juaj kompensimi i dëmeve bëhet prej nivelit qendror dhe jo atij lokal, çështje e cila u ngritë sot rreth kompensimit të dëmeve të vitit 2022 veçse u sqarua nga Kryetari i Komunës dhe që mos të bëhemi të tepërt me sqarime, kjo ka ndodh për shkak të gabimeve që Kryetari i përmendi, andaj nuk po e shtjelloj më tutje, por në parim ky kompensim bëhet prej nivelit qendror. Lidhur me çmimin e mëshqerrave siç ju e quajttët, nuk paskam parë fatura me atë çmim që ju e cekët, mirëpo vlen të theksohet siç edhe ju jeni të informuar se ky proces zhvillohet në mënyrë

publike dhe të hapur ku fillimisht shpallet thirrja dhe hapet tenderi, kështu që është një procedurë e hapur dhe transparente.

Çështja tjetër që ju shtjelluat apo e ngritët ishte edhe shpërndarja e mekanizmit bujqësor, në qoftë se vërtetë ekzistojnë raste të tilla dhe ju keni hasur në raste të tilla në ju ftoj në mënyrë publike që të gjitha këto raste t'i adresoni në DBPZHR duke i faktuar dhe dëshmuar me dokumente, dhe ne patjetër do marrim masat dhe veprimet e nevojshme ligjore. Ndërsa ndaj kolegut i cili përmendi se 90% e projekteve duke theksuar edhe DBPZHR-në kanë ardhur ose janë realizuar si rrjedhojë e bashkëpunimeve me donatorë, e kundërshtoj në tërësi për shkak se Kryetari i Komunës sërish i përmendi dhe bëri një përmbledhje të projekteve që janë realizuar nga secila Drejtori.

Unë po flas për Drejtorinë të cilën e përfaqësoj, kemi të paktën pesë projekte që janë realizuar nga buxheti i Komunës me participimin e fermerëve që është i rregulluar me rregullore e cila është votuar prej këtij Kuvendi dhe personave të cilët janë pjesëmarrës, ndërsa po, kemi edhe projekte që kanë ardhur në bashkëpunim me donatorë të cilën unë kisha dashtë t'i quaj si sukses dhe për t'u duartrokit kjo qeverisje që është e aftë dhe ka arritur sukses të sjell donator dhe të bashkëpunojnë me Komunën tonë, madje po e quaj më shumë sukses sepse unë kam ardhë që një periudhë të shkurtë, mirëpo tani që jemi në bisedime me donatorët për projektet për vitin 2024, po e quaj akoma më shumë sukses për faktin që donacionet po na vijnë pas një largimi që i ka shkaktuar qeverisja juaj, do të thotë e quaj sukses të dyfishtë që kemi arrit me i sjell këta donator.

z.Vigan Salihu, drejtor i DPZHE, theksoi, nuk dëshiroj t'ju mundoj shumë gjatë, por lidhur me lehtësimin e aplikimit për biznese dhe fermer për qasje në fonde publike e ceku edhe asamblisti Arjant Topanica.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, jam i gatshëm të jap përgjigjet dhe sqarimet për çështjet që u cekën, por po dëshiroj t'i dëgjoj fillimisht drejtorët e Drejtorive, kështu që keni durim edhe pak e pastaj e marrë fjalën.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryetar, bashkë po i dëgjojmë drejtorët e Drejtorive por nuk kisha dashtë me përmbyll edhe ju sikurse parafolësja sepse po të fillojmë të flasim duke thënë, edhe ju, nuk dua ngase ngushtohet prej kolegëve pastaj, andaj dhe nuk po jap emra konkret.

Pra kjo që po thuhet, edhe ju, nuk është e drejtë.

z.Vigan Salihu, drejtor i DPZHE, vazhdoi, në kuadër të lehtësimit të aplikacionit për biznese dhe fermerët për fondet publike në kuadër të DPZHE kemi angazhuar një kompani profesionale e cila vazhdimisht ka qenë e angazhuar në objektin e vjetër të Komunës ku rreth dy muaj vazhdimisht ka përgatitur plan bizneset dhe projektet adekuate për aplikim për fermer në mënyrë që ata të sigurojnë fonde prej nivelit qendror për të investuar dhe zhvilluar veprimtaritë e tyre.

Në kuadër të gjithë projekteve janë bërë aplikime gjithsej në vlerë 1,100,000.00€ dhe këtu parashihet që 50% prej tyre të zgjedhën përfitues që nënkupton rrjedhimisht të hyra për Komunën rreth 600,000.00€ shumë kjo e cila do të shpërndahet, do të thotë dikund do të blihet material ndërtimor, dikush do ta kryej mjeshtërinë apo punën e dorës dhe kështu me radhë.

z.Avni Fetahu, drejtor i DKA, theksoi, po mundohem të përgjigjem vetëm dy pyetje që u parashtruan sepse një numër i diskutimeve ishin supozime të cilat si supozime i keni dërguar edhe "te vendi" dhe po merrni me to, pra u përmend shkolla e mesme ekonomike dhe një projekt për perdet siç e quajti një asamblist.

Te shkolla e mesme ekonomike e dini që është një vlerë financiare rreth 2,000,000.00€ për shkak të objektit të madh që kërkohet dhe ka pas interesim të madh të kompanive, u përmend këtu që ka pasur pretendime për pazare mirëpo sikur të ishin bërë pazaret shkolla ish duke u ndërtuar tani, kështu që ne nuk jemi të pazareve, sikur të ishin pazaret ajo shkollë do të ishte duke u ndërtuar

tash, por për shkak që është një komision profesional i cili ka bërë vlerësimin e ofertave, mandej ka pas ankesa dhe ka kaluar faza qysh ka kaluar tutje.

Te çështja e perdeve, nuk është çështja që janë porositur për tu blerë perde por është një projekt që vërtetë ju kisha inkurajuar secilin prej juve të shkoni dhe vizitoni shkollën teknike, aty janë blerë perdet dhe pajisja përcjellëse të perdeve në shkollën teknike, ata e bëjnë praktikën aty në rrobaqepësi dhe pjesa tjetër e drejtimeve të makinerisë, dhe në bazë të kërkesave të shkollave për vënien e perdeve në shkollat e tyre dhe bëhet një praktikë dhe në të njëjtën kohë realizohet një përfitim më i lirë për shkolla. Një kalkulim që e kemi bërë me drejtorin e DBF-së për blerjen e perdeve vlera sillet mbi 50,000.00€, kurse për blerjen e materialit që i'u nevojitet nxënësve për të realizuar praktikën ka dalë që vlera e këtij projekt është 17,000.00€, kështu që ky projekt është për tu vlerësuar.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DKRS, theksoi, për mua nuk pati ndonjë pyetje konkrete, mirëpo ishte një konstatim i dikujt që e ceku se nuk ka pas panaire, mirëpo në fakt vetëm këtë vit janë mbajtur dy panaire të cilat janë quajtur panaire artizanale ku pjesa dërmuese e prodhimeve kanë qenë bujqësore, pra nuk është e vërtetë që s'ka pas panaire. Vetëm verën e fundit kanë qenë dy panaire në të cilat janë prezantuar kryesisht gratë që merren me bujqësi.

Sa i përket çështjes së fushës së sportit në fshatin Peran që u përmend duke thënë sërish që Komuna nuk i ka ndarë 100,000.00€ apo 200,000.00€, mirëpo Komuna e Podujevës e ka bërë një planifikim buxhetor në vlerë 450,000.00€, kriteri kryesor ka qenë çmimi më i ulët në total dhe bazuar në këto kriterie operatorët ekonomik (dhe për këtë e keni z.Ekrem Rrahmanin në Grupin e juaj i cili e njih procedurën e prokurimit dhe mund të sqaroheni), pra ai operator ka ofertuar me çmim sa ka dashur në pozicionet e tij dhe siç atij që i ka dalë tamam. Komisioni që e ka bërë vlerësimin e ka dhënë edhe një arsyetim për këtë çështje ngase me pretendimet e juaja për korrupsion dhe gjëra tjera, i keni futur edhe anëtarët e komisionit në situata të vështira ku i keni akuzuar në një mënyrë kinse edhe ata kanë keqpërdor, por ata vetëm e kanë zbatuar ligjin e prokurimit, kush do që dëshiron, qoftë në zyrë të prokurimit, qoftë në DKRS mund ta shihni gjithë dokumentacionin dhe nëse gjeni diçka inkriminuese qoftë për komisionin qoftë për DKRS-së dilni dhe qartësojeni, mirëpo shumat 100,000.00€ - 200,000.00€ apo 300,000.00€ janë politika të operatorëve ekonomik që i ofrojnë për pozicione të caktuara, në fakt në planifikimin tonë kompania ka ardh me ofertë 25,000.00€ më lirë se sa arkitektët e Komunës që e kanë planifikuar.

znj.Xhevdie Beqiri, drejtoresh e DA, theksoi, po përgjigjem shkurt për dy - tri çështjet e ngritura edhe pse parashtruesit e tyre tani nuk janë të pranishëm dhe është mirë kur parashtrojnë pyetjet të qëndrojnë në sallë e t'i dëgjojnë përgjigjet, por si do që të jetë përgjigjet nuk kthehen vetëm për parashtruesit e pyetjeve por për të gjithë qytetarët që na ndjekin.

U përmenden disa çështje që në administratë nuk është punuar asgjë, tash e një kohë të shkurtër unë jam emëruar në pozitën e drejtoreshës së Drejtorisë së Administratës, është punuar edhe më parë po punohet edhe tani dhe matësit më konkret dhe që shohin gjendjen faktike se çfarë shërbimesh dhe çfarë punësh kryen administrata, janë palët dhe qytetarët që prekin çdo ditë këto shërbime. U përmend kontrata e pastrimit të objekteve komunale dhe u tha pse lidhet kontratë kur ekzistojnë mirëmbajtëset e objektit, desha t'i përgjigjem parashtruesit të pyetjes se pastrueset që ekzistojnë brenda objektit të Komunës nuk mund t'i fshijnë dritaret e katit të parë, dytë apo katit të tretë, pra fjala është për pastrim të pjesës së jashtme të objektit, gjithashtu duke përfshirë edhe pastrimin e zyrave të vendit të gjendjeve civile të cilat ndodhen nëpër fshatra, po ashtu kjo kontratë është deri në vitin 2025.

Po ashtu u përmend edhe kontrata e furnizimit me lule dhe u tha se kjo kontratë e ka vlerën 7,000.00€, madje u cek se gjatë kësaj kohe i kanë parë lule vetëm në korridor, por fjala nuk është

vetëm për lulet që janë në korridor, edhe kjo kontratë është e nënshkruar deri në vitin 2025, dhe fjala është për të gjitha nevojat që kemi ne si administratë, qoftë për lule që i porosisim për homazhe, për seanca të ndryshme të Kuvendit e kështu me radhë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, drejtorët i lan shumë gjëra të mangëta ose sqarime pa dhënë e që sinqerisht i'u takon drejtpërsëdrejti atyre për të dhënë sqarimet, sinqerisht e them këtë, ose nuk po i shkruajnë pyetjet ose po i harrojnë, nuk e besoj se dëshirojnë t'iu ikin përgjigjeve ngase janë çështje të tyre dhe nuk mund t'i shmangen. Është shumë e mirë kuptueshme që si opozitë të jepni vërejtjet dhe absolutisht nuk kemi asgjë të keqe këtu, punët janë që duken dhe ne me diskutime këtu mund ta zgjasim edhe me ditë ndoshta, mirëpo prap janë qytetarët ata që japin vlerësimin final dhe unë besoj që ju bisedoni me qytetarët dhe keni kontakte të përditshme sikurse që edhe ne kemi kontakte dhe diskutime, dhe në një masë e dini deponimin e tyre dhe vlerësimin e tyre sepse ata janë matësit më të mirë të punës së këtij Ekzekutivi, prandaj mendoj se ndoshta nganjëherë mund të dilni më shumë keq me gjitha këto gjëra të zeza që po mundoheni të njollosni se sa që përfitonin politikisht, të jeni shumë të bindur për këtë, prandaj është mirë t'i themi gjërat ashtu siç janë, përndryshe ne të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet i marrim.

Gjatë raportimit në fillim, jo për ndonjë qëllim por harrova të përmend edhe dy çështje, fjala është për projektin e shkollës së mesme ekonomike dhe çështjen e drunjve dekorativ që si projekt dy ose tri herë është shpallë dhe nuk kemi çfarë të bëjmë më shumë ne, po të kishim procedura të mbi natyrshme që ne do t'i zgjidhnim problemet do ta bënim, ose formën qysh z.Ekrem Rrahmani del më komik, edhe z.Valon Demolli po, por ai (Ekrem Rrahmani) në veçanti po del komik me diskutimet e tij.

Po të jemi njerëz të pazareve ne, nuk do të dështonte procedura për projektin përkatës të shkollës cekur në këtë fazë sepse kemi të planifikuar shumën 2,000,000.00€, ndërsa kur keni bërë ju tenderët me shuma 1,000,000.00€ - 2,000,000.00€ kurrë kurë nuk ju kanë dështuar, krejt në vijë janë shkuar kurse tani neve po na dështojnë. Neve tani po na dështojnë disa tenderë sinqerisht, mirëpo po të kishim qenë të pazareve nuk do të dështonin sepse nuk i dështon askush 2,000,000.00€, a jeni duke e kuptuar këtë, madje ju e dini shumë mirë që unë po mundohem, por edhe nuk them që është gjithçka perfekt në Zyrën e prokurimit, as nuk them se nuk mund të ketë lëshime, mirëpo besoj që ju opozita në veçanti e dini shumë mirë kush i zhvillon procedurat e prokurimit, nuk i zhvillojmë ne, janë ata njerëz që kanë punuar deri dje aty dhe të cilët i kanë zhvilluar gjitha këto procedura, njëri prej tyre ka shkuar para disa kohe në pension, të tjerët prapë kanë mbet të njëjtit përveç njërit që e kemi dërguar ne aty të ri dhe ai ende është në praktikë profesionale dhe ende nuk ka mund t'i merr komplet kompetencat por ngadalë me kohë mësohet dhe i merr ato sepse nuk është e rëndë për t'u mësuar.

Në punën tonë ka lëshime dhe defekte, por ka edhe punë të mira të cilat është mirë t'i pranoni, madje ju opozita do të mund të fitonit më shumë nëse i pranoni ato, ndërsa në këtë formë qysh ju po i paraqitni çështjet veç po ia zgjatni vetës qëndrimin andej (opozitë), po t'i paraqitni reale mund të ndodh që qytetarët fillojnë t'ju besojnë paksa dhe ndoshta pas një kohe ua kthejnë besimin, besoj se po e kuptoni. Pra mos njollosni çdo gjë, e di që juve ju takon të bëni politikë dhe vazhdojeni bëjeni sa të mundeni nuk është problem, por ato çka janë të mira pranoni.

A kemi mungesë në kualitet, po, por në qoftë se shikojmë sot në Rr.“Skënderbeu” kemi një pamje të mirë që është bërë, nuk ka qenë kurrë kështu, nuk po e them që nuk ka ato defektet e veta dhe që nuk është përcjellë me problemet e veta gjatë punimeve ngase kemi pas zgjatje të punimeve, mirëpo ju e dini shumë mirë, në veçanti z.Naim Çunaku që është paksa më i vjetër si asamblist, pra zotëri Çunaku është në dijëni për gropat në vitet 2004 - 2005 të cilat për 4 vite kanë qëndruar, madje edhe gropa e mëdha (llagëmet) dhe jo vetëm këto biznese që janë por ka pasë edhe më

shumë biznese dhe ajo rrugë është pasivizuar pas një kohe dhe sigurisht që ka pas ngecje dhe probleme, mirëpo periudha kohore e kryerjes së punimeve është bërë nga këta ekspertë dhe profesionistë tonë por edhe ata të juaj më parë. E them këtë sepse nuk ka qenë e mundur për atë periudhë kohore qysh është planifikuar të bëhet ajo rrugë, pra nuk ka pasë asnjë logjikë që mund të kryhet ajo punë për atë periudhë dhe këtë sigurisht e keni parasysh, shto kësaj edhe telashet e mëdha që janë paraqitur me biznese (jo mos e vendos kënde, jo ngrite nivelin e rrugës më lartë e të ngjashme), nuk mund ta merrni me mend sa telashet janë zhvilluar gjatë punimeve në atë rrugë, prandaj ju them që sa do që doket i stërzgjatur ky projekt, është një projekt që është kryer goxha mirë me kohë, sepse ka pas gjasa që ende të zgjatet ngase ka pas shumë telashe me njerëz e në veçanti kur janë në pyetje bizneset, shto kësaj edhe KEDS-in e cila na ka shkaktuar bukur shumë telashe ku me muaj të tërë jemi marrë me këtë kompani, madje na është dashur të kontaktojmë edhe me kryeshefin e KEDS-it për të krijuar mundësi për zhvendosjen e rjetit të energjisë elektrike, mirëpo tani shohim se është hapë rruga, janë larguar telat dhe shtyllat elektrike, a është krejt perfekt mund të them se jo, nëse mendoni se janë bërë lëshime apo çfarë do tjetër që mendoni janë procedurat dhe mund të vazhdoni t'i paraqitni në prokurori, madje ju LDK-ja edhe ashtu jeni mësuar të dërgoni letra, prandaj dërgoni dhe ata merren pastaj me to, (nëse është ngrënë pitja tepsia ka mbet), mirëpo të thuhet se nuk është heq asnjë kamion dhe, kur e dini se prej ETC-së e deri te ura është heq komplet shtresa e argjilës e që askush nuk e ka planifikuar që do të del ajo shtresë, andaj arsyeja pse është dhënë pjesa shtesë ka qenë heqja e asaj argjile.

U përmend edhe materiali shtesë për shkollën në fshatin Obrançë, ju e dini shumë mirë z.Valon Demolli sepse je banorë i asaj pjese, çfarë kodrine është heq dhe sa dheu është heq për të filluar procesi i ndërtimit të shkollës e që jeni në dijeni që modeli i asaj shkolle është marrë nga modeli i shkollë së fshatit Ballofc, pra terreni ka qenë i rrafshët në Ballofc kur ka filluar ndërtimi i shkollës, por në Obrançë është dashur komplet me ulë kodrën për t'u larguar nga telat e rrymës dhe për të krijuar një pozicion më i përshtatshëm për ndërtimin e shkollës e që askush falas nuk e punon.

Pra ne nuk kemi mund të themi tash kur e mbaruam se e kemi marrë modelin që ka qenë terreni i rrafshët kurse tani ka dal terreni në kodrinë dhe duhet ta heqim atë pjesë të kodrinës ashtu siç e keni parë se duhet me heq komplet shtresën e oborrit për të krijuar hapësirë ngase nuk ka mund të lihet dheu aty e të hyjë të hyjë në objektin e shkollës së re ngase kemi bërë investim afër 500,000.00€ në atë objekt dhe tani nuk mundemi për 17,000.00€, 20,000.00€ apo 25,000.00€ ta lëm projektin keq.

Lëshime kemi, mbikëqyrje të mirë nuk kemi, menaxhim të mirë të kontratave nuk kemi, dhe gjitha këto unë jam duke i pranuar, por këta njerëz janë dhe nuk kemi çfarë të bëjmë, mirëpo domosdoshmërisht në vitin që do hymë nuk kemi rrugë tjetër përveç kontraktimit të një kompanie për t'i menaxhuar projektet, nuk mundemi me këta njerëz me i menaxhuar sepse njëri lidhet me Zyre të prokurimit, tjetri lidhet me operatorin ekonomik, tjetri andej, tjetri kënde, këta janë, këta inxhinier janë, këta njerëz janë nuk kemi të tjerë.

Këtë vit 4 ose 5 herë është shpallë konkursi për inspektor të ndërtimit dhe nuk vie askush të punoj me këtë pagë sepse e merr pagën tri herë më të mirë në sektorin privat, prandaj nuk vie askush për të marrë përgjegjësi, andaj keni mirëkuptim dhe përmendni gjithë ato çka janë defekte reale dhe nuk paraqet fare problem, ne jemi transparent dhe nuk e besoj që asnjëherë nuk keni pasë transparencë më të madhe, mirëpo nuk është në rregull z.Valon Demolli të thuash një herë ke raportuar, sepse tani edhe nga Ekzekutivi po njoftojnë që kam raportuar në muajin qershor, por ndoshta nuk ke qenë prezent, pra raportin e punës në muajin qershor e kam dhënë në këtë Kuvend, ka mundësi që ju nuk keni qëndruar në sallë, mos e keni lëshuar seancën rastësisht, unë nuk isha shumë i sigurt por e di që raport kam dhënë në Kuvend, mund edhe të ketë kaluar por nuk e besoj

që mund ta kem kaluar një situatë të tillë, ndoshta edhe ka kaluar por unë këtu jam çdo ditë dhe ka transparencë sa të doni dhe për çfarë të doni sepse nuk jemi duke fshehur asgjë besoni, madje keni mund ta shihni se veç në Podujevë po qëndrojmë, nuk po qëndrojmë në Prishtinë përveç gjumit që e bëjmë nganjëherë, pastaj as nuk po bëjmë pazare atje, krejt çka po bëhen këtu po rri tërë ditën me juve, me qytetarët, në këtë administratë dhe po mundohem natë e ditë të merrem me probleme të qytetarëve. Prandaj a ka pas problem për fontana në sheshe që u përmenden, ju them se ato fontana duhet të mirëmbahen sepse janë aparatura që prishen, gjatë verës ka pasë raste kur është ndërprerë komplet uji dhe nuk ka pas ujë as për ujitje të hapësirave të gjelbëruara për tri ditë radhazi gjë të cilën sigurisht keni mund ta shihni çfarë gjendje ka qenë, prandaj është dashur të bëhet rregullimi i atyre pompave në park e që është punuar me ditë të tëra për rregullimin e atyre pompave, prandaj këto janë punë që duken dhe jeni në dijeni shumë mirë që nuk mund të keqpërdoren ato mjete financiare sepse nuk i kemi nëpër xhepat tanë, janë procedura dhe raporte që duhet të arsyetohen përmes komisioneve që janë 3-4 komisione deri sa të procedohet për pagesë ngase nuk mundet askush të bëjë pagesa fshehurazi e as të marr para e as paratë t'i vë në xhirrollogaria private.

Pra ato çka janë për t'u thënë lirshëm thoni nuk ka problem sepse nuk jemi pa defekte absolut, kemi ndoshta edhe mungesë të përvojave nganjëherë, kemi nganjëherë ndoshta edhe pa përgjegjësi eventuale apo edhe jo mjaftueshme në shërbim të nevojave për njerëz, mirëpo vlerësimet përkatëse që u ceken janë vetëm tuajat e që është vetëm një vlerësim i një individi këtu që mendon se nuk është në rregull, unë pastaj mund të pajtohem ose jo me mendimin tuajin, por e rëndësishme është që në aspekt të përgjithshëm të kem vlerësimin pozitiv, ato punë t'i prekin qytetarët dhe të ecin proceset përpara.

U përmend edhe asfaltimi nëpër shi, është shumë e vërtetë por unë nuk jam ekspert i asfaltit, është inxhinieri që e mbikëqyr projektin dha ja këtu është me foto raporti i punës i paraqitur në Kuvend në muajin qershor, madje sigurisht që asambleisti z.Valon Demolli e din shumë mirë që ato automjetet e punës që e shtresojnë asfaltin, keni mundur të shihni se çfarë sasi të ujit lëshojnë përmbi asfalt gjatë tundjes së asfaltit, prandaj unë nuk jam duke u përzier në punën profesionale të njerëzve kompetent, ndërsa ju bëjeni punën e juaj si opozitë por mos dilni qesharak, sinqerisht e them këtë sepse po dilni qesharak para njerëzve, besoj po e kuptoni, përndryshe e drejtë e juaja është të na kritikoni e sulmoni për krejt këto, nuk ka kurrfarë problemi fare, madje po e vëreni që me sportivitet po i marrim këto gjëra, dhe a dini përse sepse përnjëmend nuk po thoni asgjë seriozisht, vetëm po dilni më keq jashtë dhe për këtë më besoni. Përndryshe ne jemi mbet miq dhe kritikohemi nuk është problem fare ne sërish pim kafe bashkërisht jashtë, sot këtu në këtë cilësi, ndoshta në të ardhmen mund të ndodh që unë jam në vendin e juaj kurse ndokush nga ju në vendin tim këtu, unë kështu siç e mendoj do të bëja përpjekje të jem sa më racional sepse sa më racional aq më afër reales, edhe pse normale opozitës i takon të ekzagjeroj paksa gjërat.

Për fund, vazhdoj të besoj se janë bërë disa punë të mira, ka nga pak edhe lëshime por duhet të bëjmë përpjekje bashkërisht që këto lëshime t'i mënjanojmë me qëllimin më të mirë që me dalë sa më mirë te qytetarët. Ju opozita punoni për zgjedhje, tani veç se kemi kaluar gjysmën e mandatit, mirëpo e rëndësishme është që për aq sa kohë sa jemi të lëmë punë dhe përshtypje të mirë bashkërisht për qytetarët, këto gjërat tjera ecin me kohën.

Unë e di që ju nuk jeni pa informata, ju japin informata për çdo ditë andej e këndeje prej dy anëve, nuk është me rëndësi kjo sepse për të gjitha këto jam shumë i vetëdijshëm, sikurse që edhe unë kam informata, madje ju e dini që për mua është shumë më lehtë sepse unë kam qenë aty gjatë, kemi qenë bashkë.

z.Valon Demolli, theksoi, tani ti i nderuar Kryetar po thoni që keni qenë gjatë aty, kurse më herët e cekët të kundërtën.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, po kam qenë aty, madje e di mirë se si funksionon, z.Naim Çunaku e din që unë kam përvojë të gjatë aty, gjitha i kam kaluar ato sfida.

Ju falënderoj shumë për kontributin e dhënë në krejt këtë proces, unë jam shumë mirënjohës për të gjitha vërejtjet të cilat i keni dhënë me vend, ju sugjeroj të mos jepni vërejtje kur nuk jeni të sigurt në gjëra sepse pastaj dilni keq para opinionit, kurse neve vetëm na ngritni dhe veten e ulni, ndërsa më besoni se unë dua ta kem një opozitë të fortë sepse një opozitë e fortë dhe e mirë më ndihmon shumë mua dhe anëtarëve të Ekzekutivit, ju ndihmon edhe asamblastëve që janë në pushteti për të qenë sa më aktiv për mbrojtjen e Ekzekutivit aty ku është e nevojshme.

Për fund, ju falënderoj shumë dhe njëkohësisht jua uroj vitin e ri, fat dhe mbarësi për ju dhe familjet e juaja.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, konsideroj se diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës përfunduan.

Meqë u kërkua një pauzë, atëherë mund të shkojmë në pauzë për 1 orë.

Mbështet propozimi për pauzë 1 orë, dhe atë nga ora 13:30.

Pas pauzës, mbledhja vazhdon në ora 15:00.

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, i cili fillimisht konstatoi kuorumin ku prezent për momentin janë 19 anëtarë/e të Kuvendit të Komunës e që ndër kohë mund të vijjnë edhe të tjerët.

Të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin anëtarët/et e Kuvendit, dhe atë:

Nga LDK, Valon Demolli; Edona Shabani; Donjetë Sheqiri; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Fahri Hasani.

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muqolli; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Arbnor Fazliu.

Të pranishëm ishin edhe drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Xhevdet Beqiri-Drejtorja e Administratës DA; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Pajtim Balaj-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Alban Zeka-Drejtorja e Inspeksionit DI; Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE

Gjithashtu të pranishëm në vazhdimin e mbledhjes ishin përfaqësues të mediave lokale (TV Llapi) dhe një numër i zyrtarëve komunal.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, vazhdojmë me mbledhjen aty ku kemi mbet në pikën e pestë të rendit të ditës, pikë e cila ka të bëjë me Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, andaj urdhëroni fjalën hyrëse e ka përfaqësuesi i Ekzekutivit të Komunës, përkatësisht drejtori i kësaj Drejtorie.

5. Propozim vendimi për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm

z.Leutrim Krasniqi, drejtor i DPUMM, e paraqiti fjalën hyrëse për këtë pikë të rendit të ditës, theksoi, me qëllim të avancimit të zhvillimit ekonomik, zhvillimi i Zonës Industriale është paraparë me Planin Zhvillimor Komunal-PZHK dhe me Hartën Zonale HZK.

Zonat Industriale shihen si mjet shumë efektiv për gjenerimin e vendeve të punës, përveç kësaj Zonat Industriale po ashtu luajnë një rol mjaft të madh në tërheqjen e investimeve të huaja duke ofruar infrastrukturë adekuate bashkëkohore të përcjell me politika stimuluese bazuar në praktikat botërore.

Në vazhdimësinë e punëve të cilat janë kryer për themelimin dhe ndërtimin e Zonës Industriale vie edhe hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm-PRRH të Zonës Industriale, dhe tani shtrohet pyetja cili është objektivi kryesor i PRRH të Zonës Industriale, për saktësisht është përcaktimi i normave dhe i rregullave për të lehtësuar zhvillimin e kësaj Zone.

Në bazë të Hartës Zonale Komonale në kuadër të Zonës Industriale përfshihen 61 hektar dhe duke marrë për bazë këtë funksioni primar i Zonës Industriale është pra prodhimi industrial, prandaj edhe do të tentojmë që gjatë procesit të hartimit të PRRH të Zonës Industriale të përcaktojmë çështjen e prodhimit me një përqindje sa më të lartë që është e mundshme, përderisa pjesa tjetër është në dispozicion për aktivitete të tjera shërbyese në funksion të prodhimit industrial.

Në kuadër të Zonës Industriale përfshihen disa shfrytëzime të cilat janë të lejuara e që në këto hyjnë; industri e lëndës së parë, industri e prodhimeve të lehta, prodhimi i energjisë së

ripërtëritshme, shërbimi tregtar, shërbimi profesional financiar dhe i informacionit, si dhe shërbime të tjera bujqësore.

Për shkak të natyrës së këtyre veprimtarive, normal edhe me Hartën Zonale por edhe me Planin Rregullues të Hollësishëm të Zonës Industriale parashihet vlerësimi i ndikimit në mjedis që mund të kenë këto veprimtari nga propozim vendimi i dërguar tek ju për shkak të verifikimit edhe njëherë që është në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë duhet të përfshihen disa ndryshme që kanë të bëjnë me mungesë të të dhënave grafike, e që janë:

Në Zonën Kadastrale Livadicë, saktësisht parcela me nr.229-0 zëvendësohet me parcelat me nr.229-2 dhe 229-3, pastaj parcela me nr.230-0 zëvendësohet me parcelat me nr.230-2, 230-3 dhe 230-4, si dhe parcela me nr.293-0 zëvendësohet me parcelën me nr.293-1, 293-2 dhe 293-3.

Prandaj marrë për bazë këtë, ju ftoj që ta votoni iniciimin e procedurës për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm të Zonës Industriale.

z.Naim Çunaku, theksoi, ne Grupi i LDK-së e mbështesim dhe do ta votojmë këtë propozim vendim për iniciimin e procedurës për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm të Zonës Industriale. Si pikë e rendit të ditës e formuluar linte dyshime se çfarë po rregullon ky plan, mirëpo nga fjala hyrëse e drejtorit parafolës u kuptua se ka të bëjë me Zonën Industriale dhe si e tillë asnjëherë në asnjë projekt që është për të mirën e qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe për të mirën e bizneseve që operojnë në Komunën e Podujevës gjithëherë do ta ketë mbështetjen e LDK-së e nuk ka si të jetë ndryshme edhe në këtë rast.

znj.Qëndresë Hajrizi, theksoi, duke pasë parasysh se Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave urbane apo zonave rurale siç është përcaktuar me Planin Zhvillimor Komunal për periudhën 2016-2025 si dhe në Hartën Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2022-2030, ne Grupi i LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë propozim vendim sipas kësaj pike të rendit të ditës, përfshirë edhe plotësim ndryshimet e propozuara nga drejtori i DPUMM në fjalën hyrëse.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 19 vota Për, nga anëtarët që ishin prezent miratohet Propozim vendimi për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje si dhe propozimit të drejtorit të DPUMM për plotësim ndryshime të disa numrave të certifikatave pronësore që janë në Propozim vendim, dhe atë:

-Certifikata pronësore me nr.00229-0, zëvendësohet me Certifikatat me nr.00229-2; 00229-3.

-Certifikata pronësore me nr.00230-0, zëvendësohet me Certifikatën me nr.00230-2; 00230-3; 00230-4.

-Certifikata pronësore me nr.00293-0, zëvendësohet me Certifikatën me nr.00293-1; 00293-2; 00293-3.

6. Drafti i Planit Operativ Emergjent Lokal – (Raporti nga konsultimi publik)

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, draft Planin Operativ Emergjent Lokal e keni marrë me kohë të gjithë besoj përfshirë edhe Raportin nga diskutimi publik, por sigurisht se edhe më herët e keni në posedim sepse ju është përcjellë kur ka qenë shqyrtimi për vënie në diskutim publik të këtij drafti.

Sa i përket këtij drafti mund t'ju informoj se si ka rrjedh procedurat, pra në muajin qershor kemi filluar me hartimin e këtij draft Plani ku e kemi formuar një komision komunal dhe në bashkëpunim me UNDP, Kryqin e Kuq Ndërkombëtar si dhe me Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave-AME. Pastaj kemi pasë 4 takime në formën e Workshop (punëtori) në të cilat është punuar deri sa është sjellë një draft i përbashkët në Komunën e Podujevës sikurse që është dërguar edhe në Komunitat tjera në nivel vendi, pra do të thotë se ka qenë një projekt i UNDP së bashku me Kryqin e Kuq dhe AME-në i përbashkët me Komunitat në mënyrë që të vijmë deri tek hartimi i një drafti të planit Operativ Emergjent Lokal.

Pasi është sjellë tek ne në Komunë Plani në fjalë, ne e kemi shqyrtuar dhe kemi bërë plotësim ndryshimet e nevojshme ashtu siç jemi udhëzuar nga AME dhe të njëjtin e kemi sjellë në Kuvendin e Komunës duke kërkuar që fillimisht si procedurë të del në konsultim publik, periudhë e cila e ka pasë afatin kohorë sikurse çdo dokument tjetër i ngjashëm prej 30 ditëve duke përfshirë edhe datën, kohën dhe vendin e diskutimit publik mirëpo fatkeqësisht ashtu siç po ndodh shpesh në diskutime publike edhe në këtë nuk ka marrë pjesë askush, por pavarësisht kësaj është bërë një raport nga komisioni përkatës dhe zyrtari i autorizuar i cili është caktuar nga DSHPMSH për të përcjellë këtë procedurë dhe për të hartuar raportin përkatës.

Pastaj ne jemi detyruar që bashkërisht me komisionin dhe në koordinim me AME-në, Kryqin e Kuq dhe UNDP-në të përfshijmë të gjitha sugjerimet që na janë dhënë nga niveli qendrorë ku si përfundim kemi dal me një Draft Plan final të koordinuar me AME-në e cila ka qenë përgjegjëse dhe bartëse kryesore e këtij draft Plani, dhe tani para vetës keni draftin final të Planit në fjalë për Komunën e Podujevës për të cilin kërkohet miratimi nga ana e këtij Kuvendi.

Shkurtimisht ju informoj se Plani Operativ Emergjent Lokal i Komunës së Podujevës ofron reagimin ndaj emergjencave dhe fatkeqësive me qëllim të shpëtimit të jetëve, mbrojtjes së shëndetit publik, sigurisë dhe të mirave materiale, restaurimin e shërbimeve esenciale dhe për të manifestuar dhe asistuar në rimëkëmbjen ekonomike.

Plani i cekur është i hartuar në harmoni me Ligjin për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, në pajtim me Sistemet e integruara të menaxhimit të emergjencave në Republikën e Kosovës si dhe në harmoni me Planin e Reagimit Kombëtar.

Për më shumë, koordinatori apo Ekipi emergjent i Komunës gjithashtu është i autorizuar që në koordinim me Kryetarin e Komunës të plotësoj apo amandamentoj Planin në fjalë sipas nevojës për ofrimin e sigurisë dhe shëndetit e vazhdueshëm të banorëve dhe të mirave materiale në Komunë. Për fund, ky dekret Plan hyn në fuqi me nënshkrimin e tij dhe mbetet në fuqi të plotë deri sa të amandamentohet apo shfuqizohet ky dekret me ndonjë dekret tjetër, pas miratimit Plani kërkon edhe nënshkrimin e Kryetarit të komunës dhe pastaj edhe ligjshmërinë nga Ministria përkatëse e që sigurisht besoj se është në rregull për shkak se është në koordinim të vazhdueshëm me Ministrinë, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe në fund bëhet i plotfuqishëm.

Kërkoj nga Ju që ta mbështetni, Komuna jonë ka nevojë për një Plan të tillë i cili ka marrë goxha kohë dhe punë deri sa është sjellë për t'u aprovuar, prandaj edhe kërkohet mbështetje.

z.Naim Çunaku, theksoi, sigurisht që në vazhden e përpjekjeve për hartimin e një plani që ka marrë kohë bukur të gjatë, madje edhe vite, por që shpeshherë në këtë foltore na është prezantuar herë që si Komunë kemi një plan të tillë e herë na është thënë se nuk kemi, mirëpo e rëndësishme është që komuna jonë po bëhet me Plan Operativ Emergjent Lokal dhe si të tillë sigurisht që e mbështesim plotësisht.

Arsyet nuk dua t'i cekë sepse veç i përmendi drejtori parafolës, vetë fakti që ka të bëjë me menaxhimin e emergjencave dhe është për situata të emergjencës e që vetë fjala emergjencë nënkupton situatë jo normale e shoqërisë, dhe po të mos ketë plan do të shkaktohej edhe menaxhim jo i duhur, edhe kaos në Komunën tonë, andaj si të tillë e përshëndesim dhe do ta mbështesim.

z.Ragip Fetahu, theksoi, Plani operacional për emergjenca lokale natyrisht se ka qenë domosdoshmëri dhe mbase është i vonuar por megjithatë si i tillë duhet të respektohet se si është sjellë nga Drejtoria përkatëse dhe ne Grupi i LVV-së e përkrahim fuqishëm.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, meqë nuk të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, atëherë e hedh në votim këtë propozim Plan sipas materialit përkatës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 18 vota Për, nga anëtarët që ishin prezent, me vendim miratohet Draft Plani Operativ Emergjent Lokal për Komunën e Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

7. Marrëveshja Kornizë e Bashkëpunimit Ndër-komunal Shumë-Funksional

(e lidhur mes 6 Komunave si në vijim: Kryeqyteti Prishtina; Komuna e Podujevës;

Komuna e Lipjanit; Komuna e Fushë Kosovës; Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Obiliqit)

z.Hilmi Hoxha, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kemi të bëjmë me Marrëveshje e cila është lidhë mes 6 Komunave, dhe atë; Kryeqyteti Prishtina; Komuna e Podujevës; Komuna e Lipjanit; Komuna e Fushë Kosovës; Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Obiliqit, Marrëveshje e cila është nënshkruar nga Kryetarët e këtyre Komunave. Për më shumë urdhëroni, fjala hyrëse nga Ekzekutivi i Komunës.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, kemi të bëjmë me një Marrëveshje Kornizë të Bashkëpunimit Ndër komunal Shumë Funksional e lidhur ndërmjet 6 Komunave të regjionit të Prishtinës, Marrëveshje e cila është iniciuar nga Komuna e Prishtinës si kryeqytet dhe si bartëse e regjionit të Prishtinës.

Marrëveshja fillimisht është sjellë si propozim nga Kryetari i Komunës së Prishtinës i cili është edhe bartës i kësaj Marrëveshje dhe i cili ka caktuar një Ekip Koordinuese - Teknike për hartimin e kësaj Marrëveshje, pastaj kemi marrë pjesë në disa takime të përbashkëta të regjionit me këto 6 Komuna nënshkruese që janë Kryeqyteti Prishtina; Komuna e Podujevës; Komuna e Lipjanit; Komuna e Fushë Kosovës; Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Obiliqit, dhe në fund kemi dalë me një Marrëveshje Kornizë për bashkëpunim ndër komunal, çështje të cilën nëse ju kujtohet fillimisht edhe inicimin e procedurës e kemi sjellë në Kuvend sepse ashtu kërkohet me legjislacionin në fuqi e që në atë kohë si Kuvend ka dhënë miratimin që si mundësi të iniciohet ajo Marrëveshje, pastaj është bërë hartimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjes dhe tani si procedurë kërkohet edhe miratimi nëpër Kuvendet komunale, gjë të cilën e kemi sjellë në këtë Kuvend dhe që po shqyrtohet tani.

Marrëveshja përfshinë 9 fusha, dhe atë: 1-fusha e mirëqenies sociale; 2-fusha e shërbimeve publike; 3-fusha e sportit; 4-fusha e kulturës; 5-fusha e arsimit; 6-fusha e shëndetësisë; 7-fusha e bujqësisë; 8-fusha e sigurisë dhe emergjencave, dhe në fakt pika 9-është Të Tjera e cila parasheh që nëse Komunitat e shohin të rëndësishme mund të bëjnë ndryshime dhe plotësime dhe ta fusin edhe ndonjë fushë tjetër në kuadër të kësaj Marrëveshje.

Besoj që materiali i kësaj pike ju është sjellë paksa me vonesë sepse kjo pikë është proceduar përmes KPF-së ku edhe është prezantuar në pika të shkurtra përmbajtja e kësaj Marrëveshje.

Te fusha e mirëqenies sociale, thuhet që palët pajtohen të bashkëpunojnë në ofrimin e strehimit të përkohshëm të personave në nevojë, nënat të cilat i nënshtrohen dhunës në familje si dhe nënat vetushqyese.

Te fusha e shërbimeve publike, thuhet që Komunitat pajtohen që të nënshkruajnë Marrëveshje për hartimin e një plani të përbashkët të mobilitetit i cili do të përfshinte të gjitha çështjet e ndërlidhura me trafikun dhe shtigjet për biçikleta. Në këtë fushë po ashtu palët pajtohen që bëjnë ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e përbashkët të mbeturinave më konkretisht deponitë e mbeturinave, përmirësimin e cilësisë së ajrit në mënyrë që të përmbushen standardet e BE-së si dhe rregullimin e ambientit përfshirë lumenjtë dhe ruajtjen e pyjeve duke ndërmarrë aktivitete të përbashkëta siç janë të shkruara në Marrëveshje.

Te fusha e sportit, thuhet palët nënshkruajnë pajtohen që të bashkëpunojnë për aktivitete sportive siç janë klubet e qyteteve si në organizime të përbashkëta ashtu edhe në mundësinë e shfrytëzimit të hapësirave sportive të ndërsjella.

Te fusha e kulturës, thuhet palët pajtohen që të nënshkruajnë marrëveshje për koncerte për rritur dhe fëmijë, festivale kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të tjera.

Te fusha e arsimit, thuhet palët pajtohen që të nënshkruajnë marrëveshje në rastet e emergjencave apo thënë ndryshe për mbrojtjen nga emergjencat që mund rrjedhin në arsim, pastaj për çështjet e sigurisë në shkolla përfshirë edhe shkëmbimin e planeve të veprimt, pastaj që të hulumtohen veprimet adekuate përfshirë edhe elementet financiare në mënyrë që të mundësohet që të gjithë nxënësit nga rajoni të regjistrohen në shkollat e mesme sipas zgjedhjes së tyre për çka sigurisht jeni në dijeni se ka qenë një problem i mëhershëm andaj me këtë Marrëveshje kemi mënuar ta zgjedhim atë problem që ka qenë ku nxënësit nuk mund të regjistroheshin prej një Komune në Komunën tjetër brenda drejtimeve përkatëse.

Te fusha e bujqësisë, thuhet organizimi i panairëve të përbashkëta ndër-komunale të prodhimeve bujqësore si dhe njësive agro përpunuese.

Te fusha e sigurisë së emergjencave, thuhet palët pajtohen që të koordinohen dhe ë reagojnë në mënyrë të përbashkët në rastet emergjente, të ndërtojnë një qasje të përbashkët dhe bashkëpunim të ngushtë për trajtimin e qenve endacak, problem ky i cili përveç që është problem në nivel komune e nivel regional por ky është problem edhe në nivel vendi si trajtim, madje është diskutuar shumë gjatë në këto takime sa i përket trajtimit të qenve endacak. Problemi i transportit të qenve endacak prej një komune në komunën tjetër ka bërë ndoshta që të jetë ndër pikat kryesore, andaj në kuadër të kësaj Komuna e Prishtinës veç është dakorduar që të ndaj një parcelë prej 10 hektarësh ku do të bëhet si park i kafshëve e në veçanti i qenve endacak por edhe të atyre me pronar.

Pra këto ishin në pika të shkurtra pikat apo fushat mbi të cilat do të bëhet ky bashkëpunim ndër-komunal përmes kësaj Marrëveshje e cila është e nënshkruar dhe vulosur nga 6 Kryetarët e Komunave në fjalë por që të gjitha këto Komuna duhet të kalojnë nëpër këtë procedurë që po kalojmë edhe sot.

z.Naim Çunaku, theksoi, Marrëveshja kornizë e bashkëpunimit ndër-komunal, sigurisht është e bazuar edhe në Ligjin për vetëqeverisjen lokale, e bazuar edhe në Kartën Europiane për Vetëqeverisjen Lokale e së fundmi e vendosur prej këtyre Komunave që janë fqinje.

Vërtetë që edhe nga hartuesi dhe projektuesi i kësaj sigurisht që kjo bërë me qëllimin më të mirë që të menaxhohen këto çështje sepse vërtetë kemi segmente të caktuara të qeverisjes për të cilat nuk mjafton kufiri komunal, e në këtë shembull e marrim rastin kur dikush mund ta pastroj lumin mirëpo ai lum vazhdon në Komunën tjetër, pa dashur të ndalem në çështjen tjetër që e cekur drejtori parafolës rreth transportit të qenve endacak e që unë tani me paksa humor po e them se nuk e di sa kushton transporti i qenve endacak, pra shembull kemi edhe këtë lëvizjen e qenve endacak nga një komunë në komunën tjetër, si dhe shumë e shumë raste dhe kategori tjera e që me një bashkëpunim të mirëfilltë të disa komunave edhe menaxhohen më lehtë, edhe ka kosto tjetër dhe në fund bëhen zgjidhje më të mira për qytetarët.

Krejt vërejtjet që i patëm rreth kësaj Marrëveshje ishte afati paksa i shkurtër i procedimit të saj sepse një ditë më parë (dje) erdhi si propozim shtesë në KPF e që aty për aty vendosëm, mirëpo duke e pasë parasysh rëndësinë që e ka Marrëveshja ne e mbështesim dhe urojmë që kjo Marrëveshje të jetësohet sepse është për të mirën e jo vetëm qytetarëve të komunës tonë por në të mirën e të gjithë qytetarëve të këtyre komunave nënshkruese.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, duke marrë parasysh qëllimin e kësaj Marrëveshje që është bashkërendimi i aktiviteteve në fusha të ndryshme e në interes të përgjithshëm e që në kuadër të kësaj krijohen lehtësira të ndryshme për mirëqenien e qytetarëve në sfera të ndryshme të jetës, edhe ne Grupi i LVV-së e përkrahim këtë Marrëveshje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedhim në votim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 18 vota Për, nga anëtarët që ishin prezent, me vendim miratohet Marrëveshja Kornizë e Bashkëpunimit Ndër-Komunal, (e lidhur mes 6 Komunave si në vijim: Kryeqyteti Prishtina; Komuna e Podujevës; Komuna e Lipjanit; Komuna e Fushë Kosovës; Komuna e Graçanicës dhe Komuna e Obiliqit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

8. Rishqyrtimi i Planit Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Podujevës për periudhën 2023 - 2027 (përkatësisht përfshirja e Ligjit nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-060 për Mbeturina, në dokumentin e Planit Lokal për mbeturina të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2025)

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kemi të bëjmë me një Plan i cili është miratuar në këtë Kuvend mirëpo nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës na është kthyer për rishqyrtim me disa vërejtje ku një prej tyre ka qenë mos përfshirja e plotësim ndryshimit të ligjit për mbeturina, andaj tani besoj që drejtorja përkatëse ka bërë këto plotësim ndryshme dhe sot ka sjellë në Kuvend që të vendoset për këtë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, në muajin që është votuar ky Plan është votuar edhe një pikë tjetër që ka qenë për kompensimin e anëtarëve të komisionit për procedurat e zgjedhjes së Këshillave lokal për të cilin nuk na keni dhënë arsye se a është kthyer pozitiv apo negativ nga Ministria përkatëse, pra nuk na keni dhënë sqarim i nderuar Kryesues.

Çështja tjetër është se kur e kemi votuar këtë Plan, aty ka shkruar Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027, kurse tani është 2023-2025, andaj tani nuk po e di a ka qenë ndonjë gabim teknik që e ka kthyer Ministria apo ka ndryshuar kjo periudhë, andaj nëse ka mundësi drejtori i Drejtorisë përkatëse të na sqaroj.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, kur e kemi diskutuar draftin e Planit në fjalë këtu bashkërisht i kemi diskutuar edhe disa gabime teknike që kanë qenë në atë draft fillestar, madje nga parafolësi janë dhënë shumë vërejtje për ato gabime teknike që kanë qenë por që para se të dërgohet në Ministri ato janë përmirësuar, mirëpo ashtu qysh e paraqiti arsyen edhe Kryesuesi i Kuvendit qëllimi pse është kthyer në rishqyrtim ky plan është mos përfshirja e plotësim ndryshimit të Ligjit për mbeturina e që në fakt ai plotësim ndryshim nuk e ka prek fare këtë pikë, por që është thënë se me faktin që është plotësim ndryshim është dashtë të përfshihet, prandaj sot kemi të bëjmë vetëm me përfshirjen në Planin përkatës plotësim ndryshimin e Ligjit për mbeturina.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, sa i përket vendimit për kompensimin e komisionit për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, nga Ministria e financave është kthyer përgjigjja duke na referuar që kjo çështje të dërgohet në Ministrinë e Punëve të Brendshme ku edhe e kemi dërguar por që ende nuk kemi kurrfarë përgjigje.

Sa i përket Këshillave të fshatrave, unë nga përvoja dhe praktika e komunave tjera po flasë në bazë të takimeve që kemi pasë, ka Komuna të cilat i kanë zgjedhë Këshillat për çdo fshat ku ka banorë, kështu neve kjo çështje na ka nxjerrë më së shumti telashe ku i kemi përfshirë 4-5 fshatra në një Këshill, prandaj ndoshta është mirë që edhe ne ta rishqyrtojmë Rregulloren përkatëse komunale në mënyrë që ta kthejmë sikurse që i kanë Komunitat tjera siç është njëra prej tyre Komuna e Lipjanit e cila ka bërë në çdo vendbanim një Këshill të fshatit. E them këtë sepse ne i kemi pasë këto probleme ku disa fshatra janë përfshirë në një Këshill siç ishte fshati Kërpimeh ose edhe fshati Lluzhan. Pra kjo ishte sqarim shtesë rreth Këshillave të fshatrave edhe pse nuk është pikë e rendit të ditës dhe nuk është as temë.

Kurse vendimi të cilit i'u referuar z.Ekremi Rrahmani, nuk është kthyer ende as pozitiv as negativ nga ana e Ministrisë, ka mbete ashtu pezull e që pa e kthyer ata ne nuk mund ta ekzekutojmë atë.

z.Naim Çunaku, theksoi, kolegu parafolës z.Ekrem Rrahmani ngriti diçka tjetër kurse ti Kryesues ngrite dhe komentove krejt diçka tjetër. Sa kuptova unë zotëri Rrahmani kishte një pyetje rreth numrit të vendimeve që janë kthyer të paligjshme, me theks kishte interesim rreth vendimit për kompensimin e komisionit për organizimin e zgjedhjes së Këshillave të fshatrave, pra fjala ishte për këtë vendim të kompensimit, ndërsa sa i përket asaj “që jemi mësuar të pleqnojmë” duke thënë se e ka bërë një Komunë ashtu kështu, ne për themelimin dhe konstituimin e Këshillave të fshatrave kemi një Udhëzim Administrativ në fuqi dhe duhet t'i përmbahemi atij Udhëzimi deri sa nuk kemi një bazë ligjore tjetër, andaj ne nuk mund të nxjerrim kurrfarë rregulloreje tjetër sepse nëse vazhdojmë kështu do të nxjerrim veç rregullore të cilat pastaj kthehen mbrapsht ngase nuk mund të nxjerrim rregullore në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ, përndryshe mund të bëjmë një lloj Puçi dhe nuk po e njohim MAPL-në fare e cila e ka kompetencën për të shqyrtuar ligjshmërinë e kateve komunale.

Pra një komision për organizimin e zgjedhjes së Këshillave të fshatrave është ngritur, pastaj ai komision ka punuar diçka por nuk është bërë kompensimi i tyre, këtu ishte pyetja.

Kryesuesi i kuvendit, theksoi, besoj se z.Ekrem Rrahmani ishte i kënaqur me përgjigjen time.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, në emër të grupit të LVV-së e përkrëhim plotësim ndryshimin e Ligjit nr.04/L-060 për mbeturina në dokumentin e planit lokal për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Podujevës për periudhën 2023-2025.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim rishqyrtimin sipas kësaj pike të rendit të ditës sipas rekomandimit të MMPHI.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 18 vota Për, nga anëtarët që ishin prezent, në procedurë të rishqyrtimit, me vendim miratohet Plani Lokal për Menaxhimin e Mbeturina në Komunën e Podujevës për periudhën 2023-2027, sipas materialit përkatës të miratuar në mbledhjen e datës 27.09.2023, përkatësisht përfshirjen e Ligjit nr.08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-060 për Mbeturina, në dokumentin e Planit Lokal për mbeturina të Komunës së Podujevës për periudhën 2023-2025, ashtu siç është referuar nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës përmes Shkresës DL nr. 5834-2/23 të datës 13.10.2023.

9. Të Ndryshme

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar kryesues i Kuvendit, shpeshherë po përmend disa votime kush ka votuar dhe kush jo për disa çështje, mirëpo përse sot askush nuk mori fjalën dhe të na jap komplimente që ne sot si opozitë po qëndrojmë në sallë dhe po e bëjmë kuorumin dhe po votojmë për t'i kapërcyer këto pika. Pra konsideroj se duhet të përmenden gjërat e mira sepse nganjëherë po përmendni disa gjëra duke i konsideruar vetëm si zi, andaj besoj se goxha institucionalistë jemi, të gjithë kemi punë të ndryshme por qëndrojmë në sallë, shembull kolegu z.Fahri Hasani që është këtu ka bukur punë dhe është i zënë por po qëndron në sallë, ndërsa jemi në limitet e kuorunit, vetëm një po të shkoj ne nuk mund të vazhdojmë m mbledhje.

Tani sa i përket asaj që e mora fjalën, meqë drejtori i DSHPMSh është prezent këtu, unë kam disa akuza nga bashkëfshatarët sa i përket ndriçimit publik dhe ka shumë ankesa, pra ka të tilla që nuk bëjnë dritë fare po ka edhe që bëjnë dritë shumë pak por ka edhe të tilla që bëjnë dritë m ndërprerje dhe pengojnë në sy, andaj kërkoj nëse ka mundësi të bëhet ndonjë intervenim në atë ndriçim.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, unë nuk kam pyetje por deshta të lidhem me atë që parafolësi z.Ekrem Rrahmani e potencoj, faleminderit që po e bëni kuorumin mirëpo është obligim i gjithsecilit të qëndrojmë në seancë.

z.Ragip Fetahu, theksoi, dëshiroj të ngrisë një çështje që ka të bëjë me parkingun në rrugën këtu afër që është në mes Komunës dhe shkollës “Shaban Shala”, gjë e cila është një ndër gjërave më të mira që është bërë brenda qytetit, parking i cili është rregulluar ndoshta me idenë që t'i shërbej shkollës dhe prindërve të cilët i sjellin fëmijët e tyre në shkollë. Unë për çdo ditë kaloj andej dhe shohë një kaos të madh parkingësh që bëhen aty dhe bëhen kryesisht nga persona të pandërgjegjshëm, perona që kanë edhe biznese, perona që kanë vetura edhe shumë të shtrejta të cilët i parkojnë aty dhe bllokojnë hyrjen e shkollës “Shaban Shala”. Se a kan të drejtë ligjrisht t'i parkojnë, për momentin them se kan të drejtë sepse nuk kemi asnjë shenjë, shenjëzim apo tabelë e cila i ndalon.

Unë propozoj që ky parking të shenjëzohet me një shenjë që veturat të cilat parkohen aty të mos kenë të drejtë të qëndrojnë më gjatë se 10 minuta dhe me kusht që ata të jenë në veturë brenda me qëllim që t'iu shërbej prindërve të cilët i sjellin fëmijët e tyre në shkollë.

Është shumë me rëndësi dhe është shumë për keqardhje t'ju them të drejtën se ky numër i qytetarëve të pandërgjegjshëm e të cilët janë të vetëdijshtëm dhe e dinë se për çka është menduar ai parking dhe për çka shërben ai parking, shkojnë me veturat e tyre në vlerë mbi 50,000.00€ shkojnë e zënë parkingun një nëne e cila nuk ka mundësi të ndalet dhe t'i dërgoj fëmijët e vet në shkollë.

Është shumë për keqardhje për kulturën dhe mentalitetin shumë të ulët të disa individëve, prandaj sugjeroj që në mundësinë e parë DSHPMSH të bëjnë shenjëzimin e atij parkingu me qëllimin e vetëm që ai parking t'i shërbej shkollës përkatësisht shkollave afër këtu.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, sa jam në dijeni te kjo pikë që është Të Ndryshme, ka mbete që të themelohet komisioni që u vendos në pikën 3 të rendit të ditës.

znj.Donjetë Sheqiri, theksoi, ka disa kërkesa për ndriçimin e rrugës “Abdyl Dushkollit” ku shtyllat janë të betonit dhe vetëm ka mbete vendoja e dritave, si dhe po ashtu edhe rruga “Rrustem Sadiku” dhe te lagja Zymberi në fshatin Llaushë. Gjithashtu ka kërkesë të madhe të bëhet ndriçimi nga shkolla e fshatit Llaushë deri te rruga ‘Abdyl Dushkollit’ që do t’ju shërbente shumë fëmijëve / nxënësve.

Po ashtu ka kërkesa të shumta edhe për asfaltimin e rrugëve “Beqir Hamiti”, “Rahim Tashefci” si dhe asfaltimin e rrugës së lagjes Jaholli deri tek shkolla e fshatit Llaushë.

Kam edhe një pyetje, a janë futur në listën e pagave për këtë muaj mësimdhënësit e ri të cilët kanë qenë jashtë kësaj liste që 4 muaj, nëse jo atëherë si planifikoni t’i paguani, nëse po atëherë si planifikoni t’i kompensoni për këta muaj që nuk janë paguar.

z.Haki Rudari, theksoi, propozoj që njëherë ta formojmë komisionin që u dakorduar më herët dhe të japim propozimet, pastaj mund të vazhdojmë me pyetje dhe kërkesa nëse veç dëshirojnë edhe kolegët.

Në këtë aspekt shfrytëzoj rastin që ta propozoj kolegun Ragip Fetahu në atë komision.

z.Ardi Hasani, theksoi, lidhur me përbërjen e komisionit në fjalë pyes a ka mundësi të formohet ai komision në përbërje prej 4 anëtarëve nga partitë e ndryshme që jemi si Grupe këtu në Kuvend, sepse fatkeqësisht z.Gazmend Islami nga OBKD nuk është këtu, si dhe një anëtar nga Drejtoria përkatëse që është ekspert i fushës.

z.Valon Demolli, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së propozoj që anëtar në komisionin në fjalë të jetë z.Ekrem Rrahmani.

z.Naim Çunaku, theksoi, sugjeroj që fillimisht të marrim vendim për formimin e komisionit prej sa anëtarëve e që sigurisht do të jetë prej 5 anëtarëve, vendosim ashtu dhe votohet. Ndërsa nuk mund ta përkrahim propozimin që njëri prej anëtarëve të jetë nga drejtoria përkatëse për arsye se i gjithë ai komision ka qenë i Ekzekutivit të Komunës, ndërsa ishte një marrëveshje / dakordim që ky komision tani të përbëhet prej Kuvendit të Komunës. Pra jo përse ne po dëshirojmë t’i përjashtojmë por ai komision e ka përfunduar punën e vet përmes një komisioni të Ekzekutivit dhe në këtë rast shkaku i punës së tyre u dasht që të marrim këtë qëndrim të formojmë komision prej Kuvendit, kurse bashkëpunim duhet të ketë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, pra fillimisht po vendosim numrin e përbërjes së komisionit, kush është që komisioni të formohet prej 5 anëtarëve nga radhët e Kuvendit.

Konstatim.

Njëzëri nga 18 anëtarët/et e Kuvendit që janë prezent mbështetjet propozimi që numri i përbërjes së Komisionit të jetë 5 anëtar nga radhët e Kuvendit, dhe atë prej të gjitha subjekteve politike.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, pra ka qenë një komision i formuar prej Ekzekutivit të Komunës, i cili ka bërë atë punë, kurse tani u dakorduar që të formojmë një komision prej Kuvendit që të shikoj dhe analizoj punën e komisionit të Ekzekutivit.

Nuk ka të keqe asgjë që ndonjë subjekt politik të ketë ndoshta edhe 2 anëtarë sepse të gjithë jemi qytetarë të Komunës dhe të gjithë me vota kemi ardhur këtu në Kuvend.

z.Valon Demolli, theksoi, edhe njëherë e propozoj z.Ekrem Rrahmanin nga Grupi i LDK-së.

z.Haki Rudari, theksoi, edhe unë po ashtu e përsërisë propozimin e mëparshëm nga radhët e Grupit të LVV-së z.Ragip Fetahun. Mund të ketë edhe propozime tjera meqë momentalisht jemi 4 subjekte politike në sallë, megjithëse do të ishte mirë të kalonte propozimi që një anëtar të jetë nga radhët e Drejtorisë përkatëse për arsye se përveç tjerash do të na furnizonte me material, por që tani sigurisht do të vijmë në situatë që një subjekt politikë të ketë 2 anëtar.

z.Naim Çunaku, theksoi, pa qëllim të keq i nderuar Haki Rudari sepse nuk më pengon fare se kush hyn në këtë komision, mirëpo një propozim i cili u prezantua nga kolegu z.Ekrem Rrahmani dhe që pastaj u përkrah nga Kryetari i Komunës e madje Kryetari e potencoj që do të doja që opozita ta ketë shumicën.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, propozoj që në kuadër të komisionit prej Grupit të PDK-së të jetë z.Bashkim Sylja.

z.Arbnor Fazliu, theksoi, nga radhët e AAK propozojmë z.Burim Hasanin.

z.Valon Demolli, theksoi, nga Grupi i LDK-së, anëtarin tjetër në këtë komision e propozoj znj.Edona Shabani.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani i kemi 5 anëtar të propozuar, ata janë; *Ekrem Rrahmani; Ragip Fetahu; Bashkim Sylja; Burim Hasani; Edona Shabani, atëherë e hedh në votim përbërjen e komisionit në fjalë.*

Konstatim

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 18 vota Për, nga anëtarët që ishin prezent, ngritët Komisioni ad-hoc nga përbërja e Kuvendit të Komunës, për shikimin, analizimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të të dëmtuarve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të ndodhura gjatë vitit 2022 sipas rekomandimit nr.prot.02-016/01-0086038/23 datë 06.12.2023 dhe Listës përkatëse të Komisionit komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, në përbërje si vijon;

Ekrem Rrahmani; Ragip Fetahu; Bashkim Sylja; Burim Hasani; Edona Shabani

Komision i cili do t'i qaset shikimit, analizimit dhe vlerësimit të dokumentacioneve të fermerëve dhe të tjerëve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera të ndodhura gjatë vitit 2022 që nuk janë kompensuar nga ana e nivelit qendrorë por që janë kthyer në Komunë për vendosje dhe kompensim, si dhe për punën e bërë të përgatitë raport në formë të shkruar me rekomandime konkrete për hapat dhe veprimet e mëtutjeshëm që duhet të ndërmer Kuvendi i Komunës lidhur me ndarjen e mjeteve financiare për kompensimin e dëmeve për të dëmtuarit sipas Listës përkatësisht rekomandimit të datës 06.12.2023.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 15:45

Procesverbalin e mbajti;

Enis Sheholli

Osmon Bajrami

Nr.Prot.01-033/02-0090885/23

Podujevë,

28 dhjetor 2023

Kryesuesi i Kuvendit

Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e XXXIV-të (tridhjetekatër)-e rregullt, mandati VII-të, e mbajtur më 30 janar 2024.

Mbledhja filloi në orën 10:20 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës:

(Nga LDK Demokrat Hodolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Adnan Zymeri; Arjant Topanica; Donjetë Sheqiri; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Tringa Sfishta; Fahri Hasani; kurse mungoi, Valon Demolli.

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Artrit Mulliqi; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; Lirika Maliqi.

Nga PDK, Bashkim Sylja; Mimoza Abdullahu; Endritë Murati.

Nga AAK, Mrika Thaçi; Burim Hasani; Arbnor Fazliu.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi me arsyetim shëndetësor me shkrim dërguar Kryesuesit të Kuvendit.

Gjithashtu të pranishëm mbledhje ishin drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Xhevie Beqiri-Drejtorja e Administratës DA; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Pajtim Balaj-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Alban Zeka-Drejtorja e Inspeksionit DI; Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE).

Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të KFOR, përfaqësues të OSBE, mediave lokale (TV Llapi) dhe disa zyrtar komunal.

Rendi i Ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje dhe punë të mbarë në këtë mbledhje, theksoi, para se të fillojmë me mbledhjen, jeni në dijeni se në Komunën tonë ka ndodh një rast i rëndë me të riun Lulzim Fejzullahu, prandaj ju ftoj për një minutë heshtje.

U mbajt një minutë heshtje të riun Lulzim Fejzullahu.

Kryesues i Kuvendit, vazhdoi, kuorum kemi dhe mund të fillojmë me punime, për momentin prezent në sallë janë 31 anëtar/e të Kuvendit, kurse mungojnë 5 anëtar/e (*lexon emrat e atyre që për momentin mungojnë por që në vazhdim mund të vijnë dhe të evidentohen me nënshkrim në Listën përkatëse, dhe atë z.Valon Demolli, znj.Endritë Murati, znj.Mimoza Abdullahu, z.Gazmend Islami*). Mungesat tek ne janë bërë traditë, ka mungesa shumë, komunat tjera e praktikojnë për ata që mungojnë në mbledhje të Kuvendit duhet të bëjnë njoftimin dhe arsyen e mungesës, këtu jo që mungojnë në mbledhje po as edhe një e-mail nuk e shkruajnë për arsyen e mos pjesëmarrjes në

mbledhje, i vetmi është anëtar i Kuvendit z.Gazmend Islami i cili ka dërguar një e-maile përmes të cilëve na ka njoftuar se nuk është mirë me shëndet dhe ndodhet në Gjermani për trajtim shëndetësor, kurse për mungesën e të tjerëve nuk kemi arsye asnjëherë.

Paraprakisht kësaj mbledhje i ka parapri edhe mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa – KPF ku është diskutuar dhe janë rekomanduar Kuvendit pikat për shqyrtim, Rekomandime të cilat ju janë përcjellë edhe juve. Para se të fillojmë me pikat e rendit të ditës, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, theksoi, ne si Drejtori kemi bërë përgatitjen e materialit për pikat për dhënie në shfrytëzim të pronave të pa luajtshme për gjithsej 6 parcela përfshirë edhe propozimet për formimet e komisioneve përkatëse vlerësuese, me kohë kemi bërë njoftimin publik për aplikimin e anëtarëve nga Organizatat e Shoqërisë Civile dhe deri dje ka qenë afati për aplikim, mirëpo pasi që kemi verifikuar nuk ka asnjë aplikant për këto aplikime për formimin e komisioneve, prandaj kërkoj që këto pika të rendit të ditës të shtyhen për një seancë tjetër.

z.Haki Rudari, theksoi, duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe Rregulloren e punës së Kuvendit të cilat mendoj se janë bazament i Kuvendeve komunale, unë propozoj një pikë tjetër të rendit të ditës krahas pikës së parë që është Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2024, prandaj kam këtë; Propozim vendim për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2024. Këtë që unë po e them ka shumë Komuna që e kanë praktikë këtë, kjo në të kaluarën nuk ka ndodhë, andaj mendoj se është një gjë e mirë dhe serioze për arsye se një Kuvend Komunal me 35 këshilltarë është mirë që t'i përcakton seancat se kur do të mbahen. Ne 35 këshilltar/e të Kuvendit nëse votojmë atëherë pak a shumë e kemi edhe orarin e mbajtjes së seancave të Kuvendit. Po e lexoj nenin 88 paragrafi 1, pas miratimit të Planit të punës, Kuvendi e përcakton atë që unë e propozova, po e përsërisë Kuvendi e përcakton kalendarin e mbajtjes së mbledhjeve për vitin përkatës fiskal. Pra kemi të drejtë ligjore me Rregulloren dhe mendoj që është e mirë që krahas Planit të punës që kemi, dhe një komision të përfaqësuar nga subjektet e përfaqësuar në Kuvend e që nga ne Grupi i LVV-së ishte Profesor z.Fitim Muçolli, besoj që kjo pikë e rendit të ditës do të përkrahet. Në fund të fundit e imja si këshilltar është ta bëjë propozimin ndërsa e këshilltareve është të votoj për, kundër apo të abstenoj.

z.Naim Çunaku, theksoi, lidhur me dy propozimet që u ngritën këtu, së pari ishte propozimi i drejtoreshës së DPKGJ-së për shtyrjen për një mbledhje tjetër për vendimmarrje pikat e propozuara përkatëse që lidhen me dhënien e pronave në shfrytëzim, për çka më duhet ta shpreh mendimin tim që kur kemi marrë vendim në muajin dhjetor që asetet komunale gjegjësisht pronat komunale të mundësohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, të krijohet mundësia që operatorët ekonomik të interesuar t'i marrin në shfrytëzim dhe arsyetimi që ishte atëherë, është sot dhe do të jetë gjithë që të paktën do të duhej të jetë që ato prona, ato asete të fjetura të Komunës tonë të mos të mbeten të fjetura por t'i vëmë në funksion të zhvillimit ekonomik, ngritjes së mirëqenies dhe ta përmbushim një obligim ligjor që Komuna si parësore e ka kujdesin, avancimin e ruajtjes së pronave dhe ngritjes së vlerës së tyre në zhvillimet e tregut.

Jemi dëshmitarë që në vitin paraprak është marrë një vendim i tillë dhe ato prona përmes faqes zyrtare të Komunës kanë dalë për dhënie në shfrytëzim, por tani pyes a kemi pasë dhënie në shfrytëzim të atyre pronave, e që unë e di se prona kanë mbet vetëm si përmbushje e një formaliteti ose e një mundësie ligjore, po kurrë nuk kemi një raport se çka është bërë me ato prona, madje kemi shkuar aq larg, që po e them se ka filluar funksionimi i pushtetit lokal për herë të parë në vitin 2000 dhe sot e kësaj dite Komuna jonë nuk i ka të evidentuara të gjitha pronat e saj komunale dhe sot e asaj dite ne nuk e dimë ku janë ato prona, në çfarë gjendje janë, kush i shfrytëzon dhe me çfarë të drejte i shfrytëzon, por nuk po e zgjeroj debatin më shumë rreth kësaj.

Më bëri përshtypje fakti që asnjë Organizatë jo qeveritare, si obligim ligjor që duhet të jetë nga radhët e tyre një anëtar në komisionin përkatëse, por nëse nuk kemi anëtar të tillë me të drejtë drejtoresha e DPKGJ e potencoi që është kusht ligjor që të jetë edhe një anëtar nga OJQ-të, dhe kjo e bënë formalisht të pa përfunduar një diçka që vetëm mund të shtyhet sepse nuk ka zgjidhje tjetër. Ku dëshiroj ta vë akcentin, kur kemi ndarë subvencione, gjegjësisht kur është bërë publikimi për subvencionet për OJQ, ne të gjithë jemi dëshmitarë që jo pak Organizata jo qeveritare ju kemi ndarë subvencione për veprim brenda territorit të Komunës, andaj a do të thotë kjo që i'u kemi ndarë subvencione dikujt që nuk ka gatishmërinë të vëhet në proces të mbarëvajtjes të ndonjë procedure ligjore komunale, del që po, ose të kundërtën kemi rënduar aq shumë raportet ne si institucion me OJQ që ata nuk kanë gatishmëri të jenë pjesë e vendimmarrjes ashtu siç e thotë ligji, kjo vërtetë na bën shqetësuese, apo të paktën duhet të jemi të shqetësuar që po mbeten sërish ato prona pa u vë në funksionin e tyre parësor për çka kemi vendos në këtë Kuvend në muajin dhjetor. Pra nuk kemi rrugë tjetër e nderuar drejtoreshë e DPKGJ, mund ta votojmë ose jo këtë, ne mund të marrim një vendim por derisa OJQ nuk nominonjë anëtarët e tyre për anëtar në Komisione, do të thotë është diçka që nuk po funksionon, andaj mund të marrim vendim që t'i shtyjme këto propozime për një datë tjetër. Do të doja që në datën tjetër, jo vetëm këto prona por të gjitha ato prona që i kemi, dhe ndoshta është mirë që ky Kuvend të ndalet dhe ta trajtoj si pikë të veçantë dhe të krijoj kushte që ta bëjmë atraktive për operatorët ekonomik për marrjen e atyre pronave në shfrytëzim. E zgjata paksa shumë dhe përë këtë kërkoj falje i nderuar Kryesues sepse me të vërtetë është një fakt shqetësues kjo ngase janë numër një, kur e them këtë jeni në dijeni kur është ndërtuar objekti përkatës në Orllan që e kemi shpallë dhe e dini vlerën që është investuar në atë objekt - një pjesë donacion dhe një pjesë nga buxheti dhe taksat e këtyre qytetarëve. Është objekt në vlerë mbi 1,000,000.00€ dhe ta lësh atë objekt në mëshirën e fatit me një potencial me vlerë të tregut 1,000,000.00€ më tepër se 15 vite pa vë në funksion, veç pa përgjegjësi mund t'i themi, jo diçka tjetër, dhe kur e them këtë e them pa dashur ta zgjasë gishtin dhe adresën se kush është fajtor për gjendjen kur dihet se pozita ka përgjegjësinë për atë që është mandatuar.

Lidhur me pyetjen tjetër që e bëri kolegu im i nderuar shefi i Grupit të këshilltarëve të LVV-së z.Haki Rudari, më bëri përshtypje propozimi i tij, me të vërtetë një propozim me vend, mirëpo ne pikë të parë të rendit të ditës e dini që e kemi Planin e punës së Kuvendit dhe këto që zotëri Rudari i potencoi që të merret vendim ndaras për caktimin e orareve dhe ato data është dashur të jenë në atë Plan. Vërtetë po e them edhe njëherë, nuk mund ta quaj atë si Plan sepse ai vetëm emrin plan mund ta ketë nëse nuk ndërthehen në vete datat se kur mbahen seancat. Nuk dëshiroj t'ju marrë kohë me Rregulloren e punës së Kuvendit sepse Rregullorja dhe Ligji e parashohin atë kohën rrëshqitëse se sa ditë mund të rrëshqasin / lëvizin, pra flitet vetëm për seriozitetin e punës tonë, kështu që mendoj zotëri Rudari që nuk është dashur të marrim vendim sot për caktimin e orareve sepse në këtë formë qysh jemi këtu nuk e kemi të lehtë të gjejmë ujdë ngase është dashur që ato data të jenë në Plan të punës dhe kur bisedojmë për këtë e që e kemi pikën e parë të rendit të ditës aty besoj se duhet ta marrim një vendim që ai Plan i punës mos të votohet, të kthehet dhe të përpunohet dhe të vijë i kompletuar siç i ka hije një Kuvendi komunal dhe siç bëhet gjithandej Kosovës si dhe aty të zënë vend edhe datat për të cilat ne përcaktohem se kur do të mbahen mbledhjet e Kuvendit.

z.Bashkim Sylja, theksoi, sa i përket propozimit të drejtoreshës së DPKGJ edhe unë pajtohem që në muajt e ardhshëm është mirë të na sjellët një raport lidhur me pronat që janë dhënë në shfrytëzim në vitin 2023, më duket shumë e pasinqertë nga ana e Shoqërisë civile kur e dimë se mijëra euro janë subvencionuar në vitin e kaluar prej kësaj qeverisje dhe të mos dërgojnë asnjë propozim në komisionet përkatëse.

Sa i përket pikës së propozuar nga shefi i Grupit të LVV-së, mendoj se do ishte mirë të caktohet datat e mbledhjeve në Planin e punës dhe ky propozim të mos ketë nevojë të hyj fare si pikë e rendit të ditës por në Plan të punës ka mund të caktohet data për secilin muaj kur me u mbajt seancat, kështu që kjo temë është problematike përveç nëse marrim pauzë për t'i caktuar ato data, si do që të jetë unë jam për.

z.Haki Rudari, theksoi, falënderoj parafolësin shefin e Grupit të PDK-së, kurse sa i përket shefit të Grupit të LDK-së mendoj që në një farë forme nuk qëndron ajo që e tha për arsye se Plani i punës së Kuvendit dhe orari i mbajtjes së mbledhjeve dhe takimeve janë të ndryshme.

Ne e kemi Planin e punës dhe i kemi informatat nëpër muaj, por neve fare nuk na pengon pastaj në pikën e dytë t'i caktojmë datat e mbajtjes së seancave. Unë si propozues gjithherë kam thënë që është mirë që të respektohet Rregullorja për arsye se për propozimet arsyetimin e bën këshilltari dhe nuk hapet debat. Çfarë do propozimi që e bënë LDK-ja mua fare nuk më pengon, e arsyeton e hedh në propozim votohet dhe kalon ose jo unë fare nuk e kam problem, të njëjtin propozim e kam edhe unë. Kryesuesi i Kuvendit e zgjati paksa dhe ju la hapësirë për arsye sepse fillimisht propozimi i drejtoreshës së DPKGJ është dashur të vëhet në votim dhe ato të mbeten për seancën e radhës, pastaj është dashur propozimi im të vëhet në votim dhe nëse kalon në rregull dhe nëse jo unë nuk jam person që "kukati, pesë para s'i jap", unë e mbaj qëndrimin tim dhe e respektoj qëndrimin e këshilltarëve tjerë, madje edhe në opozitë kur kam qenë kurrë nuk e kam thënë pse e ke bërë ose pse e ke votuar atë, është e drejtë e këshilltarit të voton sipas bindjeve të veta.

Kryesuesi i Kuvendit në bazë të Rregullores, pasi të arsyetohet e hedh në votim dhe kur të vije pika e rendit të ditës mund të hapet debat pastaj, atëherë hapet debati nga këshilltar të ndryshëm dhe unë si iniciues apo propozues pastaj kam propozime tjera kur vijmë te kjo pikë që tani në këtë kohë nuk mund t'i jap, por kur të vijmë te kjo pikë, nëse kalon është fjala, unë kam propozime tjera dhe atëherë hapet debati.

Për fund, është mirë propozimi të hidhet në votim, qoftë ai i drejtoreshës së DPKGJ për largim të pikave dhe shtyrje për një prej seancave të radhës, dhe propozimi im që ishte për futjen e një pike të re të rendit të ditës, të cilën e lexova më herët.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, asnjë pikë nuk hyn në rend të ditës pa u debatuar për të fillimisht, t'i e propozon kurse të tjerët flasin dhe debatohet atëherë ne e vejmë në votim atë propozim, askush nuk e mohoj që ti (i drejtohet z.Haki Rudarit) nuk ke të drejtë të propozosh pika të rendit të ditës dhe t'i vësh në votim, ne i hedhim propozimet në votim. Ne e kemi të paraparë që çdo muaj ta mbajmë nga një mbledhje normale, mirëpo data e caktimit të mbledhjeve është një problem në qoftë se e caktojmë një datë dhe e kemi mundësinë me lëvizë atë datë çfarë do të thotë ai caktim i asaj date, e rëndësishme është që çdo muaj ta mbajmë nga një mbledhje, kështu që a e caktojmë ne datën e mbajtjes së mbledhjes më 15 apo 20 të muajit shembull, e them këtë ngase kemi disa mbledhje të jashtëzakonshme dhe solemne që na e prishin rendin, andaj për mua data nuk luan rol, mirëpo ne mund të caktojmë data por nuk e di a do mund t'iu përmbahemi atyre datave.

z.Naim Çunaku, theksoi, mos të mendojmë të krijojmë dilema që me cungimin e debatit arrihet, të njëjtën Rregullore e kemi të gjithë përpara vetës dhe varësisht kush dhe çka kupton prej saj dhe si dëshiron ta interpretoj. Faktikisht ashtu thuhet që nuk hapet debat për propozimet, por nuk mund t'ia cungosh Grupeve që e përbëjnë Kuvendin e Komunës të thërrasin prej foltores dhe të orientojnë Grupin që i takojnë si duhet të veprojnë, andaj nuk ishte kurrfarë debati por ishte orientim në këtë rast për Grupin e LDK-së nga ana ime, pra që t'i orientojë për votim.

Faleminderit shefit të Grupit të LVV-së z.Haki Rudari për sugjerimin, gjegjësisht njoftimin që orari dhe plani kanë ndryshim, vërtetë këtë send nuk e kam ditë dhe e falënderoj për diçka që më bëri ta kuptoj sot, por nuk di çka ka më themelore te një Plan i punës se sa caktimi edhe i datave të

seancave, dhe kjo ishte poenta ime, ne tani mund ta ndajmë edhe muajin e korrikut dhe ta nxjerrim një vendim tjetër sikurse që mundemi edhe për muajin shtator, por cili është ai plan i cili nuk përmban në vete edhe aspektin kohor se kur do të realizohet, gjegjësisht dinamikën e realizimit të atij plani. Kurrfarë tendence nuk pata, vetëm e kamë këtë që po e potencoj edhe njëherë, nëse sot e hapim si pikë të rendit të ditës dhe mendojmë që në këtë përbërje kaq të gjerë të caktojmë data, ne do zgjasim disa seanca dhe nuk do të mund t'i caktojmë ato data. Në një formë datat e seancave përcaktohen karshi dinamikës së zhvillimit të punëve edhe të Ekzekutivit se kur ne duhet t'i mbajmë ata përgjegjës dhe të njoftojmë opinionin publik për ngjarjet për çka jemi të thirrur, këtu ishte poenta sepse mendoj dhe propozimi im ishte t'i kthehet atij komisioni ai plan i punës, të pasurohet ai plan edhe me data sepse ai komision është një grupim më i vogël dhe mund të caktojë data, kurse ne 35 këshilltar dyshoj shumë se do arrijmë të dakordohemi për data.

z.Haki Rudari, theksoi, vetëm më lejoni edhe njëherë të lexoj nenin dhe nuk ka kurrfarë problemi, neni 37 paragrafi 1, po e citoj, për propozimet lidhur me ndryshimin apo plotësimin e rendit të ditës nuk hapet debat, kjo është në Rregullore, nuk po e thotë Haki Rudari por po thotë Rregullorja, por pas arsytimit të shkurtra të propozuesit dhe sqarimet e Kryesuesit të Kuvendit kalohet në votim, do të thotë votimi është ai që e përmbyll.

Sa i përket çështjes tjetër, janë dy gjëra të kundërta edhe me Rregullore njëherë kemi të bëjmë me planin e punës pastaj orarin e mbajtjes së takimeve, se a respektohet ai orar dhe ajo datë nuk është në domenin e këshilltarit pastaj, janë organet tjera, janë Drejtoritë dhe Ekzekutivi që do të japin informata në bazë të cilave pastaj thirren seancat.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, për propozimin e shefit të Grupit të këshilltarëve të LVV-së z.Haki Rudari në formë të pyetjes i drejtohem sepse e di që e kanë pas një anëtar në komisionin përkatës për hartimin e Planit të punës por si duket nuk është konsultuar fare me të, pastaj ka mundur edhe të marrë pjesë në dëgjim publik dhe ta bëjë propozimin në fjalë, por jo tani të bëjë propozim si pikë të rendit të ditës sepse nuk ka nevojë të bëhet pikë e re e rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, i nderuari këshilltar z.Haki Rudari, Plani i punës së Kuvendit nuk është plan vetëm i imi, por është i komisionit që është formuar prej të gjitha partive politike, andaj më duket se u teprua kjo çështje paksa, askujt më nuk do t'i jepet fjala për arsye se të gjithë keni pas përfaqësuesin tuaj në komision dhe keni mund të konsultoheni nga të gjitha subjektet politike.

z.Haki Rudari, theksoi, e kam obligim t'i përgjigjem kolegut z.Ekrem Rrahmani sepse kërkoi t'i përgjigjem, ne e kemi pas një përfaqësues në komisionin përkatës, shumë të nderuar dhe të respektuar, ne kemi mbledhjet e rregullta të Grupit, mirëpo kjo që e thash unë fare nuk ka të bëjë me atë që ne kemi pas përfaqësues në Komision. Tani ne po kërkojmë orarin e mbajtjes së takimeve, asgjë tjetër, kurse sa keni qenë aktiv si komision për hartimin e planit të Punës unë pajtohem me propozimin që e keni sjellë.

Tani unë po kërkoj caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve, fundja kjo është një çështje shumë teknike në kuptimin e vet për arsye se ne kemi të drejtë të propozojmë, propozimi jonë hedhet në votim dhe kurrfarë problemi nuk ka, kurse pse LDK-ja 20 vite nuk ka kaluar, i kemi edhe ne 2 vite që se kemi kaluar këtë, edhe ne që 2 vite ende nuk kemi caktuar datat e mbajtjes së seancave dhe jemi krejt në rregull.

z.Naim Çunaku, theksoi, u bë një konstatim i pa qëndrueshëm, edhe unë edhe zotëri Rudari dhe shumë prej jush këtu kemi pas Plan të punës dhe publikisht e thërras zotëri Rudarin nëse gjen një plan të punës të miratuar nga ky Kuvend edhe në kohën e LDK-së por edhe tani, që nuk përmban datat, unë i kërkoj falje publikisht, nëse nuk e gjen duhet të paktën nga ana njerëzore të kërkoj falje për një konstatim që e bëri e që nuk qëndron.

Nuk ka plan pune pa data të mbajtjes së seancave dhe nuk ka pasë asnjëherë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, rreth kësaj pike të rendit të ditës më nuk kemi çka diskutojmë, andaj së pari e vë në votim propozimin e Drejtoreshës së DPKGJ-së për tërheqjen nga rendi i ditës për këtë mbledhje dhe shtyrjen për një mbledhje të radhës së Kuvendit propozimet e renditura në rendin e ditës (pikat 2 deri në 7), për shkak të mos interesimit të përfaqësuesve nga sektori joqeveritar lokal për të qenë pjesë e komisioneve në fjalë, dhe atë:

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njësëri me 31 vota Për, nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, mbështet kërkesa / propozimi i drejtoreshës së DPKGJ për tërheqjen nga rendi i ditës për këtë mbledhje dhe shtyrjen për një mbledhje të radhës së Kuvendit propozimet si në vijim, për shkak të mos interesimit të përfaqësuesve nga sektori joqeveritar lokal për të qenë pjesë e komisioneve në fjalë, dhe atë:

2. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Objekti afarist në Zonën Kadastrale Orllan.
-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi.
3. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës – Njësia kadastrale P-00494-0, Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm.
-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi.
4. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00495-4, Zona Kadastrale Lupç i Poshtëm.
-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi.
5. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00594-0, Zona Kadastrale Turuçicë.
-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi.
6. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00596-0, Zona Kadastrale Turuçicë.
-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi.
7. Propozim Vendimi për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00597-0, Zona Kadastrale Turuçicë.
-Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim sipas këtij propozim vendimi.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani kalojmë te propozimi i z.Haki Rudarit, paraprakisht ju them se unë kam punuar kohë të gjatë në arsim dhe ka goxha kohë që planin e punës e kemi bërë për një vit, por me kurrikul tani është veç për dy muaj sepse planin e punës nuk mund ta realizosh, pra shembull, nuk i ke shpjeguar në shtator por i ke shpjeguar në janar, dhe tani në qoftë se ti nuk e kryen Planin e punës në shtator dhe tetor atë e vazhdon në muajin nëntor.

Kështu që si parim orari i mbledhjeve është brenda çdo muaji, kështu që përcaktimi i një date nuk më arsyeton mua se si duhet t'i përmbahemi asaj date, kështu që ndoshta kemi telashe dhe do të dalin tema që do t'i diskutojmë pse nuk i'u kemi përmbajt datave të caktuara.

Të gjithë përfaqësuesit e gjitha partive keni qenë pjesë e komisionit përkatës atëherë pse nuk i keni obliguar anëtarët e juaj të japin këtë propozim, keni mundur t'ju thoni anëtarëve tuaj propozoni datat, edhe z.Haki Rudari është dashur të komunikoj përmes përfaqësuesit të partisë së tij z.Fitim Muçolli, pastaj z.Naim Çunaku përmes z.Ekrem Rrahmanit e kështu me radhë, prandaj pa humbur

kohë më shumë për këtë çështje, unë e vë në votim propozimin e z.Haki Rudarit për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje edhe pika Caktimi i orarit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 15 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan) mbështetet propozimi i z.Haki Rudarit për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje edhe pika:

- Caktimi i orarit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuari Kryesues i Kuvendit, je duke e zhvilluar një praktikë në kundërshtim me ligjin, ta kam tërheq vërejtjen njëherë dhe sërish po të them që ne jemi kursyer që mos t'i apelojmë vendimet e këtij Kuvendi, por i nderuar Kryesues konsultojë ligjin, konsultojë Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Nuk ka kalim të një vendimi nëse për një vendimmarrje nuk janë 18 vota, këtë e kam me ty zotëri Kryesues sepse me z.Haki Rudarin nuk desha të polemizoj. Nuk thuhet prezent, por që marrin pjesë në votim, kështu e thotë ligji, është duke praktikohet ky standard, dijeni që është një standard në kundërshtim me ligjin.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, këtu në ligj thuhet, të pranishëm dhe votojnë.

z.Naim Çunaku, theksoi, zotëri Kryesues, kjo do të thotë për çdo vendimmarrje, që kanë marrë pjesë në vendimmarrje 18 vota, qofshin ata për, qofshin kundër, qofshin të abstenuar, mirëpo mos pjesëmarrja në votim nuk nënkupton as prezencë dhe nuk mund të kualifikohet.

Vazhdojeni ju asgjë të keqe s'kemi, por është një praktikë dhe një standard që je duke e zhvilluar në kundërshtim me ligjin. Nuk kemi dashur të apelojmë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal këtë vendimmarrje që është kah ndodh në këtë Kuvend Komunal të Podujevës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, në Ligj thuhet, shumica që janë prezent dhe që votojnë, këtu votuan 15 këshilltar.

z.Naim Çunaku, theksoi, kur ti u zgjodhe Kryesues i Kuvendit a ishim ne prezent këtu po, a kemi marrë pjesë në votim jo, dhe nuk mund të zgjedhesh deri sa nuk i ke 18 vota në kuti, qofshin ato vota për, kundër apo abstenim, 18 duhet të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ligji nuk e specifikon numrin e anëtarëve që duhet të marrin pjesë në votim.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues, me keqardhje e them se nuk është ky shpjegim siç e cekët, nuk e shpjegon numrin sepse Kuvendet komunale nuk janë të përbëra prej numrit të njëjtë të anëtarëve dhe nuk mund të thotë kaq e aq numra sepse diku kemi Kuvend komunal me 25 këshilltar, diku tjetër me 31 këshilltar, pastaj me 35 - 41 dhe 51 këshilltar, për këtë arsye nuk është përcaktuar numri.

z.Ragip Fetahu, theksoi, të respektuar të pranishëm, atë që e thotë z.Naim Çunaku është shumë e thjeshtë, kjo kaloi tashmë këtu dhe kemi praktika që edhe në të kaluarën kemi kaluar vendime në këtë formë, në qoftë se kjo është në kundërshtim me ligjin atëherë zotëri Çunaku ka të drejtë të dërgoj në Ministrinë përkatëse opinionin e tij dhe ai opinion të na kthehet e ta shohim se ai opinion a është i ligjshëm a jo.

z.Naim Çunaku, theksoi, zotëri Ragip Fetahu, unë e potencova që ka raste e raste, por është krijuar si standard dhe ne nuk kemi dashtë të merremi me diçka formale dhe në Ministri, nëse ata nuk i përkushtohen kësaj është problem i tyre dhe neve asgjë nuk na prish punë kjo.

Nëse atakohemi drejtpërdrejtë dhe atakohet një interes më i madh qytetarë, ne do ta bëjmë por kjo tregon që edhe ata nëse nuk reagojnë ose po dëshirojnë t'i mbyllin sytë ose nuk janë në nivel detyre.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kurrfarë vendimi nuk është marrë lidhur me këtë që po diskutojmë, këtu vetëm u vendos që të hyjë si pikë e rendit të ditës edhe ajo pikë. Po e citoj nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, ku thuhet, nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht në këtë ligj, vendimet e Kuvendit të Komunës aprovohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë. Pra këtu ceket,shumicës prej atyre që votojnë, ju nuk keni votuar as kundër e as nuk keni abstenuar, nuk keni marrë pjesë në votim.

z.Naim Çunaku, theksoi, meqë filluam ta trajtojmë këtë temë në gjysmë të mandatit pasi që gjysma e mandatit veç ka shkuar, dhe unë e potencova se është krijuar standard kjo, mirëpo kur i referohemi bazës ligjore nuk mund t'i referohemi pjesërisht por duhet t'i referohemi ashtu siç shkruan. Të gjithë i kemi disa letra që i mbajmë me vete, e them këtë sepse u lexua një dispozitë e Ligjit për vetëqeverisjes lokale e që besoj se i njëjti ligj është edhe ky që po e citoj unë, pra atë që e thash unë, për mendimin tim thuhet edhe në këtë Ligj sepse atë e kam marrë nga ligji, kurse ju e cituat nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale ku thuhet, nëse ndryshe nuk parashihet shprehimisht në këtë ligj vendimet e Kuvendit të Komunës aprovohen me shumicën e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë, mirëpo çka thotë ky Ligji për abstenimet,abstenimet regjistrohen me qëllim të themelimit të kuorumit por nuk merren parasysh në rezultatet e votimit, prandaj unë nuk di çka me qenë më i qartë këtu.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kjo pikë veç po hyn në rend të ditës, pastaj diskutojmë dhe e shqyrtojmë kur t'i vie radha. Këtu thuhettë pranishmit që votojnë, pra të pranishëm këta që votojnë, si të voton shumica kalon, por shumica e atyre që votojnë, ju nuk morët pjesë në votim, madje as unë, por kuorumin e keni bërë.

z.Naim Çunaku, theksoi, mendoj se u teprua ky debat, mirëpo dalloje kuorumin e mbajtjes së seancës prej kuorumit të vendimmarrjes sepse ato janë dy gjëra të ndryshme, vazhdoje ashtu sikurse deri më tani, kurse ne po themi që të mos krijohet si standard, përndryshe nuk është kushedi çfarë pike kjo, si hyni ose jo në rend të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, kemi dy propozime që kaluan për rend të ditës, propozimi i drejtoreshës së DPKGJ që të hiqen pikat e cekura nga rendi i ditës dhe propozimi i z.Haki Rudarit për përfshirje të një pike në rend të ditës, prandaj pa humbur kohë më shumë e vë në votim rendin e ditës me pikat si vijon;

1. Propozim Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024
2. Propozim vendim për përcaktimin e kompensimit të anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike-Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM "Pastrimi" sh.a
3. Caktimi i orarit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024
4. Të Ndryshme

Pas votimit Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 28 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet rendi i ditës për këtë mbledhje, me pikat si vijon:

1. Propozim Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024
2. Propozim vendim për përcaktimin e kompensimit të anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike-Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM "Pastrimi" sh.a
3. Caktimi i orarit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024
4. Të Ndryshme

1. Propozim Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, e paraqiti propozim Planin në fjalë, theksoi, dihet që të gjitha procedurat i ka kaluar plani i punës, duke filluar së pari nga ky Kuvend që është formuar komisioni prej të gjitha subjekteve politike, është mbajtur diskutimi publik më datë 09 janar 2024 dhe po ashtu është diskutuar disa herë nga anëtarët e komisionit dhe në fund komisioni përkatës ka vendosur që plani i punës të paraqitet për shqyrtim në Kuvend.

Kryesisht jemi orientuar që të gjitha Drejtoritë të përfshihen në planin e punës për të dhënë informata dy herë në vit, pastaj edhe Kryetari i Komunës, Auditori, dhe ato pika që i kanë propozuar drejtorët e Drejtorive që parashihet brenda këtij viti t'i procedojnë në Kuvend, mirëpo ne e dimë që shumë herë na dalin pika të reja, kërkesa të reja qoftë nga Ministrinë apo nga Drejtoritë e Komunës kështu që nuk ka mundësi që të gjitha të përfshihen.

Për orarin e mbledhjeve që u diskutua këtu afërsisht 1 orë, ne mbledhjet i mbajmë brenda çdo muaji kurse sa i përket datave të mbledhjeve besoj që ashtu sikurse mua edhe juve të gjithëve që jemi 35 anëtar/e të Kuvendit nuk do të na pëlqej ndonjë datë, e them këtë sepse po te pyesësh secilin prej nesh ka propozime tjera, kështu që është mirë të veprohet ashtu siç kemi vepruar ku mbledhjet kryesisht janë mbajtur në fund të muajit përkatës. Vlen të theksohet se në vitin e kaluar i kemi mbajtur të gjitha mbledhjet, pra nuk e kemi humbur asnjë mbledhje me përjashtim të muajit gusht kur ka qenë pushim. Përndryshe nëse duhet dhe e vlerësoni se duhet të caktohen data e mbledhjeve mund t'i caktojmë, por unë nuk po besoj që do të kemi mundësi t'iu përmbahemi.

Materialin e draft Planit të punës e kemi marrë në qoftë se keni ndonjë vërejtje por besoj se këtu s'ka çka të diskutohet sepse përfaqësuesit i kemi pas të gjithë në Komision dhe i kanë dhënë mendimet dhe sugjerimet e tyre, andaj pa humbur kohë, urdhëroni e hapi debatin.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë edhe herën e kaluar kam votuar kundër për anëtar të komisionit dhe e kam ditë se nuk mund të bëjnë asgjë dhe për këtë ka dal ashtu siç kam thënë. Këtu në plan të punës për vitin 2024 janë përfshirë 42 pika, mund t'i them fotokopje e planit për vitin 2023 e që prej 42 pikave 22 prej tyre as nuk janë përmend kurrë as nuk kanë dal kurrë dhe po i cekë ato që s'janë mbajtur kurrë, e ato janë; plani i prokurimit për vitin 2024 nuk ka ardh asnjëherë në Kuvend, Informatë e DSHPMSHP jo dy herë në vit por asnjëherë e që e kemi listuar këtu në muajin shkurt, në muajin mars i kanë cek 6 pika me u mbajtur prej tyre 3 s'janë mbajtur kurrë, informatë nga DPUMM asnjëherë s'ka pas informatë nga kjo Drejtori as për vitin 2022 e as në vitin 2023, besoj se ashtu vazhdon përsëri, pastaj informatë nga DKRS asnjëherë s'ka pas asnjë informatë, informatë nga DI asnjëherë, mandej informatë për gjendjen e ambientit në Komunën e Podujevës asnjëherë s'ka pas, informatë nga DA s'ka pas asnjëherë, në muajin maj nga DSHMS ka pas informatë njëherë në vitin 2023, e jo dy herë siç ceket tani për vitin 2024, a do të ketë informatë se di, informatë DPKGJ asnjëherë s'ka pas.

Raporti i performancës për vitin 2023 nuk është mbajtur asnjëherë as për vitin 2022, e as për vitin 2021, raporti i punës së komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës së Podujevës për vitin 2023 asnjëherë raport të tillë para Kuvendit s'kemi pas. Raporti 6 mujor i Kryetarit të Komunës ky e ka dhënë raportin një vjetor e jo atë 6 mujor, do të thotë njëri raport mungon, informatë nga drejtori i DBF-së s'ka, prapë e kemi informatën e DKRS-së në muajin nëntor dy herë në vit as kjo s'ka ndodh kurrë, as nga DBPZHR kurrë, prapë DI në muajin nëntor s'ka sjellë informatë. Raporti financiar në muajin tetor për janar-shtator as që ka ardh ndokush në Kuvend për të dhënë raport dhe as që është dhënë arsyeja e mos dhënies së këtyre raporteve kur dihet se në bazë të ligjit të financave këto raporte janë të obligueshme por s'ka ndodh as kjo. Informatë nga DSHPMSH e paraparë në muajin dhjetor as kjo s'ka ardh në vitin 2023 dhe nuk do të ndodh, informatë e

DPZHE as ky drejtor kurrë s'ka dhënë informatë edhe pse e ka obligim dy herë në vit, informatë nga DPUMM në muajin dhjetor as kjo informatë s'ka ardh dhe ky drejtor i kësaj Drejtorie s'ka dhënë kurrë një informatë të tillë, informata nga DA as kjo s'ka ndodh.

Nëse ne e bëjmë një plan sa për sy e faqe ose me i gënjye qytetarët ose ne me gënjye njëri tjetrin me ngritë dorën këtu me votu e pastaj me thënë se kemi me iu përmbajte këtyre pikave që janë 42 e nuk përmbahen 22 prej tyre, vazhdojeni. Këtu duhet me iu përmbajt pikave të planit të punës pastaj mos të vijne drejtorët për të dhënë informatë këtu, ne kërkojmë përgjegjësi prej tyre pse nuk vijne, por jo ju t'i pyesni ata a t'jua vëni pikën e rendit të ditës apo jo, përfshijeni pikë në rend të ditës e mos të vijne ata, pastaj ne do dalim e të ulemi aty në vend të tyre.

z.Adnan Zymeri, theksoi, sa i përket procedurave të përpilimit të planit të punës t'i (i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit) e ceke shumë mirë më herët që secili subjekt politik i ka pasë përfaqësuesit në atë komision, mirëpo detyra e këshilltarit të Kuvendit nuk mund të cunohet veç me propozimet e dhëna prej propozuesve të partive politike në komisionin përkatës, por e kemi të drejtën të japim propozime dhe të plotësojmë planin e punës për kundër asaj që po thua ti i keni dërguar përfaqësuesit dhe tash ne të mos japim propozimet tona, andaj nuk po e konsideroj që është e drejtë. Ajo që e ceku kolegu im më herët z.Ekrem Rrahmani pajtohem plotësisht për shkak se realizueshmëria e planit të punës në vitin e kaluar ka qenë shumë e ulët, por edhe përkundër kësaj unë po e konsideroj shumë të rëndësishme që duke marrë parasysh zhvillimet e fundit që kanë ndodhur në Komunën e Podujevës në aspektin e sigurisë, vrasjet tronditëse që kanë qenë dhe që na e kanë ul reputacionin edhe si Komunë në nivel nacional, Kuvendi mos të jetë vëzhgues i këtyre aktiviteteve por të marrë rolin e vet, shembull çka kanë bërë komunat tjera në këtë drejtim është se kemi raste kur njëra prej komunave e ka vendos në muajin mars shqyrtimin e raportit të informatës për aktivitetet të KKS-së, ne e dimë që ai Këshill është instrumenti i vetëm në komunë që merret me sigurinë në Komunën e Podujevës, andaj konsideroj që Kuvendi është shumë e rëndësishme ta ketë një raport prej KKS-së kur do që ne e vendosim.

Tema tjetër që është mirë të vendoset në plan të punës është edhe një informatë mbi sigurinë në Komunën e Podujevës, do të thotë këto tema i propozoj që të jenë pjesë e planit të punës, besimin e kam shumë të vogël që do të diskutohet për to qysh nuk është diskutuar për shumë tema që i ceku kolegu im z.Ekrem Rrahmani, por të paktën ky është propozimi im dhe ju ftoj ta votoni.

z.Haki Rudari, theksoi, pajtohem tërësisht me diskutimin e kolegut z.Adnan Zymeri nga radhët e LDK-së, pavarësisht që ne kemi pas përfaqësuesit në atë komision, përfaqësuesi i LVV-së nuk e din ndoshta çka unë propozoj ose ai tjetri apo përfaqësuesit e subjekteve tjera, seriozisht pajtohem që secili këshilltar edhe tani ka të drejtën të bëjë propozime. Pse ne mund të bëjmë një propozim siç e bërë kolegu z.Adnan Zymeri nuk paraqet kurrfarë problemi dhe nuk e qesim në pozitë të keqe komisionin që ka qenë sepse kemi të drejtë t'i japim disa propozime dhe sot miratohet plani i punës dhe pastaj vazhdojmë tutje.

Personalisht i kam dy propozime krahas kësaj që ka ardhë plani i punës prej komisionit, së pari kam një propozim që raporti nga Kuvendi i Komunës për vitin 2023 të hyjë si pikë e rendit të ditës në muajin shkurt, është e drejtë e imja të bëjë propozime, kurrfarë vërejtje s'kam te komisioni që se ka propozuar sepse është qëndrim dhe bindje e imja, si dhe po ashtu kam bërë një propozim në plan të punës për muajin shkurt ta kemi një raport nga Komitetet e themeluar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës siç janë Komiteti për Politikë dhe Financa si dhe Komiteti për Komunitete. Këto dy çështje propozoj që të hyjnë në plan të punës dhe atë muajin shkurt dhe besoj se vijne si pika të rendit të ditës dhe kurrfarë problemi s'ka.

Do të thotë do të thotë komisioni e ka kryer punën e vet dhe e ka sjellë planin në Kuvend kurse tani ne e kemi ende të drejtën për të bërë propozime, miratohet plani i punës dhe vazhdojmë tutje.

znj.Saranda Stublla, theksoi, vetëm një sqarim shtesë për asamblistin z.Ekrem Rrahmani, DPKGJ e ka mbajtur informatën bazuar në planin e punës në muajin e përcaktuar.

z.Ekrem Rrahmani, duke i'u përgjigjur parafolëses, theksoi, këtu në plan të Punës së Kuvendit shkruan dy herë në vit Drejtoria me dhënë informatë, ndoshta e tejkalova që thash asnjëherë dhe kërkoj falje, por e di që drejtoresha e DSHMS-së ka dhënë njëherë raport, po ashtu drejtori i DKA-së edhe pse unë hiç fort në qejf se kam, por raportet i ka dhënë e që ndoshta se përmenda dhe po i hy në hak, prandaj po e përmendi se raportet i ka dhënë, ndërsa drejtorët tjerë asnjëherë s'kanë dhënë asnjë informatë. Pra ju drejtoresh e DPKGJ e keni pas obligim dy herë në vit të jepni informata kurse keni jep vetëm një informatë, por edhe njëherë ju kërkoj falje që paraprakisht e potencova se nuk keni dhënë informatë fare.

Unë mendoj se drejtorët e Drejtorive duhet me qenë më të përgjegjshëm, nuk e di pse hezitojnë me dhënë informata dhe të tregojnë punët e tyre çfarë kanë bërë dhe çfarë jo, ndoshta edhe do t'i bënin pak reklamë vetit duke treguar për punët e tyre që i kanë kryer, pastaj ne i'u tregojmë a është ashtu apo jo, po lëvdohen pak më shumë apo jo. Pra duhet të respektohet Kuvendi i Komunës, të jepen informatat për qytetarët mendoj se kjo është legjitime dhe duhet të ndodhë andaj nuk e di përse iket nga kjo punë.

z.Arjant Topanica, theksoi, desha të ndërlihem shkurt me atë që u potencua disa herë se kemi qenë të gjitha subjektet pjesë e hartimit të planit të punës, nuk është e vërtetë që kemi qenë të gjithë anëtarët e subjekteve politike pjesë e hartimit të planit të punës së Kuvendit për arsye se qëndrimi jonë ka qenë që nuk do jemi pjesë e një plani të cilin po e shohim që vit pas viti nuk po zbatohet, madje as në përqindjen më të ulët të tij dhe kështu nuk e kemi parë të arsyeshme të jemi pjesë e një komisioni që harton një plan i cili nuk po zbatohet dhe nuk po merret seriozisht.

Është për të ardhur keq qasja që i bëhet akterëve që duhet të jenë pjesë e mbikëqyrjes së hartimit dhe zbatimit të planit të punës kurse ky plan nuk po zbatohet, andaj për këtë arsye desha ta korrektoj këtë sepse nuk kemi qenë pjesë e hartimit të një plani të punës dhe shpresojmë dhe duam të besojmë se nga ky vit do të merret më seriozisht ky plan dhe si i tillë të zbatohet në përpikëri për arsye se jemi të thirrur që t'ju qëndrojmë qytetarëve mbrapa, megjithatë për çka është i thirrur dhe çka jemi të thirrur ne si asamblist dhe ky Kuvend që t'ju dal në mbrojtje interesave të tyre kur ka për çka të jepet përgjegjësia.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, i nderuari z.Arjant Topanica, ti ke pranuar këtu në Kuvend që të zgjedhesh dhe je zgjedhë anëtar i komisionit me vota, pra të kanë votuar, a është kështu.

Pastaj të kemi thirr në komision dhe nuk ke ardhë njëherë, ke thënë jo në këtë kohë, ta kemi ndërruar edhe orarin më vonë por në fund ke thënë s'do të jem pjesë e këtij komisioni, kështu ka qenë rrjedha. Pse nuk janë kryer informatat në vitin e kaluar ne ato informata i kemi këtë vit.

Ne jemi për t'i realizuar dhe për me ardhë drejtorët për të dhënë informatat në Kuvend dhe për këtë arsye i kemi si pika të rendit të ditës në plan të punës. Ju po thoni s'janë mbajtur vitin e kaluar, mirëpo ndoshta këtë vit do të mbahen dhe do të insistojmë për këtë, normale me shpresë jetojmë.

z.Arjant Topanica, theksoi, secili i ka punët e veta dhe nuk mundemi ne të vazhdojmë duke i shtyrë prej një viti në vitin tjetër për arsye sepse informata e vitit 2023 nuk është e njëjtë si informata e vitit 2024 sepse kemi të bëjmë për periudha të ndryshme. Sa serioz ka filluar të zbatohet ky plan e kemi edhe raportin e janarit që as janari tash që po fillojmë nuk i ka pikat që i ka parapa ky plan i punës në mbledhjen e parë të tij, mirëpo shpresojmë se e keqja kur do dhe ku do që ndalet dhe përmirësohet është e mirë, kështu që shpresojmë se nga ky vit të zbatohet ky plan për shkak të mos seriozitetit, andaj të merret më seriozisht.

z.Naim Çunaku, theksoi, plani i punës i një Kuvendi në këtë rast i Kuvendit tonë komunal në rastin më të mirë nga ajo që e pashë dhe lexova, nga ajo që kemi pas edhe vitet e kaluara, me keqardhje është një refleksion i gjendjes së këtij Kuvendi, e them këtë sepse në këtë plan të punës që në rend të parë ish dashtë t’iu vë në spikamë anëtarëve të Kuvendit që të jemi në misionin që na përcaktohet në përfaqësim, në monitorim të ekzekutivit gjegjësisht në thirrje të llogaridhënies së Ekzekutivit karshi Kuvendit në vendimmarrje.

Kemi raste e që nuk po dua kësaj radhe t’i përmend që aq larg ka shkuar Ekzekutivi ku në një formë e numëron veten si diçka mbi Kuvendin dhe harron t’i lexoj dy shkronja ku thuhet organi më i lartë i Komunës është Kuvendi i Komunës, dhe ashtu siç e ceka edhe në mbledhjen e KPF-së po e cekë edhe tani se për vendimet e Kuvendit të Komunës disa pjesëtar të Ekzekutivit po i japim vetës të drejtë t’i “pleçojnë” ato, ndërsa po harrojnë se ata janë aty për t’i zbatuar vendimet e Kuvendit, kurse “pleçninë” e bën Kuvendi edhe duhet t’i përmbahen asaj.

Çka shohë të mangët në këtë raport është prej ditës kur është propozuar themelimi i komisionit, unë jam njëri prej atyre që kam qenë kundër dhe kam votuar kundër tij sepse që në start është përzier, është bërë një komision miks Ekzekutiv – Kuvend, e që mënoj se nuk ka diçka më shkelje flagrante se sa që atë i cili do të të jap llogari, ta ofrosh për të bërë plan e që ai duhet me të dhënë llogari, kjo ka qenë që e kam kundërshtuar.

Nga plani i vitit të kaluar kemi një avancim, pra nuk e them që po shihet vetëm zi, por dua të shohë edhe diçka bardh që ka ndodh dhe është për herë të parë që ka ndodh që ky plan ka dal në diskutim publik, mirëpo por se çfarë ka qenë ai diskutim publik do të duhej t’i bashkëngjitet raporti nga diskutimi publik sepse në fakt i dimë çfarë diskutime publike kemi dhe madje është goxha për keqardhje të thirrëmi në diskutim publik, ndërsa ne si anëtar të Kuvendit të mos kemi raport nga diskutimi publik. Para se të bëjmë një plan të ri, u fol që është dashur ta kemi raportin se sa është realizuar plani paraprak, sa kemi qenë ne në nivel të detyrës sipas planit të hartuar për vitin 2023 e që nuk e kemi pasë, andaj kështu siç ka ardh ky plan e tha dhe kolegu z.Ekrem Rrahmani dhe s’dua ta përsërisë, mirëpo kjo që po na ngjanë është vetëm një përmbushje formale e një ane juridike, por përmbajtje këtu diçka nuk ka, me vetë faktin që sot na u krijuan dilemat dhe na u shtuan minutat shtesë që do të na merr kohë (po paragjykoj ndoshta nuk është siç po them unë) dhe nuk do t’i afrohem caktimit të datave se kur do të mbahen mbledhjet e Kuvendit.

Dëgjova që u cekë nga dikush se ajo nuk është as Bibël e as Kuran dhe mund të ndryshoj sepse çdo këshilltar e ka të drejtën të propozoj pika qoftë për të shtuar apo për të hequr, mirëpo plani është ai se ku e shohim vetën ne në fund të vitit 2024 dhe si mendojmë ta luajmë rolin tonë si Kuvend. Diçka përmbajtje në këtë nuk ka, me vetë faktin se edhe datat janë të mangëta, nuk dëshiroj të them diçka tjetër, vetëm atë që duam ta bëjmë që mos të jemi pjesë e një vendimmarrje për një plan i cili për të mos qesharak po e them se as për së afërmi nuk i përmbush kriteret të jetë një plan ose udhërrëfyes i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nëse nuk ka propozime tjera atëherë ne duhet të shkojmë në votim, mirëpo ftoj z.Adnan Zymerin t’i paraqes edhe njëherë sakt propozimet e bëra për përfshirje në kuadër të planit të punës së Kuvendit për vitin 2024.

z.Adnan Zymeri, theksoi, propozimi i parë është, shqyrtimi i raportit / informatës për aktivitetet e KKSB-së, që i njëjti të vendoset në muajin mars, ndërsa propozimi i dytë ishte, informatë mbi sigurinë në Komunën e Podujevës, që e njëjta të na jepet nga Policia e Kosovës dhe atë në muajin nëntor ose kur do që e shihni më të përshtatshme, për mua nuk paraqet ndonjë problem kurdo që vendos Kuvendi sepse e rëndësishme është përmbajtja, propozimi im konkret ishte që kjo informatë të vije në muajin nëntor.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani i vë në votim propozimet e anëtarit të Kuvendit z.Adnan Zymeri, dhe atë:

-Shqyrtimi i raportit / Informatës së KKSB - (në muajin Mars)

-Informatë mbi sigurinë në Komunën e Podujevës, nga Policia e Kosovës - (në muajin Nëntor)

Njëzëri me 32 vota Për, nga anëtarët sa ishin prezent në sallë, mbështeten propozimet që në kuadër të Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2024 të përfshihen edhe pikat e propozuara nga anëtari i Kuvendit z.Adnan Zymeri, dhe atë:

-Shqyrtimi i raportit / Informatës së KKSB - (në muajin Mars)

-Informatë mbi sigurinë në Komunën e Podujevës, nga Policia e Kosovës - (në muajin Nëntor)

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, po ashtu anëtari i Kuvendit z.Haki Rudari e pati një propozim që ishte sjellja e Raportit të punës së Kuvendit për vitin 2023, dhe atë në muajin shkurt, andaj edhe këtë propozim e vë në votim.

Me 31 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë e Përmbajtur, (1 anëtar nuk votoi), mbështetet propozimi që në kuadër të Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2024 të përfshihet edhe pika e propozuar nga anëtari i Kuvendit z.Haki Rudari, dhe atë:

-Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023 - (në muajin Shkurt)

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani e vë në votim propozim planin e punës së kuvendit për vitin 2024 sipas materialit përkatës, përfshirë edhe plotësim ndryshmet e bëra sipas propozimeve të cekura më lartë.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 29 Vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), miratohet Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024, sipas propozimit përkatës dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje si dhe duke përfshirë edhe pikat e propozuara dhe mbështetura paraprakisht, si në vijim;

-Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023 - (në muajin Shkurt)

-Shqyrtimi i raportit / Informatës së KKSB - (në muajin Mars)

-Informatë mbi sigurinë në Komunën e Podujevës, nga Policia e Kosovës - (në muajin Nëntor)

2. Propozim vendim për përcaktimin e kompensimit të anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike-Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM “Pastrimi” sh.a

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës ju rikujtoj se anëtarët e këtij bordi / komisioni nuk kanë drejtë të jenë pjesë e mbledhjes sepse mund të jetë konflikt interesi.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, në emër të Grupit të LDK-së, ne propozojmë që të paguhet të gjithë aksionarët e të gjitha ndërmarrjeve publike lokale, dhe të mos ketë ndasi sepse është e pa drejtë, prandaj nëse hyjnë në kuadër të kompensimit të gjithë aksionarët e të gjitha ndërmarrjeve, atëherë e përkrahim, ndryshe jo.

z.Florent Hasani, theksoi, në emër të Grupit të LVV-së e mbështesim këtë propozim ashtu siç është paraqitur si pikë të rendit të ditës.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, neve Grupit të LDK-së nuk na bie të votojmë i nderuar Kryesues ngase në qoftë se e mban mend në këtë Kuvend kur janë propozuar anëtarët e komisioneve të aksionarëve, goxha moti është më 28 shkurt 2022, ne i kemi dhënë propozimet tona mirëpo na keni thënë se ju nuk bënë të jepni propozim sepse jeni në opozitë dhe ne i kemi numrat ju s'bën me qenë aksionar, andaj tani jemi kundër.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, KRM "Pastrimi" është Kompani Regjonale ku përbëhet prej 7 komunave dhe në kuadër të kësaj të gjitha komunat kanë nxjerrë një vendim të tillë për pagesë të aksionarëve që do të bëhet nga buxheti i Ndërmarrjes dhe këtë ta kemi të qartë sepse nuk preket buxheti i Komunës dhe se aksionarët nuk paguhen në asnjë Ndërmarrje Publike nga Komuna, por paguhen nga Ndërmarrja nëse veç ka mundësi buxhetori për t'i paguar këta aksionar. Tani bordi i Ndërmarrjes në fjalë ka marrë një vendim për t'i paguar këta aksionar dhe në fakt edhe në Ndërmarrje ka qenë një diskrepancë mes këtyre pagesave sepse e vetmja ka qenë Komuna e Podujevës / aksionarët e Komunës së Podujevës që nuk janë paguar ngase për të gjithë aksionarët e komunave tjera që janë 6 komuna tjera paguhen, dhe meqë kjo është një vendim i Ndërmarrjes dhe paguhet prej buxhetit të Ndërmarrjes nuk e di a ka mundësi që ne të nxjerrim vendim për t'i paguar gjithë aksionarët e Ndërmarrjeve pa pëlqimin e atyre Ndërmarrjeve.

Tani ne e dimë që në Komunën tonë kemi Ndërmarrje Publike "Stacioni i Autobusëve", dhe Ndërmarrjen Banesore e cila po thuajse është inekzistente për shkak të numrit të punësuarve.

Mendoj se Kuvendi nuk ka mundësi dhe të drejtë të nxjerrë vendim për pagesën e aksionarëve meqë duhet paraprakisht pëlqimi i Ndërmarrjes sepse buxheti është i Ndërmarrjes jo i Komunës.

Në këtë rast unë edhe njëherë ju sqaroj se 6 komunat tjera që janë aksionare në "Pastrimi" e kanë nxjerrë një vendim të tillë, është vetëm Komuna e Podujevës që nuk e ka nxjerrë dhe tani Ndërmarrja në fjalë i ka propozuar dhe kërkuar Kryetarit të Komunës që të nxjerrë një vendim i tillë në mënyrë që në një formë të bëhet një lloj barazimi me të gjitha Komunat tjera aksionare, dhe në këtë aspekt Kryetari i Komunës është obliguar të propozoj në Kuvendin e Komunës që të nxirret vendim dhe atë vetëm për anëtarët e komisionit që janë nga Kuvendi, tani kushdo qofshin ata. Këto janë procedurat dhe kërkohet nga ne të nxjerrim vendim me të cilin Komuna lejon pagesën e aksionarëve që do të bëhet nga Ndërmarrja "Pastrimi" dhe buxheti i Ndërmarrjes e cila paraprakisht ka marrë vendim për këtë çështje dhe vetëm pret vendimet e komunave.

Tani nuk e shoh krejt në rregull që të votohet ose jo për pagesë të gjithë aksionarëve të të gjitha Ndërmarrjeve publike Lokale që janë të caktuar prej Kuvendit sepse për anëtarin nga radhët e Ekzekutivit vendos Kryetari i Komunës se a dëshiron apo jo, kurse për anëtarët e zgjedhur nga përbërja e Kuvendi vendos vet Kuvendi i Komunës, prandaj kjo është në pika të shkurtra procedura e kësaj çështje. Ndërmarrja në fjalë na janë drejtuar edhe me shkrim dhe i kemi e-mailat përkatëse ku kanë kërkuar një gjë të tillë e që pastaj edhe Kryetari i Komunës ka qenë në një far forme i obliguar ta paraqes në Kuvend këtë çështje.

Përndryshe kur të funksionalizohen dhe të fuqizohen ekonomikisht Ndërmarrjet tona tjera lokale, atëherë sigurisht gjithsecila do të nxjerrë një propozim për t'i paguar aksionarët e vet përveç anëtarëve të bordit që është obligim për t'i paguar.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, i nderuar drejtor i DSHPMSH, e di që Kompania në fjalë i paguan sepse e kam lexuar materialin dhe është arsytimi aty, paga minimale e një punëtori që e merr pagën më të vogël në Ndërmarrje, paguhen aksionarët, mirëpo në komunat tjera si ajo e Prishtinës ka ndodh që Kryetari e ka marrë vendimin, jo Kuvendi, madje unë nuk e kuptoj përse edhe u ardhë këtu ky propozim. Në Prishtinë me vendim të Kryetarit kanë vazhduar me i paguar aksionarët kompanive, atje janë Ndërmarrje më të mëdha dhe kanë buxhetin ndryshe dhe paguhen në të gjitha

Ndërmarrjet, diku rreth 350 € sa është paga minimale e një punëtori, mirëpo përse neve na është sjell ky propozim në Kuvend nuk arrita ta kuptoj, nëse e din pak më gjerësisht na e thoni.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, ndoshta mbeta borxh për këtë, mirëpo unë e potencova edhe më parë që vendimin për të emëruarit nga Ekzekutivi e merr Kryetari i Komunës ndërsa për asamblistët vendimin e merr Kuvendi dhe kjo ka ndodh i nderuar zotëri Rrahmani në 6 komunat tjera, unë i kam në e-mail që mi kanë dërguar këtu vendime të tillë të ngjashëm të Komunës së Lipjanit dhe Komunës së Obiliqit të cilat i kanë nxjerrë kohë më parë në vitin 2022. Për anëtarët e emëruar nga Kuvendi nuk mund të marrë vendim Kryetari, për këta anëtar merr vendim Kuvendi i Komunës dhe i propozohet kompanisë, por në këtë rast me propozim të kompanisë siç e thash më herët.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nëse merret ky vendim sot, pagesa a do të bëhet retroaktive prej datës kur janë emëruar në shkurt të vitit 2022, apo do të paguhet prej kohës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, përgjigje parafolësit, theksoi, kërkesa është për pagesë retroaktive mirëpo vetëm për vitin 2023, jo për 2022, pastaj vazhdon me pagesën e tyre ashtu siç siç e kanë edhe komunat tjera.

z.Bashkim Sylja, theksoi, është e vërtetë se pagesa bëhet prej Ndërmarrjes publike mirëpo të gjithë ne e dimë që këtë Ndërmarrje në vitin e kaluar e kemi subvencionuar si Kuvend dhe në njëfarë forme kjo i bie që mjetet e qytetarëve janë nga buxheti i Komunës sonë dhe normalisht ajo ka edhe të hyra që inkason nga puna e saj, prandaj mendoj se do ishte mirë që kjo çështje të rregullohej edhe për bordet / komisionet tjera e jo vetëm për një bord të aksionarëve sepse po diskriminohen tjerët, siç është Ndërmarrja “Stacioni i Autobusëve” i cili ka 7 muaj dhe asnjë cent nuk e kanë marrë, kështu që nuk po më duket në rregull një kompanie ose një bord të aksionarëve me t’i bëhet pagesa ndërsa aksionarëve dhe bordeve tjera jo.

Do të ishte mirë që të paktën në seancën e ardhshme të gjendet baza ligjore dhe të rregullohet kjo çështje edhe për aksionarët e ndërmarrjeve tjera.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, nuk e di sa u dëgjua me vëmendje dhe ndoshta në këtë sallë jemi keqkuptuar paksa apo nuk kam qenë mjaftueshëm i qartë, por unë e thash që në fillim se një propozim vendim të tillë e bënë/ekzekuton Ndërmarrja, jo Komuna sepse nuk paguhet prej buxhetit të Komunës. Pra Komuna nuk mundet pa propozim të Ndërmarrjes të thotë paguaj komisionin e aksionarëve, komisione të cilat nuk paguhet në asnjë Ndërmarrje publike tjetër prej Komunës, por prej Ndërmarrjes. Tani sa është Ndërmarrja e fuqishme dhe ka buxhet t’i paguaj aksionarët përveç Bordit të drejtorëve që është obligative i nderuar Bashkim Sylja, ndërsa për aksionarët merr vendim Ndërmarrja, nuk mund të merr vendim Komuna.

Stacioni i Autobusëve në momentin që të forcohet dhe të bëhet e zojna e vetit në njëfarë forme, ajo mund të nxjerrë vendim të tillë, aksionarët janë ata që e udhëheqin Bordin e secilës Ndërmarrje dhe ata mund të angazhojnë Bordin për marrjen e një vendimi të tillë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, plotësisht pajtohem me drejtorin parafolës z.Bahri Selimi, mirëpo ne të gjithë e dimë në çfarë gjendje është Stacioni i Autobusëve dhe çfarë gjendje ka qenë kur e kemi marrë ne, do të thotë nuk kanë pas mundësi as pagesat për punëtor të kryhen e lëre më të formojë Bord, por në këtë Kuvend keni sjellë dhe e kemi subvencionuar atë me shuma 10,000.00€ e 20,000.00€, do të thotë me u marrë një vendim prej Qeverisë dhe Ekzekutivit për t’u subvencionuar Stacioni i Autobusëve, pra ta kenë një buxhet të paktën anëtarët e Bordit të Drejtorëve, nuk po them për aksionarët por për anëtarët e Bordit sepse ata e kanë sjellë gjendjen deri në këtë pikë. Tani paguhet me rregull të gjithë punëtorët, pra dua të them në njëfarë formë që puna e tyre të kompensohet, thjeshtë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, mendoj se është mirë që për ata aksionarët e kompanive tjera komunale të bëhet një zgjidhje, por për këtë mbledhje nuk jemi të përgatitur sepse normalisht që duhet të bëhen propozim vendimet për mënyrën e pagesës së tyre e që për t'i paguar duhet të ketë buxhet ose duhet subvencionuar kompaninë dhe përmes atyre mjeteve t'i marrin pagesat aksionarët. Tani edhe unë e mbështes që për aksionarët e kompanive të bëhet një zgjidhje sepse punën e kryejnë njëjtë, prandaj është mirë që në një mbledhje të ardhshme ta marrim një vendim sepse sot nuk jemi të përgatitur për marrjen e një vendimi të tillë, pra mendimi im është që këtë çështje ta lëmë për një mbledhje të ardhshme, të diskutojmë me Drejtoritë dhe Kryetarin e Komunës, pastaj të sillim propozim vendimi në Kuvend edhe për pagesën e aksionarëve tjerë dhe bordeve tjera. Kështu që për këtë kompani nuk kemi më çfarë të diskutojmë edhe pse të drejtën e fjalës nuk mund t'ia mohojmë askujt, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën.

Pra ky ishte vetëm një mendim i imi, përndryshe propozimin e z.Qëndrim Softolli mund ta vëmë në votim, por nuk jemi të përgatitur për atë çështje.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, kam një pyetje dhe kërkoj sqarim sa i përket asaj që ceku drejtori parafolës z.Bahri Selimi, nëse kompania ka caktuar kompensimin e aksionarëve atëherë përse ne po marrim vendim për buxhetin e dikujt tjetër, nëse veç nuk është në kompetencën e Kuvendit të Komunës, këtë nuk e kam të qartë a ka apo jo bazë ligjore ky propozim vendim.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, vendimi që merr Kuvendi i Komunës është për t'i paguar asamblistët që janë trupë e komisionit në fjalë të cilët janë të angazhuar në atë Ndërmarrje e cila ka kërkuar një vendim se a dëshiron Komuna që edhe ata të jenë pjesë e asaj pagese, pra ata e kanë kërkuar një gjë të tillë. Secila komunë aksionare e kësaj kompanie e ka dërguar një vendim të tillë për asamblistët e vet që janë pjesë e komisionit. Pra në një formë ne po marrim vendim për t'i paguar asamblistët tanë të cilët pastaj mund të jenë pjesë e pagesës që kompania i paguajnë.

Unë edhe njëherë po e them, për ndërmarrjet tjera ne mund të marrim vendim vetëm nëse i paguajmë me paratë tona e që për këtë s'ka mundësi ligjore, nuk është e drejtë e rregulluar kjo çështje, mirëpo në rastin në fjalë ne po marrim vendim për 2 assembleistët që janë anëtarët të komisionit të aksionarëve për t'juar lejuar pagesën Komuna e Podujevës krahas anëtarëve tjerë të komunave tjera pjesëmarrëse në Ndërmarrjen përkatëse të cilët paguhen.

z.Haki Rudari, theksoi, duke dëgjuar diskutimin e gjithë kolegëve dhe drejtorit parafolës, ne kemi një propozim vendim për caktimin e kompensimit të një ndërmarrje, po në të njëjtën kohë edhe unë pajtohem dhe nuk është mirë të bëjmë pagesa selektive për arsye se duhet gjetur mënyrat që edhe për anëtarët e tjerë të komisioneve të bëhen pagesat. Në seancën e radhës duhet gjetur mënyrën, duhet të vij siç ka ardh ky propozim vendim tani, duhet të gjendet ana ligjore dhe të vij propozim vendimi për të tjerët që janë të përfaqësuar në ndërmarrjet tjera si "Eko Llapi", "Kosova Trans", "Ndërmarrja Banësore", e të tjera nëse ka, pra po e përfundoj, duhet gjetur ana ligjore edhe për të tjerët në seancën e radhës dhe besoj se do e marrim vendimin që edhe ata të paguhen konform ligjit dhe rregullores.

z.Bashkim Sylja, theksoi, është mirë që ky propozim vendim që është sjellë në Kuvend të përkrahet sepse komunat tjera normalisht e kanë përfunduar këtë procedurë, andaj përse të mbeten vetëm dy anëtarët e Komunës tonë pa e gëzuar këtë të drejtë. Kjo bëhet si praktikë në të ardhmen kur të formohen komisionet dhe e dimë që kanë përgjegjësi dhe subvencionohen për punën që e bëjnë, kështu që është mirë të kryhet kjo punë.

z.Arjant Toponica, theksoi, unë sërish kërkoj një sqarim sepse nuk e di a jemi shumë të qartë, do të thotë ne të marrim vendim që kompania me pasë të drejtë t'i paguaj dy aksionarët e Kuvendit të komunës së Podujevës.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, ne duhet që kompanisë t’ia japim një lloj pëlqimi që ajo të mund ta bëjë pagesën.

z.Arjant Topanica, theksoi, nëse ata meqenëse janë pjesë e saj përse nuk mundet kompania t’i paguaj me buxhetin e saj pa na pyetur neve si Kuvend, unë s’po e kuptoj këtë.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSH, theksoi, kompania përkatëse e kanë kërkuar si dëshmi që këta janë aksionar pra le të dihen me emra dhe mbiemra se kush janë aksionarë atje.

z.Arjant Topanica, theksoi, edhe njëherë pyes, pasi që është buxheti i tyre përse të pyetemi ne për këtë pagesë. Kush janë aksionarët ne e kemi dërguar listën kur janë votuar dhe ata e dinë se kush janë, pra qysh tani kërkojnë ta dinë se kush janë ata aksionarë, unë nuk e di a ka bazë ligjore.

Dhe atëherë kur janë votuar aksionarët ne nuk jemi pyetur fare si Grup, por jemi anashkaluar andaj ju takon juve që ta merrni një vendim të tillë për ata aksionarë që i keni dërguar në atë ndërmarrje.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, besoj se diskutimi për këtë pikë të rendit të ditës përfundoj, prandaj e hedhë në votim propozim vendimin që t’iu lejohet kompensimi anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike-Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM “Pastrimi” sh.a, sipas propozimit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 18 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë e Përmbajtur (të tjerët nuk votuan) miratohet Propozim vendimi për lejimin e kompensimit të anëtarëve të Komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike-Kompania Regjionale e Mbeturinave KRM “Pastrimi” sh.a, sipas propozimit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

3. Caktimi i orarit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024

z.Haki Rudari, në cilësinë e propozuesit të kësaj pike, theksoi, erdhëm te një pikë e cila ndoshta u zgjatë e stërgjatë shumë e që për mua nuk ka problem sepse gjithkush e ka të drejtën e diskutimit.

Të nderuar koleg, duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe në Rregulloren e Punës së Kuvendit, nenet 87 dhe 88 propozoj; caktimin e orarit të mbajtjes së seancave të Kuvendit të Komunës së Podujevës dhe atë që mbledhjet të mbahen si vijon; në muajin shkurt më 29.02.2024, në muajin mars më 28.03.2024, në muajin muaji prill më 30.04.2024, në muajin maj më 31.05.2024, në muajin qershor më 27.06.2024, në muaji korrik më 30.07.2024, muaji gusht te jetë muaj i pushimeve, pastaj në muajin shtator mbledhje të jetë më 02.09.2024, në muaji tetor më 01.10.2024, në muaji nëntor më 26.11.2024, dhe në muaji dhjetor më 27.12.2024, ndërsa Mbledhjet e KPF-së të mbahen rregullisht para mbledhjeve të Kuvendit,

Po ashtu krahas kësaj që unë e lexova, askush nuk e cenon të drejtën e thirrjes së mbledhjeve solemne që në këtë rast e kemi datën 17 shkurt për Ditën e Pavarësisë së Kosovës, 5 maji Dita e Dëshmorëve, Ditën e Çlirimit të Komunës dhe ditët tjera.

Unë i kam rekomanduar vetëm mbledhjet e rregullta të Kuvendit, prandaj po besoj që është një propozim i mirë, por në fund të fundit këshilltari e ka të drejtën e vet të votimit.

Mbledhjet e solemne le të jenë pjesë e këtij propozimi të cilat i ceka më lartë.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, a ka ndonjë propozim lidhur me këto data të prezantuara nga z.Haki Rudari. Këto data të mbledhjeve që i propozoj parafolësi prapë mund të jenë 7 ditë më herët ose më vonë, pra ka një mundësi të tillë, mirëpo nëse ndokush dëshiron ta marrë fjalën për ndonjë propozim për ndryshimin e këtyre datave urdhëroni.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nuk arrita t'i shkruaj të gjitha këto data, por çka pata mundësi të mbaj në mend dhe që mu duk se kolegu z.Haki Rudari e tha që më 1 tetor të mbahet mbledhja për muajin tetor, ne e dimë që Ligji për menaxhimin e financave e obligon Kryetarin e Komunës që më datë 30 tetor të sjellë raportin 9 mujor financiar gjë që nuk ka ndodhur në vitin e kaluar dhe shpresoj se këtë Kryetari i Komunës nuk e bënë traditë që të mos e sjellë në Kuvend raportin financiar 9 mujor.

Tani nuk e di përse kolegu z.Haki Rudari i iku kësaj date kur e propozoj që të mbahet mbledhje shembull më datë 1 tetor për seancën e tetori, kurse seanca e muajit nëntor u propozua për datë 26 nëntor 2024, ndërsa Ligji i cekur e obligon Kryetarin e Komunës që deri më 30 tetor të sjellë raportin financiar 9 mujor në fund të muajit tetor. Pra kjo i bie që raporti 9 mujor financiar nuk vie fare në Kuvend.

z.Haki Rudari, theksoi, jo nuk ka problem për data i nderuar z.Ekrem Rrahmani, unë e dhashë një propozim dhe nuk e kam marrë atë në aspektin që u përmend, ndoshta duket paksa ashtu, por si hapësirë e kam marrë datën 1 tetor për hir se është 30 shtatori afati i fundit i buxhetit dhe patëm një datë diku me 1 ose 2 shtator, dhe për çdo rast nëse me 1 ose 2 shtator nuk mund ta miratojmë buxhetin, natyrisht shumica e komunave e di që këtë e bëjnë ditën e fundit dhe duke u nisur nga rregullorja që e tha z.Arjant Topanica që 7 ditë pune mund të lëviz data, para ose mbrapa, mundet ndoshta kjo mbledhja e caktuar për 1 tetor, ndoshta me 23 ose 24 shtator, pastaj mbledhja e tetorit mund të shtyhet për datën 7 ose 8 tetor, fare nuk ka të bëjë me raportin financiar për arsye se ato çka janë të parapara, jam ithtar i respektimit të planit të punës.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, edhe unë një sqarim paksa, për datën e shtatorit ju e dini që së pari duhet të na vije pëlqimi prej Ministrisë përkatëse për miratimin e buxhetit, pastaj ne duhet ta bëjmë miratimin e buxhetit në Kuvend.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk isha tërë kohën këtu sa u diskutua për këtë pjesë dhe nuk po i jap vetës të drejtë të merrem me data tjera, por nga ajo që kuptova derisa isha prezent këtu konkretisht të mbledhja e shtatorit dhe mbledhjen e shtatorit po e shoh se është propozim data 2 shtator, por kur kemi para sysh që një prej mbledhjeve më të rëndësishme të Kuvendit të Komunës është mbledhja e miratimit të projektbuxhetit, duhet t'i kemi parasysh edhe specifikat që na obligon Ligji për financat, për atë edhe në fillim kam hezitur ta mbështes që tani të formohet dhe e pata ndër dije që mund ta kemi një komision.

Me qëllimin më të mirë po mundohem të sqaroj diçka, në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, më 1 shtator Kryetari i Komunës, pas diskutimeve publike dhe pas hartimit të buxhetit, duhet t'ia dorëzoj Kuvendit të Komunës projektbuxhetin, kurrë nuk ka ndodh kjo, por Ligji e thotë kështu dhe të paktën mos të bëjmë diçka në kundërshtim me ligjin e që prej 1 shtatorit deri më 30 shtator është obligim i Kuvendit Komunal të organizon dëgjime publike dhe pastaj data e fundit e miratimit të buxhetit skadon më 30 shtator. Nëse ne sot caktojmë data me 1 dhe 2 shtator ndërsa Kryetari e dorëzon buxhetin në Kuvend, të paktën ish dashtë ta dorëzoj ashtu siç e thotë ligji po flas me 1 shtator, atëherë ne po ia shkurtojmë afatin vetit si Kuvend ose po heqim dorë nga një obligim ligjor të cilin e kam potencuar disa herë në foltore që prej 1 shtatori deri më 30 shtator është në përpunim dhe diskutim publik i kuvendarëve me publikun dhe marrja e vendimit deri në datën finale më 30 shtator. Prandaj këtu të kemi kujdes sepse kemi të bëjmë me afate ligjor edhe nuk duhet të marrim një vendim që është në kundërshtim me afatet ligjore, përndryshe mund të jetë si datë rrëshqitëse data 27 ose 28 por jo më shumë se data 27 sepse në një formë po e cungojmë një të drejtë elementare të diskutimit publik të Kuvendit me qytetarin.

z.Haki Rudari, theksoi, për atë arsye ishte edhe propozimi me datë 1 tetor dhe ashtu siç e tha kolegu z.Arjant Topanica më herët rreth atyre lëvizjeve që mund t'i bëjë Kryetari dhe Ekzekutivi, tani ajo seancë e caktuar për 1 tetor mund të vije më datë 25 apo 26 shtator, pra kjo datë mund të lëvizë. Unë e bëra propozimin, mirëpo datat mund të lëvizin, Kryetari dhe Ekzekutivi na e sjellin më 27 shtator dhe jemi në rregull apo 29 - 30 shtator dhe mund të miratohet buxheti, pra unë e lash hapësirën për me lëvizë këto data. Arsyeja pse propozova në fillim të shtatorit pak a shumë kolegëve ju thash jo zyrtarisht se ne kemi muajin gusht që është pushim dhe pastaj nëse shkojmë në fund të shtatorit besoni se po bëhen dy muaj dhe besoni që në fillim të shtatorit shumë Kuvende komunale kanë seanca, kjo është arsyeja.

z.Naim Çunaku, theksoi, me qëllimin më të mirë po sqarohemi, nuk jemi sot për të caktuar një datë dhe se qysh sot po paragjykojmë që asaj date mos t'i përmbahemi ngase kur propozojmë datën dhe lëmë mundësi rrëshqitëse në një formë ne vet nuk jemi ata që mund të bëjmë një dakordancë. Pra me qëllimin më të mirë, kur të thuash datën 2 shtator të paktën duhet të kesh diçka specifike që duhet ta lidhësh me datën 2 shtator, qoftë të kërkosh përgjegjësinë për monitorimin e ndonjë afati ligjor që ta lidhësh me atë datë, mirëpo data 2 shtator krejt çka mundem me dalë prej asaj situate që e pranoi edhe Kryesuesi i Kuvendit dhe kolegu z.Haki Rudari është shumë normale mund t'i mbajmë dy seanca, mirëpo data 2 shtator na përjashton nga një obligim ligjor që Kuvendi duhet të mbaj diskutime publike për buxhetin dhe në një formë vet vullnetarisht po hiqet dorë, madje as në plan të punës nuk e parasheh një diçka që është shkelje ligjore, prandaj në këtë kontest ishte ajo, nëse i mbajmë dy mbledhje atëherë të mbetet propozimi z.Haki Rudari që me 2 shtator dhe 30 shtator të mbahen, pastaj ajo data 30 shtator mund të lëvizë më 27 ose 28 shtator, ndërsa data 1 tetor nuk vjen në shprehje sepse me 1 tetor Qeveria pastaj ka punë me pushtetin lokal sepse kjo hiqet prej kompetencës dhe intervenon Ministria sepse pastaj zyrtari për menaxhimin e buxhetit komunal shkon me 1/12 e një viti, por të mos hyjmë në këto tema. Data 1 tetor nuk mund të kalkulohet.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, ta kemi parasysh se muajin gusht gjithëherë e kemi pas muaj të pushimit përveç ndonjë rasti të mundshëm që mund të ketë ndonjë urgjencë që paraqitet për diskutim.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit, muajin gusht, është një prej të paktave komuna për të mos e vetmja që e kemi shpallë muaj pushimi. Nuk po e vërej se a është prezent këtu drejtori i DBF-së, por gushti nuk është muaj i përshtatshëm për pushim, arsyeja pse dihet, KAB, data 30 qershor, pastaj hyjmë në fazën e përgatitjes së buxhetit dhe fazën më intensive të konsultimeve publike, kurse ne i japim vetit pushim.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, të jemi të sigurtë në mënyrë që të dalim mirë, data 29 shtator është ditë e diele, ne mund ta propozojmë këtë që të jetë data 27 shtator, tash mbledhja e tetorit na ka mbet në fillim të muajit.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues, të mbesin për muajin shtator të parashikuara dy mbledhje, 2 shtator dhe 27 shtator.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, tani muaji tetor po na jetë shumë afër, në qoftë se më 2 shtator mbahet mbledhja atëherë materiali dhe thirrja duhet të dërgohet 7 ditë pune më herët, prandaj ne duhet të diskutojmë dhe të dalim sa më mirë.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar Kryesues, për atë arsye në fillim e cekëm që e kemi telash caktimin e datave, kjo që t'i po e shfaq tash nuk bëjmë kurrfarë shkelje edhe nëse në muajin e pushimit e dërgojmë materialin, aty thuhet kur mbahet seanca dhe fundja është me 2 shtator por kjo mund të lëviz 5 ose 6 shtator por si orientim të jetë data 2 shtator.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, mendoj nëse mbahen dy seanca në muajin shtator duhet me lëviz edhe mbledhja e muajit tetor, nëse e mbajmë mbledhjen më datë 27 shtator siç e propozuat edhe për datën 2 tetor e potencova më herët që është raporti 9 mujor prandaj e them se mbledhja e tetorit duhet të jetë në fund të muajit tetor.

z.Naim Çunaku, theksoi, afatet ligjore për raportim që përcaktohen me Ligj të financave atyre ne duhet t'i përshtatemi e jo ato neve, dhe kur kemi të bëjmë me këtë raportet periodike financiare janë obligim ligjor që deri në 30 ditë pas përfundimit, do të thotë 3 mujori e ka afatin deri më 30 prill, kurse te tetori ky 7 mujori po na del keq, duhet të del ajo që e potencoi z.Ekrem Rrahmani, 27 eventualisht 30 tetor, përndryshe jemi në kundërshtim me afatet që nuk varen prej neve sepse ato janë afate të dikujt tjetër.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, po i rishikojmë edhe njëherë datat e propozuara për caktimin e orarit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024, pra mbledhja e muajit shkurt më datë më 29 shkurt 2024, mbledhja e muajit mars më datë 28 mars 2024, mbledhja e muajit prill më datë 30 prill 2024, mbledhja e muajit maj më datë 31 maj 2024, mbledhja e muajit qershor më datë 27 qershor 2024, mbledhja e muajit korrik më datë 30 korrik 2024, muaji Gusht pushim përveç paraqitjes së ndonjë kërkesë të veçantë për mbajtje të mbledhjes, pastaj mbledhjet e muajit shtator më 02 dhe 27 shtator 2024, mbledhja e muajit tetor më datë 28 tetor 2024, mbledhja e muajit nëntor më datë 26 nëntor 2024, dhe mbledhja e muajit dhjetor më datë 27 dhjetor 2024. Këto ishin datat e propozuara për caktimin e orarit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024, nëse ndokush nga ju ka ndonjë propozim tjetër urdhëroni nëse jo atëherë shkojmë në votim këtë orar së bashku me çështjet tjera të cilat duhet bashkëngjitur në vendim.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 25 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), me vendim miratohet caktimi i orarit të mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 si në vijim:

Mbledhja e muajit Shkurt më datë;.....29 shkurt 2024

Mbledhja e muajit Mars më datë;.....28 mars 2024

Mbledhja e muajit Prill më datë;.....30 prill 2024

Mbledhja e muajit Maj më datë;.....31 maj 2024

Mbledhja e muajit Qershor më datë;.....27 qershor 2024

Mbledhja e muajit Korrik më datë;.....30 korrik 2024

Muaji Gusht;..... pushim, përveç paraqitjes së ndonjë kërkesë të veçantë për mbajtje të mbledhjes.

Mbledhjet e muajit Shtator më;.....02 shtator 2024 dhe 27 shtator 2024

Mbledhja e muajit Tetor më datë;.....28 tetor 2024

Mbledhja e muajit Nëntor më datë;.....26 nëntor 2024

Mbledhja e muajit Dhjetor më datë;.....27 dhjetor 2024

Para çdo mbledhje të Kuvendit të Komunës sipas këtij vendimi, Komiteti për Politikë dhe Financa paraprakisht mban mbledhje ku shqyrton dhe rekomandon pikat e rendit të ditës.

Pavarësisht këtij vendimi, Kuvendi i Komunës mund të mbaj edhe mbledhje tjera të cilat parashihen me legjislacionin në fuqi, si mbledhje solemne, të jashtëzakonshme, urgjente dhe mbledhje tjera sipas situatave të paraqitura.

Datat e mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit sipas këtij vendimi, mund të lëvizin më së shumti 7 ditë para ose pas, nga planifikimet në nenin 1.

4. Të Ndryshme

z.Arjant Topanica, theksoi, kam një kërkesë nga Lagjja Mehana në fshatin Sfeçël për rregullimin e një rruge e cila ka qenë në projekt, rrugë kjo afër urës së fshatit Sfeçël, prandaj nga ana e Drejtorisë përkatëse kërkoj që kjo kërkesë të merret parasysh në afatin më të shpejt të mundshëm.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, trotuari përball Kafiterisë “Pranvera” përse nuk shtrohet asnjëherë, do të thotë prej pjesës së kthesës deri në gjysmë të rrugës të “Univertrade”. E di që ka probleme kontestuese, por trotuari i takon rrugës sepse qytetarët vijnë deri në atë pjesë të rrugës në trotuare kurse prej asaj pjese nuk ka trotuar, unë e di se aty ka konteste pronësore, mirëpo trotuari i takon qytetit. Më janë bërë shumë pyetje për këtë, prandaj presim shpjegim nga ana e drejtorit të DSHPMSh.

Po ashtu një lagje në fshatin Lupç kanë bërë goxha moti kërkesë për ndriçim, konkretisht fjala është për rr.”Hazir Bajgora”, pres përgjigje nga drejtori i Drejtorisë përkatëse .

z.Qëndrim Softolli, theksoi, para disa dite është mbajtur një punëtori e Kryetarit me Ekzekutivin e Komunës, edhe pse këtu nuk është Nënkryetarja e Komunës e as drejtori i DBF-së, jam kurioz ta dijtë deri ku kanë shkuar punimet e asaj punëtorie, sa ishte kostoja e asaj vizite, dhe ku i morën paratë.

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, theksoi, i nderuari z.Ekrem Rrahmani, trotuari të Kafiteria “Pranvera” është çështje që e kemi diskutuar gjatë dhe e kemi shqyrtuar si problem, jemi të njoftuar me atë, siç u tha edhe nga ju, është në kontest, mirëpo ne do të mundohemi që ta zgjidhim këtë problem edhe pse duhet bashkëpunim sepse është pronë e atij pronarit që mendon, andaj pa u zgjidh kontesti është problematike kjo çështje, mirëpo besoj se do e rregullojmë atë problem.

Ndriçimi publik të lagjja e Bajgorëve në fshatin Lupç, unë e di që me projektin e fundit ndriçimin publik e kemi bërë në lagjet Kaçiu dhe Bajgora si dhe në rrugën kryesore të fshatit Lupç prej shkollës deri të Lagjja e Bajgorëve lartë, andaj mos rastësisht ka qenë kërkesa për ndonjë defekt apo ka qenë kërkesë e re që do të thotë nuk është funksionale, kjo nënkupton që ka defekte, ka prishje, por tani kontratën e kemi të hapur për mirëmbajtje dhe jemi duke punuar në vazhdimësi, nëse ka kërkesa për defekte kjo nënkupton se ndriçimi është bërë por ka defekte sepse unë e di që në dy lagjet e cekura vitin e kaluar e kemi bërë ndriçimin publik dhe shumë shpejtë do ta rregullojmë këtë problem nëse kemi të bëjmë me mirëmbajtjen e tij sepse jemi duke punuar në këtë drejtim.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:15

Procesverbalin e mbajti;

Enis Sheholli

Osmon Bajrami

Nr.Prot.01-060/04-0007939/24

Podujevë,

30 janar 2024

Kryesuesi i Kuvendit

Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 17 shkurt 2024, në mbledhjen Solemne të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VII,

E mbajtur për nderë të 17 shkurtit - Ditës së Shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës

Mbledhja filloi në orën 10;15, dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit.

Në fillimin e mbledhjes të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e Kuvendit të Komunës së Podujevës: (Nga LDK Valon Demolli; Demokrat Hodolli; Arnisa Sylejmani; Arjeta Abazi; Edona Shabani; Adnan Zymeri; Arjant Topanica; Ilir Koprani; Qëndrim Softolli; Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Fahri Hasani, munguan, Donjetë Sheqiri dhe Tringa Sfishta.

Nga LVV, Florent Hasani; Fitim Muçolli; Kasib Bashota; Sebastina Vokri; Drita Pajaziti; Qëndresë Hajrizi; Ragip Fetahu; Xhevdet Maloku; Ardi Hasani; Haki Rudari; Bahri Blakçori; ndërsa munguan Artirit Mulliqi dhe Lirika Maliqi.

Nga PDK, munguan, Bashkim Syla; Endritë Murati dhe Mimoza Abdullahu.

Nga AAK, Burim Hasani; Arbnor Fazliu, ndërsa mungoi Mrika Thaqi.

Nga OBKD, Gazmend Islami i cili mungoi.

Gjithashtu i pranishëm ishte z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës së Podujevës, drejtorët e Drejtorive të Komunës, dhe atë;

(Xhevdet Beqiri-Drejtorja e Administratës DA; Avni Fetahu-Drejtorja e Arsimit DKA; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Leutrim Krasniqi-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit DPUMM; Saranda Stublla-Drejtorja e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Pajtim Balaj-Drejtorja e Kulturës Rinisë dhe Sportit DKRS, Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh; Alban Zekai-Drejtorja e Inspeksionit DI, Lirie Hoti-Drejtorja e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR, Vigan Salihu-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik DPZHE,)

Të pranishëm tjerë ishin; përfaqësues nga Shoqatat e Dala nga Lufta e UÇK-së; z.Avni Ajeti, z.Florim Statovci, z.Musa Salihu, Kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së z.Xhemshir Gashi dhe anëtari kësaj Shoqate z.Maliq Behrami, Gjyqtari Mbikëqyrës i Gjykatës Themelore – Dega Podujevë z.Minir Hoti, Përfaqësuesi i Bashkësisë Islame z.Idriz Bilalli, përfaqësues të mediave lokale-TV Llapi, si dhe një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunale (lista e pjesëmarrësve)

Mbledhja u hap me Intonimin e Himnit të Republikës së Kosovës dhe Himnit të Republikës së Shqipërisë – Himni Kombëtar

- **Fjalë rasti nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

z.Hilmi Hoxha, theksoi, i nderuari Kryetar i Komunës së Podujevës z.Shpejtim Bulliqi, të nderuar anëtar e anëtare të Kuvendit të Komunës së Podujevës, drejtorë të drejtorive të Ekzekutivit të Komunës, të respektuara familje të Dëshmorëve anëtarë, përfaqësues të UÇK-së, përshëndetje për Imamin nga Podujeva z.Idriz Bilalli si dhe për Gjyqtarin z.Minir Hoti dhe të gjithë të pranishmit tjerë, mirë se keni ardhur në mbledhjen e organizuar për nderë të shënimit të 16 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

16 vjet më parë Kuvendi i Republikës së Kosovës shpalli Kosovën Shtet të Pavarur, kjo është ngjarja më e rëndësishme e historisë tonë, për shtetin dhe demokracinë.

Ngjarja që sot po e kremtojmë na e kujton luftën dhe sakrificën e Dëshmorëve dhe të rënëve të cilët dhanë jetën e tyre për lirinë e kësaj toke, andaj me këtë rast ju ftoj që t'i nderojmë me 1 minutë heshtje të gjithë Dëshmorët dhe të rënët për liri.

Mbahet 1 minutë heshtje në nderim të të gjithë Dëshmorëve dhe të të rënëve për liri. Lavdi

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdoi, tani ftoj Kryetarin e Komunës z.Shpejtim Bulliqi për një fjalë rasti.

- **Fjalë rasti nga Kryetari i Komunës së Podujevës**

z.Shpejtim Bulliqi, theksoi, i nderuar Kryesues i Kuvendit z.Hilmi Hoxha, të nderuar drejtorë/sha të Drejtorive Komunale, të respektuar anëtar/e të Kuvendit të Komunës, të nderuar përfaqësues të Shoqatave të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Familje të Dëshmorëve, Veteran të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i respektuari drejtues i institucionit të drejtësisë në Podujevë z.Minir Hoti, të nderuar media dhe qytetarë, motra dhe vëllezër.

Sot ne festojmë përvjetorin e 16-të të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

26 vite kanë kaluar nga lufta e Kosovës dhe 16 vite nga shpallja e Pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe kjo ditë vazhdon të jetë një kujtim i rëndësishëm i luftës dhe përpjekjeve tona për liri dhe pavarësi.

Në përvjetorin e Pavarësisë së Kosovës ne reflektojmë mbi rrugën tonë të gjatë drejtë Pavarësisë, mbi sfidat dhe pengesat që hasëm, si dhe mbi arritjet dhe sukseset tona.

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës ishte një moment historik për mbarë Kombin Shqiptar që na bëri të ndihemi të gjithë ne krenar.

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës ishte një moment kulminant për të cilin kontribuuan shumë breza e u sakrifkuan aq shumë gjatë historisë tonë.

Pavarësia e Kosovës ishte një shembull i rrallë i arritjes së lirës dhe sovranitetit në shekullin e XXI, kjo arritje ishte mundshme falë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe sakrificës së shumë brezave të cilët u flijuan duke rezistuar dhe luftuar për lirinë e Kosovës.

Gjithashtu lirinë e fituam edhe falë bashkëpunimit dhe ndihmës së miqve tanë ndërkombëtar që na mbështeten në këtë rrugëtim të vështirë e për të cilën u jemi falënderuar gjithmonë vendeve mike, por sigurisht se edhe rrugës paqësore të ish Presidentit Rugova dhe bashkëpunëtorëve të tij të cilët krijuan shumë ura të bashkëpunimit në vendet perëndimore dhe demokratike të botës.

Megjithatë duhet të pranojmë se ka ende sfida që duhet ballafaquar me to. Pavarësia dhe sovraniteti i Kosovës ende nuk janë njohur nga të gjitha shtetet e botës, dhe ne duhet të vazhdojmë të punojmë për të siguruar ato njohje dhe për të forcuar identitetin tonë shtetërorë.

Ne gjithashtu duhet të punojmë për të ndërtuar një shtet të qëndrueshëm dhe të integruar, me një ekonomi funksionale dhe në respektim të të drejtave dhe lirive për të gjithë qytetarë pa dallim.

Ne sot po festojmë këtë ditë historike, por Dita e Pavarësisë na obligon edhe më shumë për të qenë të përkushtuar, për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët tanë, e në veçanti për brezat e rinj.

Kosovën e kemi borxh ta duam dhe ta forcojmë. Liria dhe Pavarësia u arrit me shumë gjak e mund, e ne më së miri i nderojmë ata që mundësuan realizimin e kësaj dite duke punuar me dashuri dhe përkushtim për vendin.

Urime Dita e Pavarësisë së Kosovës të gjithë Shpatarëve anë e mbanë botës.

Zoti e bekoftë Kosovën.

Lavdi e nderime të gjithë Dëshmorëve, Martirëve dhe të rënëve të Kosovës.

Ju faleminderit.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, falënderoj Kryetarin e Komunës për këtë fjalim. Tani fjalën e ka kërkuar përfaqësuesi i Familjeve të Dëshmorëve z.Xhemshit Gashi.

z.Xhemshit Gashi, Kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, theksoi, faleminderit i nderuar Kryesues i Kuvendit, i nderuar Kryetar i Komunës, përfaqësues i Bashkësisë Islame, përfaqësues i Institucionit të drejtësisë në Podujevë z.Minir Hoti, përfaqësues i Organizatave të Veteranëve të luftës z.Avni Ajeti, shumë i nderuar z.Maliq Behrami babë i Dëshmorit Elfir Behrami, të nderuar anëtar/e të Kuvendit të komunës, drejtor/sha të Ekzekutivit të Komunës, ju përshëndes në emër të Organizatave të dala nga lufta e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të Zonës Operative të Llapit, në emër të familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve dhe Veteranëve të luftës.

Njëherit shfrytëzoj rastin t'ju uroj 16 vjetorin e Pavarësisë së shtetit tonë.

Nderi dhe lavdia i'u takon Dëshmorëve të Kombit.

Ne Llapi kemi dhënë një kontribut jashtëzakonisht të madh në këtë vijën kufitare për të mbrojtur dhe për ta qar përpara çështjen Shqiptare.

Siç e dini, edhe Komandanti i parë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë Zahir Pajaziti, pastaj nga Llapi është simbol i rezistencës tonë Kombëtare baca Adem Demaçi. Luftën e nisën Ali Ajeti, Afrim Zhitia dhe gjithë Zona Operative e Llapit.

Prandaj edhe njëherë shfrytëzoj rastin t'ju uroj këtë përvjetor sepse është arritja më e madhe e Popullit Shqiptarë që nga Shpallja e Pavarësisë së vitit 1912.

Urime kjo festë për të gjithë.

Kryesuesi i Kuvendit, duke falënderuar parafolësit, theksoi, para se të përfundojmë me këtë mbledhje solemne, ju njoftoj se pas përfundimit të kësaj mbledhje do të vazhdojmë me homazhe duke filluar nga Qyteti, por paraprakisht para objektit të komunës do ta bëjmë një fotografi të përbashkët.

Pra ju falënderoj për pjesëmarrje në këtë mbledhje Solemne dhe duke i'u uruar të gjithë qytetarëve të Komunës së Podujevës dhe Republikës së Kosovës Ditën e Pavarësisë – 16 vjetorin e shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Urime të gjithëve dhe mirupafshim në takimet e radhës.

Mbledhja përfundoi në ora 10:25

Procesverbalin e mbajti;

Enis Sheholli

Nr.Prot.01-016/01-0011914/24

Podujevë, 17 shkurt 2024

Kryesuesi i Kuvendit

Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja h) e ndërlidhur me nenet 5 shkronja b), 14 paragrafët 1, 2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, neneve 6 paragrafi 1.1 dhe 14 paragrafët 1, 2 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 61 paragrafi 1.8, ndërlidhur me nenet 3 paragrafi 1.2, dhe 17 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2019, në kërkesë dhe propozim të Drejtorisë së pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë me **02-463/06-0018159/24** të datës: **15.03.2024** Kryetari i Komunës së Podujevës, Kuvendit të Komunës, i;

PROPOZON **VENDIM**

PËR MIRATIM PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS – Njësia kadastrale **P-00594-0** e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej **25397 m²** në vendin e quajtur “Fshati” me shfrytëzim aktual Mal me Klasë 6

Neni 1

Kuvendit të Komunës i propozohet për miratim paraprak – Njësia kadastrale **P-00594-0** e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej **25397 m²** në vendin e quajtur “Fshati” me shfrytëzim aktual Mal me Klasë 6 e evidentuara në çertifikatën pronësore me **Nr.Pro. 08-942-06-0086689/23** të datës **13.12.2023**, pronë e Komunës, kopjen e planit si dhe dokumentacionit përkatës bashkëngjitur këtij propozim vendimi.

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në nenin 1 të këtij propozim vendimi, është shfrytëzimi për qëllime afariste, krijim i mundësive për vende të reja të punës dhe rritje e të hyrave vetanake.

Neni 3

Afati kohor për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në nenin 1 sipas këtij propozim vendimi është afatshkurtër përkatësisht në periudhë 10 (dhjetë) vite.

Neni 4

Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë realizohet përmes ankandit publik të cilat zbatohen nga Komisioni përkatës vlerësues i cili ngritët nga Kuvendi i Komunës.

Neni 5

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe të përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, do të rregullohen me kontratë të veçantë, të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi, pas përfundimit të procedurave përkatëse ligjore.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi dhe procedurave përkatëse ligjore dhe nënligjore, kujdeset Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës i cili formohet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 7

Pas shqyrtimit dhe miratimit, si dhe përfundimit të procedurave të shqyrtimit administrativ të ligjshmërisë së këtij akti, i njëjti hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqe zyrtare të Komunës.

Nr.Pro: 02-463/06-0018159/24

Me datën: 15.03.2024

**Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NUMËRIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71712079-00594-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

08-942/06-0086689/23

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

13.12.2023 - 08:52

Komuna / Opština / Municipality:

PODULJEVË / PODULJEVO / PODULJEVÉ

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Turqiçë / Turucica / Turciçe

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

PODULJEVË / PODULJEVO / PODULJEVÉ

A. TË DHËNAT PËR NUMËRINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71712079-00594-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		25397			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i kualitur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
FSHATI-FSHATI				



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i Klasës Kualiteti i Klasës Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area
1	Pyjeje/Sumsko/Forestry	Tokat Pyjeje/Sumsko zemljište/Forest	Mali I Klasës 6/Suma 6 Klasë/6th Class Forest	25397

B. PRONAR/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Llenti broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postai Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Fojedhnosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo inovine Share quota	Perskribimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poseidim individual / Individualna Drazavina / Single possessor	Komuna e Podujevës	600534946	PODUEVË / PODUEVO / PODUEVË /		NUHH GASHI	1/1		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PODUJEVË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Turuçicë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71712079-00594-0	Parcelë / Parcela / Parcel	25397



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2017

Punoi/Obradio/Created: Valon Beselica

Nënshkrimi/Potpis/Signature: _____

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 17.01.2024

Koha/ Vreme/ Time: 01:34:05





Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja h) ndërlidhur me nenin 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 18 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, nenit 18 të Rregullores QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të nenit 61 paragrafi 1.8, ndërlidhur me nenin 15 paragrafi 2.4, të Statutit të Komunës Nr.Prot: 01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, Kuvendit të Komunës, i

PROPOZON

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00594-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej 25397 m² në vendin e quajtur "Fshati" me shfrytëzim aktual Mal me Klasë 6 me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Miniera dhe Gurore

Neni 1

FORMOHET KOMISIONI VLERËSUES për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për 10-të vite sipas vendimit

_____ të datës: ____/____/____ për miratimin paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik pronën e paluajtshme të Komunës: Njësia kadastrale P-00594-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej 25397 m² në vendin e quajtur "Fshati" me shfrytëzim aktual Mal me Klasë 6 me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Miniera dhe Gurore

1. _____, nga Kuvendi i Komunës
2. _____, nga Kuvendi i Komunës
3. _____, nga Ekzekutivi i Komunës
4. _____, nga Ekzekutivi i Komunës
5. _____, nga sektori joqeveritar lokal

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Mandati i Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për zbatimin e vendimit me

Nr.Pro. _____ të Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të Komunës të datës: ____/____/_____.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje këtij komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 9 paragrafi 8 të rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren Nr.06/2021.

Nr.Pro: 02-020/04-0018165/24
Më 15.03.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja h) e ndërlidhur me nenet 5 shkronja b), 14 paragrafët 1, 2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, neneve 6 paragrafi 1.1 dhe 14 paragrafët 1, 2 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 61 paragrafi 1.8, ndërlidhur me nenet 3 paragrafi 1.2, dhe 17 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2019, në kërkesë dhe propozim të Drejtorisë së pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë Kryetari i Komunës së Podujevës, Kuvendit të Komunës, i;

PROPOZON

VENDIM

PËR MIRATIM PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS – Njësia kadastrale **P-00596-0** e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej **16214 m²** në vendin e quajtur “Fshati” me shfrytëzim aktual Tokë jo pjellore me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Miniera dhe Gurore

Neni 1

Kuvendit të Komunës i propozohet për miratim paraprak Njësia kadastrale **P-00596-0** e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej **16214 m²** në vendin e quajtur “Fshati” me shfrytëzim aktual Tokë jo pjellore me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Miniera dhe Gurore e evidentuara në çertifikatën pronësore **08-942/06-0004589/24** të datës 17.01.2024 dhe kopjës së planit, si dhe dokumentacionit përkatës bashkëngjitur këtij propozim vendimi.

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në nenin 1 të këtij propozim vendimi, është shfrytëzimi për qëllime afariste, krijim i mundësive për vende të reja të punës dhe rritje e të hyrave vetanake.

Neni 3

Afati kohor për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në nenin 1 sipas këtij propozim vendimi është afatshkurtër përkatësisht në periudhë 10 (dhjetë) vite.

Neni 4

Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtë realizohet përmes ankandit publik të cilat zbatohen nga Komisioni përkatës vlerësues i cili ngritet nga Kuvendi i Komunës.

Neni 5

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe të përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, do të rregullohen me kontratë të veçantë, të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi, pas përfundimit të procedurave përkatëse ligjore.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi dhe procedurave përkatëse ligjore dhe nënligjore, kujdeset Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës i cili formohet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 7

Pas shqyrtimit dhe miratimit, si dhe përfundimit të procedurave të shqyrtimit administrativ të ligjshmërisë së këtij akti, i njëjti hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqe zyrtare të Komunës.

Nr.Pro: 02-463/06-0018159/24

Me datën: 15.03.2024

Kryetari i Komunës

Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Zvoine Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NUMËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71712079-00596-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 08-942/06-0004589/24
Data dhe koha e fëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 17.01.2024 - 10:49
Komuna / Opština / Municipality: PODUJEVË / ПОДУЈЕВО / ПОДУЈЕВË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastrial Zone: Turuçë / Туруча / Туручѐ
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastrial Office: ПОДУЈЕВË / ПОДУЈЕВО / ПОДУЈЕВË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta inovine Property Type	Zona U/R C/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përkrahim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-71712079-00596-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL.	Pronë shoqërore / Društvena Inovini / Socially owned Land		16214			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
FSHAT- <u>FSHATI</u>				



A2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENIA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcesës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcesës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina Area (m ²)
1	Toke Tjetër/Ostalo Zemljište/Otherland	Jo Pëlllore/Neproduktiv Unproductive		16214

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Liten broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poseidin individual / Indivudnina Drzavina / Single possessor	Komuna e Podujevës	600534946	PODUEVE / PODUEVO / PODJEVE /		NUHI GASHI	1/1		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PODUJEVË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Turuçicë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71712079-00596-0	Parcelë / Parcela / Parcel	16214




Shkalla/Razmera/Scale: 1:1195

Punoi/Obradio/Created: Valon Beselica
Nënshkrimi/Potpis/Signature: _____
Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 17.01.2024
Koha/ Vreme/ Time: 01:33:38





Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja h) ndërlidhur me nenin 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 18 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, nenit 18 të Rregullores QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe në bazë të nenit 61 paragrafi 1.8, ndërlidhur me nenin 15 paragrafi 2.4, të Statutit të Komunës Nr.Prot: **01-020/01-0050862/18**, Kryetari i Komunës së Podujevës, Kuvendit të Komunës, i

PROPOZON

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Njësia kadastrale P-00596-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej 16214 m² në vendin e quajtur "Fshati" me shfrytëzim aktual Tokë jo pjellore me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Miniera dhe Gurore

Neni 1

FORMOHET KOMISIONI VLERËSUES për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës për 10-të vite sipas vendimit

_____ të datës: ____/____/____ për miratimin paraprak të vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik pronën e paluajtshme të Komunës: Njësia kadastrale P-00596-0 e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej 16214 m² në vendin e quajtur "Fshati" me shfrytëzim aktual Tokë jo pjellore me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Miniera dhe Gurore

1. _____, nga Kuvendi i Komunës
2. _____, nga Kuvendi i Komunës
3. _____, nga Ekzekutivi i Komunës
4. _____, nga Ekzekutivi i Komunës
5. _____, nga sektori joqeveritar lokal

Kryesuesi i Komisionit zgjedhet me shumicën e votave të anëtarëve të këtij komisioni dhe i njëjti organizon dhe kryeson punën e komisionit.

Neni 2

Mandati i Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, përkatësisht për zbatimin e vendimit me Nr.Pro. _____ të Kuvendit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës të paluajtshme të Komunës të datës: ____/____/_____.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Ligjin Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren QRK 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 4

Drejtoritë dhe shërbimet tjera përkatëse të Administratës së Komunës i ofrojnë përkrahje këtij komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 9 paragrafi 8 të rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren Nr.06/2021.

Nr.Pro: 02-020/04-0018165/24
Më 15.03.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës
Opština Podujeva / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja h) e ndërlidhur me nenet 5 shkronja b), 14 paragrafët 1, 2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, neneve 6 paragrafi 1.1 dhe 14 paragrafët 1, 2 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr.06/L-092, në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 61 paragrafi 1.8, ndërlidhur me nenet 3 paragrafi 1.2, dhe 17 të Statutit të Komunës nr.prot. 01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2019, në kërkesë dhe propozim të Drejtorisë së pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë Kryetari i Komunës së Podujevës, Kuvendit të Komunës, i;

PROPOZON VENDIM

PËR MIRATIM PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS - Njësia kadastrale **P-00597-0** e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej **768 m²** në vendin e quajtur "Fshati" me shfrytëzim aktual Livadh i Klasës 4 me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Miniera dhe Gurore

Neni 1

Kuvendit të Komunës i propozohet për miratim paraprak Njësia kadastrale **P-00597-0** e cila gjendet në Zonën Kadastrale Turuqicë me sipërfaqe prej **768 m²** në vendin e quajtur "Fshati" me shfrytëzim aktual Livadh i Klasës 4 me destinim sipas Hartës Zonale Kadastrale Miniera dhe Gurore e evidentuara në çertifikatën pronësore **08-942/06-0004589/24** të datës **17.01.2024** dhe kopjës së planit, si dhe dokumentacionit përkatës bashkëngjitur këtij propozim vendimi.

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës të cekur në nenin 1 të këtij propozim vendimi, është shfrytëzimi për qëllime afariste, krijim i mundësive për vende të reja të punës dhe rritje e të hyrave vetanake.

Neni 3

Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në nenin 1 sipas këtij propozim vendimi është afatshkurtër përkatësisht në periudhë 10 (dhjetë) vite.

Neni 4

Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtë realizohet përmes ankandit publik të cilat zbatohen nga Komisioni përkatës vlerësues i cili ngritet nga Kuvendi i Komunës.

Neni 5

Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe të përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim, do të rregullohen me kontratë të veçantë, të nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe përfituesi, pas përfundimit të procedurave përkatëse ligjore.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi dhe procedurave përkatëse ligjore dhe nënligjore, kujdeset Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës i cili formohet me vendim të veçantë nga Kuvendi i Komunës.

Neni 7

Pas shqyrtimit dhe miratimit, si dhe përfundimit të procedurave të shqyrtimit administrativ të ligjshmërisë së këtij akti, i njëjti hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqe zyrtare të Komunës.

Nr.Pro: 02-463/06-0018159/24

Me datën: 15.03.2024

Kryetari i Komunës

Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /

Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NUMËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71712079-00597-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

08-942/06-0004589/24

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vrene izdavanja / Date and time of submission:

17.01.2024 - 10:49

Komuna / Opština / Municipality:

PODUEJEVË / ПОДУЈЕВО / ПОДЈЕВЉЕ

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Turqicë / Turcieta / Турциџе

Zyra Kadastrale Komonale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:

PODUEJEVË / ПОДУЈЕВО / ПОДЈЕВЉЕ

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj kadastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronësisë Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
P-71712079-00597-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL.	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		768			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Azurirano Updated
FSHATI-FSHATI				



A2 LLOJII I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasesë Kvaliteti klase Quality Class	Sipërfaqja (m ²) Površina (m ²) Area (m ²)
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Livadhet/Livade/meadow	Livadh I Klasesë 4/Livada-4 Klase/4th Class Meadow	768

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi posttal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo inovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Azurirano Updated
Posejtim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Podujevës	600534946	PODUEVE / PODUEVO / PODUEVE /		NUHI GASHI	1/1		



